



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË ALBGAZ SHA

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI

PËRPUTHSHMËRINË NË
SHOQËRINË “ALBGAZ” SHA TIRANË”

QERSHOR 2022

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.	3
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.	9
II.	HYRJA	12
1	Objekti i auditimit.....	12
2	Qëllimi i auditimit.....	12
3	Identifikimi i çështjes.....	12
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	13
5	Përgjegjësitë e audituesve.....	13
6	Kriteret e vlerësimit.....	13
7	Standardet e auditimit.....	14
8	Metoda e auditimit.....	15
9	Dokumentimi i auditimit	15
III.	PËRSHRIMI I AUDITIMIT.....	16
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	16
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	16
2.1	Mbi zbatimin e ligjmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit, si dhe vendimet e marra dhe zbatimit i tyre	16
2.2	Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe administrimi i marrëdhënieve të punës.	20
2.3	Auditim mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko-financiar të shoqërisë, si dhe ndjekja e realizimit të këtyre treguesve.	30
2.4	Organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese. Analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.	34
2.5	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale	39
2.6	Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjeve me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj.,).	40
2.7	Mbi zbatimin e ligjshmërisë në procedurat e prokurimeve, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, si dhe efektiviteti i investimeve.	48
2.8	Mbi zbatimin e rregullave dhe procedurave të shitblerjes të gazit dhe projektet që lidhen me gazin natyror.	68
2.9	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të auditit të brendshëm.	71
2.10	Të tjera që mund të dalin gjatë auditimit.	81
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	81
V.	ANEKSE.....	97

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Organizmi dhe funksionimi i Shoqërisë është në zbatim të Ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e Gazit Natyror. VKM nr. 848, datë 07.12.2016 “Për krijimin e Shoqërisë “Albgaz” Sh.a dhe përcaktimin e autoritetit publik”.

-Objekti i kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është operimi si operator i kombinuar i gazit natyror në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e Gazit Natyror. Për të realizuar këtë funksion, Shoqëria: -Ushtron aktivitetin si Operator i Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.-Kryen të gjitha aktivitetet e nevojshme për të ndërtuar dhe operuar sisteme gazi për transmetimin, shpërndarjen, depozitimin nëntokësor apo operimin e terminaleve të gazit të lëngëzuar, menaxhim të interkonjeksionit të transportit të gazit ndërkufitar, depozitimit dhe shpërndarjes.-Planifikon, projekton, ndërton, zotëron, operon dhe mirëmban në përputhje me rregullat teknike, kapacitetet e reja apo ekzistuese teknike të sigurta të transmetimit, shpërndarjes dhe interkonjeksionit, si dhe depozitat e gazit natyror dhe të lëngshëm.-Koordinon dhe bashkëvepron në rrjetin Evropian të Operatorëve të sistemit të Transmetimit për Gaz (ENTSO-G). -Realizon çdo operacion tregtar dhe financiar, lidhur direkt ose indirekt me objektin e veprimtarisë, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

-Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është përputhshmëria aktivitetit të subjektit për periudhën nga 01.07.2017 deri më datë 31.12.2021.

Është audituar aktiviteti i Institucionit për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar vendimmarrja e organeve drejtuese, shpenzime për investime, shpenzimet operative, shpërblimet dhe pagat, programimi dhe realizimi i plan-biznesit, realizimi i prokurimeve dhe kontratave përkatëse, etj.

2. Përshkrim i shkurtër i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së “Albgaz” ShA Tiranë, për periudhën objekt auditimi. Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi: Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit, si dhe vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, pagat dhe shpërblimet, administrimi i marrëdhënieve të punës, hartimi, miratimi dhe realizimi i programit ekonomiko-financiar të shoqërisë, organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile, hartimi dhe miratimi i bilancit, gjendja dhe ecuria e detyrimeve debitorë dhe kreditorë, derdhja e detyrimeve fiskale në buxhetit të shtetit, procesi i inventarizimit, dhënien dhe marrjen me qira të aseteve dhe zbatimi i kontratave të qirasë, veprimet e arkës dhe bankës, zbatimi i ligjshmërisë në procedurat e prokurimeve, zbatimi i ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të auditit të brendshëm, etj.

3. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Nga auditimi është konstatuar se:

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar të auditimit.	Rëndësia	Rekomandimi

1	Situata ekonomiko financiare që nga krijimi i kësaj shoqërie (2017-2021), është me humbje, si dhe detyrimet ndaj të tretëve si kredi afatshkurtër e afatgjatë në vlerën 411,656 mijë lekë, detyrime të cilat janë maturuar për pagesë dhe janë kërkuar për likuidim, pasqyron qartazi jo vetëm situatën e vështirë të likuiditetit të Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, por po të vazhdohet në këtë pozitë, kjo shoqëri rrezikon të falimentojë. Në opinionin e grupit të auditimit kjo ka ardhur për arsyet si më poshtë: -Mos kryerja e plotë aktivitetit të kësaj shoqërie referuar objektit të veprimtarisë, si operator i kombinuar i gazit natyror, duke kryer veprimtarinë vetëm të operatorit të sistemit të transmetimit dhe jo edhe të operatorit të sistemit të shpërndarjes {për tre vite kjo shoqëri ka marr gaz natyror nga shoqëria A. (shoqëria mëmë) dhe ja ka shitur përsëri shoqërisë mëmë (A.) si klient fundor}. -Mos vëmendja e duhur në investime shtetërore në zbatim të parashikimeve Master Planit të Gazit Natyror, mos avancimi në projekte me interes të përbashkët të Komunitetit të Energjisë {JAP (Degëzim i TAP AG në drejtim të Kroacisë), ALKOGAP (Degëzim i TAP AG në drejtim të Kosovës, si dhe depozita nëntokësore e gazit natyror në Dumre-Elbasan) që duhet të ishin të avancuara, si e vetmja Shoqëri në Republikën e Shqipërisë me objekt të veprimtarisë, si operator i	Pika 2	E lartë	Organet drejtuese të shoqërisë duhet analizojnë dhe të vlerësojnë arsyet e produktivitetit të ulët të veprimtarisë ekonomiko-financiare, efektin e çdo arsyeje të identifikuar, përfshirë një analizë të detajuar të detyrimeve ndaj të tretëve dhe në veçanti kreditë afatshkurtra e afatgjata, si dhe të merren masat e nevojshme për daljen nga kjo situatë që shoqëria mos të falimentojë. Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, ti kërkojnë në rrugë institucionale Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë Asamblesë (pronarit) dhe të monitoruesit dhe hartimit të politikave, që të ndërmarrin veprime ligjore, për korrigjimin e menjëhershëm të veprimtarisë së kësaj shoqërie, dhe konkretisht për investime shtetërore në zbatim të parashikimeve të Master Planit të Gazit Natyror dhjetor 2016, si dhe marrjen e masave për kryerjen e plotë të aktivitetit të kësaj shoqërie referuar objektit të veprimtarisë, si operator i kombinuar i gazit natyror, duke kryer veprimtarinë e operatorit të sistemit të transmetimit dhe operatorit të sistemit të shpërndarjes.
---	--	--------	---------	--

	kombinuar i gazit natyror, duke kryer veprimtarinë e operatorit të sistemit të transmetimit dhe operatorit të sistemit të shpërndarjes. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, neni 104 dhe 190, Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, neni 22, Master Plani i Gazit Natyror, dhjetor 2016. -Organizimi i shoqërisë me strukturë organizative, të mbingarkuar, e pa strukturuar për të plotësuar objektin e shoqërisë, duke sjellë kosto në rritje në shpenzimet e shoqërisë.			
2	: -Sipas programit ekonomik për vitin 2017, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 116 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar 115 punonjës, pra 1 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 68,790 mijë lekë, pra 2,908 mijë lekë më pak se programi. -Sipas programit ekonomik për vitin 2018, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 117 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar 115 punonjës, pra 2 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 79,141 mijë lekë, pra 459 mijë lekë më pak se programi. -Sipas programit ekonomik për	Pika 5	E mesme	Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë Albgaz SHA të merren masa për parashikimin e saktë të strukturës numrit të punonjësve, duke ju referuar nevojave specifike të shoqërisë, bazuar në funksionin e saj primar.

	vitin 2019, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 117 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2019 është realizuar 116 punonjës, pra 1 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 93,330 mijë lekë, pra 3,103 mijë lekë më pak se programi. -Sipas programit ekonomik për vitin 2020, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 118 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2020 është realizuar 113 punonjës, pra 5 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 90,922 mijë lekë, pra 3,618 mijë lekë më pak se programi. -Sipas programit ekonomik për vitin 2021, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 119 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2021 është realizuar 113 punonjës, pra 6 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 97,428 mijë lekë, pra 2,372 mijë lekë më pak se programi. -Sa më sipër, konstatohet se struktura organizative e shoqërisë Albgaz SHA, është e paargumentuar, jo e mirë menduar dhe duke u bazuar në aktivitetin, të ardhurat e rezultatin financiar negativ të shoqërisë nuk justifikohet numri i punonjësve. -Sa më sipër nga grupi i auditimit konstatohet se			
--	---	--	--	--

	struktura organizative dhe fondi i pagave, çdo vit kanë progresion rritës, i cili në asnjë rast nuk realizohet dhe nuk justifikohet.			
3	Për vitin 2017 janë kryer 3 procedura prokurimi me vlera të vogla me objekt “Blerje karburanti Diezel D1 dhe Benzinë” me vlerë totale 1,150,000 lekë pa TVSH. Nga auditimi i këtyre procedurave konstatohet se Autoriteti Kontraktor për vitin 2017 ka copëzuar fondin limit, në kundërshtim me nenin 28.2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e efikasitetit në përdorimin e këtyre fondeve. - Në procedurën e iniciuar me kërkesën e Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëveshjeve me nr. 237 Prot., datë 05.09.2017, me objekt “Blerje pajisje GPS” për nevoja të Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, u konstatua se parametrat teknik të kërkuar janë me vlera specifike dhe jo me kufij të limituar. Përcaktimi me vlera të pandryshuara të madhësisë së ekranit, pesha, rezolucioni, kohë zgjatja e baterisë ka sjellë paracaktimin e fituesit të procedurës. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 23, pika 3, nenin 23, pika 3 dhe nenin 40 të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,	Pika 5	E lartë	Nga Autoriteti kontraktor të merren masa për korrigjimin e praktikave që çënojnë parimet e konkurrencës në çmimin e paguar nga shoqëria për blerjen e një malli, shërbimi apo kryerjen e një pune, të cilat nga ana tjetër kanë efekt të drejtpërdrejtë në shpenzimet e buxhetit të shtetit.

	me ndryshimet vijuese të tij.			
4	Administrata e Shoqërisë ka përfituar padrejtësisht: -Për periudhën Mars 2018 deri më Mars 2020, trajtim me dietë ushqimore në vlerën 4,648,000 lekë, trajtim i cili referuar pikës 2, germa a, të VKM nr. 68, datë 07.02.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, duhet të ishte 300 lekë për ditë pune, ndërsa Administrata e Shoqërisë është trajtuar me 500 lekë për ditë pune. Për periudhën prill të vitit 2020 e në vazhdim ky trajtim është konformë VKM të sipërcituar. -Për periudhën objekt auditimi konstatohet se punonjësit e shoqërisë Albgaz SHA kanë përfituar padrejtësisht bonusin dietë antidodë në vlerën 3,170,244 lekë, bonus i cili referuar kontratës kolektive nr. 261, datë 19.09.2017, jepet për punonjësit që ushtrojnë detyrën në terren në kushtet e vështirësive tekniko profesionale, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë	Pika 5	E mesme	Nga organet drejtuese të shoqërisë të analizohet vlera 5,286,854 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me trajtim me dietë ushqimore dhe dietë antidodë të administratës në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 5 datë 12.11.2019, dhe të merren masa për tu mos u përsëritur në të ardhmen, pasi kjo vlerë për Shoqërinë “Albgaz” dhe Buxhetin e Shtetit, përbën efekt negativ në menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.
5	Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 7 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 8,491,981 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të	Pika 2	E lartë	Nga Administratori, sektori Juridik dhe Burimet Njerëzore të shoqërisë Albgaz SHA, të merren masa për analizimin e vlerës prej 8,491,981 lekë, të efektit negativ dhe për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës

	marrëdhëniet e punës dhe shpenzime përmbartimore. Lidhur me këto çështje gjyqësore nga ana e përmbartuesve privatë është vepruar me urdhër sekuestro. Sa më sipër vlera 8,491,981 lekë përbën efekt negativ financiar në buxhetin e shoqërisë.			me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinion i auditimit.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si edhe për shkak të kufizimeve të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale.

Konkluzionet dhe opinionet ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Albga ShA., e cila konsiderohet nga ana jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin profesional dhe ushtruar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionit me siguri të arsyeshme.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë¹

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë i kryer në subjektin Albga SHA, i mbështetur në ligjin nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi. Krahas parregullsisë materiale sasiore, grupi i auditimit në dhënien e opinionit ka marrë në konsideratë dhe gabime/parregullsi të caktuara të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre. Në përfundim të auditimit, pasi u morën dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë.

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000²)

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale. Konkluzionet dhe opinionet ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Albga SHA, e cila konsiderohet nga ana

jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinioni me siguri të arsyeshme. Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, ISSAI 1500 (ISA 500)¹ dhe ISSAI 1530 (ISA 530)²; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinioni në këtë auditim përputhshmërie. Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinioni të gabuar rreth objektivit të auditimit.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, nga gjetjet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e opinionit të mësipërm, veçojmë:

- Janë konstatuar efekte negative në administrimin e fondeve të pagave dhe menaxhim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet i tyre në vlerën prej **5,286,854 lekë** në drejtim të shpërblimeve në pagë;
- Janë konstatuar efekte negative në administrimin e marrëdhënieve me punonjësit duke pasur si pasojë shpërblime nga vendime gjyqësore në vlerën prej **8,491,981 lekë**
- Mangësi në drejtim të hartimit të kriterëve dhe specifikimeve teknike gjatë procedurave të prokurimit;
- Shoqëria “Albgaz” Sh.a është çertifikuar nga ERE, si operator i kombinuar i gazit natyror, nga ERE me Vendim nr. 179, datë 08.11.2017 në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 EC, çertifikim i cili është kushtëzuar, si për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror me plotësimin e dokumentacionit që tregon titujt e pronësisë mbi aktivet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar, lejet dhe autorizimet mjedisore, certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri). Për plotësimin e këtyre kushteve ERE herë pas here ka vendosur dhe rivendosur afate me Vendimet nr. 188, datë 10.11.2017, nr. 63, datë 23.04.2019, nr. 221, datë 20.12.2019, nr. 37, datë 04.03.2019, nr. 220, datë 20.12.2019, nr. 261, datë 19.12.2018, nr. 36, datë 04.03.2019 dhe me Vendim nr. 220, datë 20.12.2019, ka vendosur të shtyjë sërish afatin e depozitimit të dokumentacionit të munguar deri më datë 31.03.2022. Sikurse me aktivitetin e transmetimit, edhe me shpërndarjen, konstatohet se deri më datë 31.03.2022 datë në të cilën përfundoj auditimi, nuk është plotësuar asnjë nga kushtet e vendosura nga ERE.
- Etj.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të Albgaz SHA:

Stafi drejtues është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve të strukturës në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe

¹ Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij.

² Objektivi i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe për përdorimin e këtyre fondeve me ekonomicitet eficient dhe efektivitet etj.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinioni i auditimit janë të përshtatshme.

¹Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti i një çështje nuk është aq material sa të justifikojë dhënien e një opinionit të kundërt.

²ISSAI 4000-Udhërfyesi i Auditimit të Përputhshmërisë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr.9/1 prot., datë 17.01.2022, nga data 18.01.2022 deri më datë 31.03.2022, në subjektin Albgaz Sh.A., për periudhën nga data 01.07.2017 deri më datë 31.12.2021, u krye auditimi “Përputhshmërisë” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1.B. Sh.
- 2.I. B.
- 3.K. Sh.
- 4.B. Sh.

1.Objekti i auditimit: Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me aktivitetin e subjektit, sipas pikave të programit të auditimit., si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e situatës.

2. Qëllimi i auditimit: Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të

dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse Albgaz Sh.A., në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar dhe shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

3. Identifikimi i çështjes: Projekt Raporti mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Albgaz Sh.A., për periudhën 01.07.2017- 31.12.2021, ka identifikuar sipas kriterëve specifikë të vlerësimit, shqyrtimit dhe vlerësimit të fushave në vijim:

- Organizimi dhe funksionimi i organeve drejtuese të institucionit si këshillit drejtues dhe drejtorisë, ligjshmëria e vendimeve të marra dhe zbatimi i tyre.

- Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programeve ekonomiko-financiare në organet drejtuese të institucionit dhe në institucionet e prore, si dhe realizimi i tyre.

- Administrimi i marrëdhënieve të punës, miratimi dhe zbatimi i strukturave organizative, zbatimi i dispozitave ligjore për pagat dhe shpërblimet, ligjshmëria e pagesave të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

- Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese, dërgimi i miratimi i tij në institucionet e prore, si dhe zbatimi i detyrimeve fiskale ndaj buxhetit të shtetit.

- Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullariteti i veprimeve të arkës dhe bankës në lekë dhe në valutë, duke përfshirë dhe shpenzimet për karburant, shpenzimet telefonike, për energji elektrike, udhëtim e dieta etj., si dhe blerjet me vlera të vogla.

- Mbi regjistrimin, gjendjen dhe masat e marra për uljen e detyrimeve debitoare dhe kreditore, si dhe inventarizimi pasurisë.

- Zbatimi i ligjshmërisë në procedurat e prokurimeve publike, lidhja dhe zbatimi i kontratave.

- Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime.

- Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së Njesisë Auditit të Brendshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Strukturat drejtuese, duhet të orientojnë strukturat e institucionit, për ndërtimin e banesave sociale me kosto sa më të ulët dhe cilësi.

5. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar:

- Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e

përcaktuara (ISSAI 4000), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne si Auditues Shtetëror shprehemi me një opinionin mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryej në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300).

-Të kryej procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit: Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH, - Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

-Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

-Ligji nr. 25/2018, Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare

Ligji nr. 8438, datë 28.12.2018 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”;

Ligji nr. 7853, datë 29.04.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi) i ndryshuar me ligjin nr. 7853, datë 29.07.1994, ligjin nr. 8297 datë 4.03.1998, nr. 10137 datë 11.05.2009.

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”.

Ligji nr. 7746, datë 28.08.1993 “Për kërkimin, zhvillimin, prodhimin, trajtimin, transportimin dhe shitjen e naftës bruto, gazit dhe rërave bituminoze brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse.

Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, i ndryshuar

Ligji nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar.

Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve; Ligji nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016 “Për krijimin e Shoqërisë “Albgaz” Sh.a dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Shoqërive “Albpetrol” Sh.a dhe “Albgaz” Sh.a;

- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-VKM nr. 68, datë 07.02.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”.

-VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar,

VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre.

- Statuti dhe Rregullorja e brendshme e shoqërisë.

- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë miratuar sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH me nr. 66 datë 23.06.2020.

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”.

- Dispozitat ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë.

- Të tjera.

7. Standardet e auditimit: Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme tëpranuara të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

-Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.

- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;

- ISSAI 400-Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;

- ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;

- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;

- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;

- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; si dhe në praktikat më të mira të fushës.

8. Metodatat e auditimit: Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e Albgaz Sh.A., kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimtimit të auditimit; të gjykrimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe

konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me akt-konstatimet, aktverifikimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

9.Dokumentimi i auditimit: Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion u konsiderua i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Dokumentimi i punës audituese në teren është bërë në aktet e mbajtura në subjektin e audituar. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve dhe akt-verifikimeve të mbajtura si dhe observacioneve të paraqitura për këto akte dhe për Projekt Raportin përkatës u përgatit dhe u dërgua në subjekt ky Raport Përfundimtar të Auditimit.

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Pika III.1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar

Organizmi dhe funksionimi i Shoqërisë është në zbatim të Ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e Gazit Natyror. VKM nr. 848, datë 07.12.2016 “Për krijimin e Shoqërisë “Albgaz” Sh.a dhe përcaktimin e autoritetit publik”.

-Objekti i kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është operimi si operator i kombinuar i gazit natyror në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e Gazit Natyror. Për të realizuar këtë funksion, Shoqëria:

-Ushtron aktivitetin si Operator i Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

-Kryen të gjitha aktivitetet e nevojshme për të ndërtuar dhe operuar sisteme gazi për transmetimin, shpërndarjen, depozitimin nëntokësor apo operimin e terminaleve të gazit të lëngëzuar, menaxhim të interkonjeksionit të transportit të gazit ndërkufitar, depozitimit dhe shpërndarjes.

-Planifikon, projekton, ndërton, zotëron, operon dhe mirëmban në përputhje me rregullat teknike, kapacitetet e reja apo ekzistuese teknike të sigurta të transmetimit, shpërndarjes dhe interkonjeksionit, si dhe depozitat e gazit natyror dhe të lëngshëm.

-Koordinon dhe bashkëvepron në rrjetin Evropian të Operatorëve të sistemit të Transmetimit për Gaz (ENTSO-G).

-Realizon çdo operacion tregtar dhe financiar, lidhur direkt ose indirekt me objektin e veprimtarisë, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Pika III.2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre

procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

Drejtimet e auditimit dhe rezultatet përkatëse, paraqiten në vijim.

2.1 Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe administrimi i marrëdhënieve të punës.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit “Nr.9/1, datë 17.01.2022”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) Vendimet e Këshillit të Mbikëqyrjes për periudhën objekt të auditimit

2) Urdhrat e brendshëm të Administratorit.

Organizmi dhe funksionimi i Shoqërisë është në zbatim të Ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e Gazit Natyror”. VKM nr. 848, datë 07.12.2016 “Për krijimin e Shoqërisë “Albgaz” Sh.a dhe përcaktimin e autoritetit publik”.

-Objekti i kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është operimi si operator i kombinuar i gazit natyror në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e Gazit Natyror”, për të realizuar këtë funksion, Shoqëria:

-Ushtron aktivitetin si Operator i Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

-Kryen të gjitha aktivitetet e nevojshme për të ndërtuar dhe operuar sisteme gazi për transmetimin, shpërndarjen, depozitimin nëntokësor apo operimin e terminaleve të gazit të lëngëzuar, menaxhim të interkonjeksionit të transportit të gazit ndërkufitar, depozitimit dhe shpërndarjes.

-Planifikon, projekton, ndërton, zotëron, operon dhe mirëmban në përputhje me rregullat teknike, kapacitetet e reja apo ekzistuese teknike të sigurta të transmetimit, shpërndarjes dhe interkonjeksionit, si dhe depozitat e gazit natyror dhe të lëngshëm.

-Koordinon dhe bashkëvepron në rrjetin Evropian të Operatorëve të sistemit të Transmetimit për Gaz (ENTSO-G).

-Realizon çdo operacion tregtar dhe financiar, lidhur direkt ose indirekt me objektin e veprimtarisë, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Për periudhën objekt auditimi me Vendime të Këshillit Mbikëqyrës:

Me vendim Nr. 2, datë 05.01.2017, Këshilli Mbikëqyrës i përberë nga E. E., A. B., E. L., T. K., S. D. dhe S. T., ka emëruar K. G. në detyrën e administratorit të Shoqërisë.

Me Vendim Nr. 21, datë 21.09.2017 Këshilli Mbikëqyrës i përberë nga E. E., A. B., E. L., T. K., S. D. dhe S. T., ka komanduar në detyrën e Administratorit të Shoqërisë G. Gj., me afat deri në emërimin e administratorit të ri.

Me vendimin Nr. 5/1, datë 06.04.2018 është vendosur lirimi nga detyra e Administratorit z.G. Gj. si dhe emërimi në detyrë i z.A. A.

Titulli i Gjetjes: Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk kanë lidhur kontratë me Administratorët e Shoqërisë.

Situata: Për periudhën objekt auditimi me Vendime të Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 05.01.2017, nr. 21, datë 21.07.2017 dhe nr. 5/1, datë 06.04.2018 janë emëruar Administratorët e Shoqërisë, me të cilët asnjëherë veprimtaria e tyre nuk është bazuar në marrëdhënie kontraktuale, në kundërshtim me statutin e shoqërisë.

Kriteri: Statuti i shoqërisë.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e kriterëve dhe objektivave për matjen e performancës vjetore të Administratorëve të Shoqërisë.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Keq interpretim i dispozitave ligjore.

Rekomandime: Në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 5/1, datë 06.04.2018 të lidhet kontratë me Administratorin e Shoqërisë, në të cilën të parashikohen kriteret e qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë, si dhe të bëhen vlerësime vjetore të performancës së punës së Administratorit, bazuar në objektivat/kriteret e performancës të parashikuar në kontratë.

Theksojmë se në asnjë moment veprimtaria e tyre nuk është bazuar në marrëdhënie kontraktuale, kjo vjen në kundërshtim me statutin e shoqërisë neni 19.5 ku shprehimisht cilësohet se :

“Me pranimin e zgjedhjes së tij Administratori pranon se marrëdhënia e tij me Shoqërinë janë marrëdhënie kontraktuale sipas legjislacionit në fuqi, kjo miratuar nga Asambleja e Përgjithshme “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, datë 05.01.2017.

-Në statutin e shoqërisë Albgaz Sh.a, neni 13.3, ku citohen të drejtat e Asamblesë së përgjithshme, u konstatua vendosja e kufirit për aprovimin e huave në vlerat mbi 10,000,000 euro dhe të drejtën e vendimmarrjes për heqje dorë nga një e drejtë për vetëm mbi 300,000 euro ose 500,000 euro vlera kumulative gjatë një viti, duke i lënë vlerat nën këto tavane si kompetencë e aprovimit të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 16, Këshilli Mbikëqyrës, pika 16.3, kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës, gërma n., shprehë në mënyrë eksplicite: “Të miratojë hyrjen në një marrëveshje huaje apo kredie ose krijime të tjera (apo marrëveshje për krijim) të një borxhi të shoqërisë deri në shumën prej 10,000,000 Euro.

- Të japë miratimin paraprak për blerjen e aseteve të paluajtshme mbi vlerën 100.000 Euro.

- Të miratojë paraprakisht shitjen apo çdo formë disponimi të aseteve të paluajtshme të Shoqërisë me vlerë nga 50.000 deri 100.000 Euro, dhe të kërkojë paraprakisht miratimin e Asamblesë për vlera më të mëdha se 100.000 Euro.

- Të miratojë paraprakisht shitjen e aseteve të luajtshme në rast se vlera e një kontrate është nga 50.000 deri 100.000 Euro, ose nëse vlera kumulative e këtyre kontratave është nga 250.000 deri 500.000 Euro brenda një viti financiar.”

- Termi i përdorur sa më sipër (... të miratoj paraprakisht...), nuk është i qartë dhe nuk i jep vlerë përfundimtare kompetencës së ceduar, pra Këshilli Mbikëqyrës, i shqyrton paraprakisht dhe më pas shqyrtohen dhe nga Asambleja e Përgjithshme, apo është organi i vetëm që i shqyrton dhe pas tij vendimet marrin vlerë përfundimtare.

Kompetencat si më sipër të Këshillit Mbikëqyrës, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, neni 4, (Shtuar pas fjalisë së parë me Ligjin nr. 8/2016, datë 11.2.2016), ku shprehet në mënyrë

eksplicite: “Ministria e Ekonomisë është përfaqësuese e pronarit për pronën shtetërore. Ushtrimi i së drejtës së përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, përfshirë edhe të drejtën e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, në shoqëritë elektro-energjetike, bëhet në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe në shoqëritë e gazit natyror bëhet në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror. Neni 10. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe për sa kohë që shteti do të jetë i vetmi aksionar ose ortak i shoqërive, organet drejtuese të ndërmarrjeve a shoqërive nuk kanë të drejtë të autorizojnë ose të kryejnë shitje të pasurive të paluajtshme dhe të makinerive e pajisjeve, të marrin hua dhe kredi, si dhe të krijojnë shoqëri të përbashkëta.

- Lidhur me nenin 17, përbërja e Këshillit Mbikëqyrës, në asnjë nga pikat nuk përcaktohet kriteri i aftësive profesionale, eksperiencë dhe monitorimi i veprimtarisë mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse i tyre me performancën e shoqërisë.

- Në pikën 18.8, i mundësohet Këshillit Mbikëqyrës të marrë vendime pa u mbledhur, duke i'u komunikuar vendimi që do të merret me e-mail ose postë. Kjo lloj forme e marrjes së vendimeve pa zhvilluar pjesën e njohjes së problematikës që do të shqyrtohet dhe pa pjesën e diskutimeve dhe vlerësimeve të opsioneve të ndryshme e deformon funksionin mbikëqyrës dhe vendimmarrës të KM, në një pjesë formale dhe të rrezikshme për mbarëvajtjen e shoqërisë.

- Marrëveshja për fondet e rikonstruksionit të qendrës Fier (Funding Agreement C32919 between Trans Adriatic Pipeline AG Albanian Branch and AlbgaZ Sh.a), hartuar dhe nënshkruar më datën 18.09.2017, protokolluar me nr. 141 prot., datë 03.11.2017 në gjuhën Angleze, nuk është hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare.

- EBRD-ECA (Terma Reference: Project është përgatitur me ndihmën e konsulentit E., si pjesë e asistencës për ngritjen e kapaciteteve teknike, financuar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZ) e nënshkruar më datën 04.05.2017, hartuar dhe nënshkruar në gjuhën Angleze, nuk është hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare.

- Marrëveshja trepalëshe të trajnimit të negociuar ndërmjet S. S.P.A, Shoqërisë “AlbgaZ” Sh.a dhe Shoqërisë “A.” Sh.a, e nënshkruar më datën 22.01.2020, hartuar dhe nënshkruar në gjuhën Angleze, nuk është hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare.

Marrëveshjet si mësipër të hartuara dhe nënshkruara vetëm në gjuhën angleze, pa u hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 14.

Grupi i auditimit në këto kushte, refuzon të jap opinion në lidhje mbi përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi të këtyre marrëveshjeve, pasi ato janë hartuar dhe nënshkruar vetëm në gjuhën angleze, pa u hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare, në kundërshtim me Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 14.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

-Situata ekonomiko financiare që nga krijimi i kësaj shoqërie (2017-2021), është me humbje, si dhe detyrimet ndaj të tretëve si kredi afatshkurtër e afatgjatë në vlerën 411,656 mijë lekë, detyrime të cilat janë maturuar për pagesë dhe janë kërkuar për likuidim, pasqyron qartazi jo

vetëm situatën e vështirë të likuiditetit të Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, por po të vazhdohet në këtë pozitë, kjo shoqëri rrezikon të falimentojë. Në opinionin e grupit të auditimit kjo ka ardhur për arsyt si më poshtë:

-Mos kryerja e plotë aktivitetit të kësaj shoqërie referuar objektit të veprimtarisë, si operator i kombinuar i gazit natyror, duke kryer veprimtarinë vetëm të operatorit të sistemit të transmetimit **dhe jo edhe të operatorit të sistemit të shpërndarjes** {për tre vite kjo shoqëri ka marrë gaz natyror nga shoqëria A. (shoqëria mëmë) dhe ja ka shitur përsëri shoqërisë mëmë (A.) si klient fundor.

-Mos vëmendja e duhur në investime shtetërore në zbatim të parashikimeve Master Planit të Gazit Natyror, mos avancimi në projekte me interes të përbashkët të Komunitetit të Energjisë {JAP (Degëzim i TAP AG në drejtim të Kroacisë), ALKOGAP (Degëzim i TAP AG në drejtim të Kosovës, si dhe depozita nëntokësore e gazit natyror në Dumre-Elbasan) që duhet të ishin të avancuara, si e vetmja Shoqëri në Republikën e Shqipërisë me objekt të veprimtarisë, si operator i kombinuar i gazit natyror, duke kryer veprimtarinë e operatorit të sistemit të transmetimit dhe operatorit të sistemit të shpërndarjes. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, neni 104 dhe 190, Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, neni 22, Master Plani i Gazit Natyror, dhjetor 2016.

-Organizimi i shoqërisë me strukturë organizative, të mbingarkuar, e pa strukturuar për të plotësuar objektin e shoqërisë, duke sjellë kosto në rritje në shpenzimet e shoqërisë.

2.2 Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe administrimi i marrëdhënieve të punës.

1. Titulli i Gjetjes: Struktura organizative dhe niveli i pagave i Shoqërisë, nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja Aksionare.

Situata: Struktura organizative dhe niveli i pagave të Shoqërisë, nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja Aksionare (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë). Konkretisht për vitin 2017 nuk është marrë miratimi për strukturën organizative, për vitet 2018 dhe 2019 nuk është marrë miratimi për strukturën organizative dhe nivelin e pagave dhe për vitin 2020 nuk është marrë miratimi për nivelin e pagave. Organet drejtuese të Shoqërisë (Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori) e kanë quajtur të ezauruar miratimin vetëm me miratimin e programit ekonomik ku pjesë e tij është dhe fondi i pagave.

Kriteri: Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 2.

Ndikimi/Efekti: Situata konfuze dhe e paqartë në shpërblimin e punonjësve të shoqërisë.

Rëndësia: E mesme.

Shkaku: Keq interpretim i dispozitave ligjore.

2. Titulli i Gjetjes: Për pozicionet Përgjegjës Sektori, Shef Sektori, Asistent Ekzekutiv, Këshilltar, Drejtor Drejtorie, përcaktimi dhe rritja e pagës është lënë kompetencë të Administratorit.

Situata: Shoqëria “Albgaz” Sh.a marrëdhëniet e punës me punonjësit e saj i ka të rregulluar bazuar në Ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, Kontratës kolektive nr. 261, datë 19.09.2017 dhe kontratave individuale të punës. Pagat janë të grupuar në katër nivele për secilin pozicion pune, konkretisht niveli i I, II, III dhe IV dhe secili nivel ka një

limit përcaktuar. Për pozicionet punëtor deri në specialist brenda limitit të çdo niveli është përcaktuar paga e secilit punonjës me vendim të Administratorit.

Për pozicionet përgjegjës sektori, shef sektori, asistent ekzekutiv, këshilltar, drejtor drejtorie nuk ka të miratuar sipas kompetencave statusore një rregullore, ku të parashikohen kriteret e caktimit të pagës brenda limit të miratuar.

Kriteri: Kodi i punës, kontratat kolektive dhe individuale të punonjësve, rregullorja e organizimit dhe funksionimit dhe struktura organizative e shoqërisë.

Ndikimi/Efekti: Mos motivim i punonjësve sipas kontributit dhe vështirësisë së vendit tyre të punës.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Keq interpretim i dispozitave ligjore në fuqi që kanë të bëjnë me shpërblimin e pagës.

3. Titulli i Gjetjes: Mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

Situata: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se, mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në këtë Shoqëri, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

Kriteri: Ligji nr. 9125, datë 29.07.2003 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 9 pika 1, pika 5, gërma a.

Ndikimi/Efekti: Mos evidentim i procedurave të rekrutimeve, parregullsi në përzgjedhjen e punëmarrësve.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Mungesa e parashikimeve specifike lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Mos zbatimi i parashikimeve të bëra në deklaratat për pozicionin e lirë të punës lidhur me kriteret për disa pozicione pune.

4. Titulli i Gjetjes: Rëndim në shpenzimet e veprimtarisë nga vendimet gjyqësore me dëmshpërblim për zgjidhje të pa arsyeshme të kontratës së punësimit.

Situata: -Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 7 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **8,491,981 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Sa më sipër nga ana e përmbartuesve privatë është vepruar me urdhër sekuestro.

Kriteri: Kodi i punës, kontrata kolektive dhe kontratat individuale të punësimit, kodi i procedurës civile, kodi i procedurës administrative, rregullore e brendshme e funksionimit të Shoqërisë.

Shkaku: Ekzekutim i vendimeve gjyqësore nga shoqëria për proceset të cilat lidhen me zgjidhjen e kontratës së punësimit.

Ndikimi/Efekti: Sa më sipër **vlera 8,491,981 lekë** përbën efekt negativ financiar në buxhetin e shoqërisë.

5. Titulli i Gjetjes: Administrata e Shoqërisë ka përfituar padrejtësisht trajtim ushqimor dhe bonus për antidodë.

Situata: Për periudhën Mars 2018 deri më Mars 2020, trajtim me dietë ushqimore në **vlerën 4,648,000 lekë**, trajtim i cili referuar pikës 2, germa a, të VKM nr. 68, datë 07.02.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, duhet të ishte 300 lekë për ditë pune, ndërsa Administrata e Shoqërisë është trajtuar me 500 lekë për ditë pune. Për periudhën Prill të vitit 2020 e në vazhdim ky trajtim është konformë VKM të sipërcituar.

Nga auditimi konstatohet se punonjësit e Albgaaz SHA kanë përfituar padrejtësisht bonusin dietë antidodë **në vlerën 3,170,244 lekë**, bonus i cili referuar kontratës kolektive nr. 261, datë 19.09.2017 jepet për punonjësit që ushtrojnë detyrën në terren në kushtet e vështirësive tekniko profesionale. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë.

Shkaku: Keq interpretim i dispozitave ligjore.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën **7,818,244 lekë**.

Rëndësia: E mesme.

Kriteri: VKM nr. 68, datë 07.02.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore” dhe kontrata kolektive nr. 261, datë 19.09.2017.

6. Titulli i Gjetjes: Diferencë ndërmjet pozicionit të punës me diplomë të arsimit të lartë dhe jo të lartë, me efekt në vlerën 416,000 lekë.

Situata: Me vendim të ish-Administratorit të Shoqërisë K. G. nr. 86, datë 01.03.2017, në pozicionin e specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore është emëruar M. H. me pagë 75,000 lekë. Me vendim të Administratorit të Shoqërisë A. A. nr. 24, datë 30.01.2019, është bërë ndryshimi i pagës nga 75,000 lekë në 50,000 lekë për këtë ish-punonjëse. Ish-punonjësja në fjalë nuk disponon diplomën e arsimit të lartë, në kundërshtim me kriteret e aprovuara me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 2/1, datë 26.01.2017. Nga përlllogaritja e pagës si diferencë ndërmjet pozicionit të punës me diplomë të arsimit të lartë dhe jo të lartë, për periudhën mars 2017 deri më dhjetor 2017 rezulton një diferencë në vlerën 416,000 lekë. Vlera 416,000 lekë për Shoqërinë “Albgaz” Sh.a dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerë 416,000 lekë.

Rëndësia: E mesme.

Kriteri: Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 2/1, datë 26.01.2017 “Për caktimin e nivelit të pagave”.

Shkaku: Keq interpretim i dispozitave ligjore.

7. Titulli: Mos plotësimi i numrit mesatar të punonjësve.

Situata: -Sipas programit ekonomik për vitin **2017**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar **116 punonjës** gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i

të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar **115 punonjës**, pra **1 punonjës më pak**. Fondi i pagave është realizuar **68,790 mijë lekë**, pra **2,908 mijë lekë më pak** se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin **2018**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar **117 punonjës** gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar **115 punonjës**, pra **2 punonjës më pak**. Fondi i pagave është realizuar **79,141 mijë lekë**, pra **459 mijë lekë më pak** se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin **2019**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar **117 punonjës** gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2019 është realizuar **116 punonjës**, pra **1 punonjës më pak**. Fondi i pagave është realizuar **93,330 mijë lekë**, pra **3,103 mijë lekë më pak** se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin **2020**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar **118 punonjës** gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2020 është realizuar **113 punonjës**, pra **5 punonjës më pak**. Fondi i pagave është realizuar **90,922 mijë lekë**, pra **3,618 mijë lekë më pak** se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin **2021**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar **119 punonjës** gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2021 është realizuar **113 punonjës**, pra **6 punonjës më pak**. Fondi i pagave është realizuar **97,428 mijë lekë**, pra **2,372 mijë lekë më pak** se programi.

-Sa më sipër, konstatohet se struktura organizative e shoqërisë Albgaz SHA, është e paargumentuar, jo e mirë menduar dhe duke u bazuar në aktivitetin, të ardhurat e rezultatin financiar negativ të shoqërisë nuk justifikohet numri i punonjësve.

-Sa më sipër nga grupi i auditimit konstatohet se struktura organizative dhe fondi i pagave, çdo vit kanë progresion rritës, i cili në asnjë rast nuk realizohet dhe nuk justifikohet.

Kriteri: Përcaktimet e programeve ekonomike të viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Rëndësia: E lartë.

Ndikimi/Efekti: Mos parashikimi i saktë i nevojave të shoqërisë lidhur me numrin e punonjësve ndikon në performancën e saj.

Shkaku: Numri i punonjësve të shoqërisë nuk është parashikuar saktë, është i paargumentuar dhe çdo vit kanë progresion rritës, i cili në asnjë rast nuk realizohet dhe nuk justifikohet.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Shoqëria “Albgaz” Sh.a ka formën ligjore të shoqërisë Aksionare me ofertë private sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar. Shoqëria administrohet me dy nivele drejtimi, ajo drejtohet nga Këshilli Mbikëqyrës i emëruar nga Asambleja e Shoqërisë dhe nga Administratori. Për çdo vit bëhet parashikimi i shpenzimeve, të cilat aprovohen nga të gjithë organet drejtuese. Shpenzimet për pagat janë elementi parësor. Punonjësit e Shoqërisë “Albgaz” Sh.a janë të shpërndarë sipas dy qyteteve, të punësuarit pranë administratës në Tiranë, si dhe të punësuarit pranë administratës në Fier e cila ka në përbërje edhe punëtorët e operimit dhe mirëmbajtjes së stacioneve ekzistuese.

Struktura Organizative

Në lidhje me miratimin e fondit, nivelit të pagave dhe strukturës organizative, janë audituar vendimet e Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë Aksionare, të cilat janë të evidentuara si më poshtë:

-Me Vendimin nr. 2/1, datë 26.01.2017 të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar struktura organizative dhe përshkrimet e punës sipas aneksit nr. 1 dhe 2 të relacionit nr. 1, me numër 112 punonjës. Me Vendimin nr. 3, datë 26.01.2017 të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar plani financiar, fondi i pagave dhe kategoritë e pagave për vitin 2017. Me Vendimin nr. 11, datë 13.04.2017 të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar shtesë dhe ndryshime në strukturën organizative me numër 5 punonjës. Me shkresën nr. 1069/1 prot., datë 20.03.2017 të Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është miratuar Programi Ekonomik për vitin 2017, në të përcaktohet që: Pas shqyrtimit të programit ekonomik të paraqitur nga Shoqëria me shkresën nr. 2, datë 07.02.2017, shoqëruar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 26.01.2017 miratojmë programin ekonomik për vitin 2017.

-Për vitin 2018 me Vendimin nr. 3, datë 09.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës janë miratuar disa ndryshime në strukturën organizative. Me shkresën nr. 491/5 prot., datë 17.01.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është miratuar Programi i Zhvillimit Ekonomik për vitin 2018, ku është miratuar dhe fondi i pagave për këtë vit.

-Me Vendimin nr. 16, datë 27.11.2018 të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar programi ekonomik për vitin 2019, në të përcaktohet që: Miratimin e programit zhvillimit ekonomik 2019 për Shoqërinë “Albgaz” Sh.a. Me Vendimin nr. 16/1, datë 27.11.2018 të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar niveli i pagave për secilin pozicion pune dhe struktura organizative me numër 117 punonjës. Me Vendimin nr. 21, datë 12.11.2019 të Këshillit Mbikëqyrës janë miratuar ndryshimet në strukturën organizative. Me Vendimin nr. 95/2, datë 10.01.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë është miratuar Programi i Zhvillimit Ekonomik për vitin 2019 duke u bazuar në Vendimin nr. 16, datë 27.11.2018 të Këshillit Mbikëqyrës.

-Me Vendimin nr. 20, datë 11.11.2019 të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar struktura organizative me numër 118 punonjës, plani i investimeve dhe programi ekonomik për vitin 2020. Me Vendimin nr. 9975/1, datë 27.12.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë është miratuar Programi i Zhvillimit Ekonomik për vitin 2020 sipas Vendimit nr. 20, datë 11.11.2019 të Këshillit Mbikëqyrës.

-Me Vendimin nr. 17, datë 23.12.2020 të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar struktura organizative me numër 119 punonjës, niveli i pagave të punonjësve të shoqërisë dhe miratimin e përshkrimeve të Punës për secilin pozicion pune sipas strukturës të paraqitur.

Nga përshkrimi i situatës në lidhje me miratimin e fondit, nivelit të pagave dhe strukturës u konstatua se:

- Struktura organizative dhe niveli i pagave të Shoqërisë, nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja Aksionare (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë). Konkretisht për vitin 2017 nuk është marrë miratimi për strukturën organizative, për vitet 2018 dhe 2019 nuk është marrë miratimi për strukturën organizative dhe nivelin e pagave dhe për vitin 2020 nuk është marrë miratimi për nivelin e pagave. Organet drejtuese të Shoqërisë (Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori) e kanë quajtur të ezauruar miratimin vetëm me miratimin e programit ekonomik ku pjesë e tij është dhe fondi i pagave.

Në opinionin e grupit të auditimit ka keq interpretim nga organet drejtuese të Shoqërisë të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve”, neni 6, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“Organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50% shtetëror, miratojnë nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit*

minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga Ministri përkatës”.

Struktura aktuale e Albgaz SHA paraqitet si më poshtë:

- Administratori (1),
- Drejtor kabineti (1),
- Këshilltar (1),
- Asistente ekzekutive (1),
- Specialist i marrëdhënieve me median dhe marketingun (1),
- Drejtor Auditi (1),
- Specialist auditi (1),
- Zyrtar i përputhshmërisë (1),
- Drejtoria Tregtare (5) – Drejtor tregtar (1) – Përgjegjës i sektorit të marrëdhënieve rregullatore (1) – Specialist të sektorit të marrëdhënieve rregullatore (3),
- Drejtoria e Financës, Kontabilitetit dhe Programimit (6) – Drejtor sektorit të Financës, Kontabilitetit dhe Programimit (1) – Përgjegjës i sektorit të Financës, Kontabilitetit dhe Programimit (1) – Specialist i sektorit të Financës, Kontabilitetit dhe Programimit (3) – Magazinier (1),
- Drejtoria e Projekteve dhe Marrëveshjeve (9) – Drejtor Projektimi dhe Marrëveshjeve (1) – Përgjegjës i sektorit të Projekttimeve (1) – Specialist i sektorit të Projekttimeve (3) – Përgjegjës i sektorit të Marrëveshjeve (1) – Specialist i sektorit të Marrëveshjeve,
- Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve (7) – Drejtor Juridik dhe i Prokurimeve (1) – Përgjegjës i sektorit Juridik (1) – Përgjegjës i sektorit të Prokurimeve (1) – Specialistë të sektorit Juridik dhe atij të Prokurimeve,
- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (11) – Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse (1) – Përgjegjës i sektorit të Burimeve Njerëzore (1) – Specialist i sektorit të Burimeve Njerëzore (2) – Specialist sektori IT (1) – Mjeku i kompanisë (1) – **Sektori Operacional (4)** – Përgjegjës i Shërbimeve Operacionale (1) – Protokoll (1) – Sanitare (1) - Shofer administrate (1),
- Drejtoria Teknike (68) – Drejtor Teknik (1) – Përgjegjës Transmetim Shpërndarje (1) – Përgjegjës i Mirëmbajtjes, Sigurimit Teknik dhe Impaktit Mjedisor (1) – Specialist i Mirëmbajtjes, Sigurimit Teknik dhe Impaktit Mjedisor (1) – **Brigada e Mirëmbajtjes (5)** Përgjegjës i Brigadës të Mirëmbajtjes (1) – Punëtor (3) – Shofer (1) – Dispeçeria (4) – Përgjegjës Dispeçerie (1) – Specialist Dispeçer (3) – **Stacioni i Gazit Fier (12)** Përgjegjës Stacioni (1) – Operator (4) – Ndihmës Operator (4) – Kontrollor tubacioni (3) – **Stacioni i Gazit Ballsh (12)** Përgjegjës Stacioni (1) – Kipist (1) - Operator (4) – Ndihmës Operator (4) – Kontrollor tubacioni (2) – **Kompresorat Drenovë (10)** Kompresorist (4) – Elektriçist Kompresori (4) – Operator Pompe Uji (2) – Roje tubacione jo aktivë (22) – Roje (22).

-Marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me kontratën kolektive nr. 260 prot., datë 19.09.2017, nënshkruar në datë 09.09.2017, midis shoqërisë Albgaz SHA të përfaqësuar nga Administratori K. G. dhe Sindikatës së Re të Naftëtarëve të përfaqësuar nga Kryetari K. K., si përfaqësuese e punëmarrësve, për një periudhë 3 (tre) vjeçare. Afati i Kontratës Kolektive ka përfunduar në datën 18.09.2020, dhe kjo kontratë nuk është rinovuar.

Pasqyra nr.1: Të dhëna përmblledhëse për treguesit e punës periudha 01.07.2017 – 31.12.2021

Nr	Emërtimi	Viti 2017		Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020		Viti 2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Nr mesatar	116	115	117	115	117	116				

	punonjësve							118	113	119	113
2	Paga mesatare (000/lekë)	51,730	49,848	56,695	57,348	66,474	64,818	66,766	67,004	69,888	71,767
3	Fondi i pagave pa trajtime	71,698	68,790	79,600	79,141	93,330	90,227	94,540	90,922	99,800	97,428

Puno: Drejtoria e Financës, Kontabilitetit dhe Programimit dhe përpunoj Grupi i Auditimit

-Sipas programit ekonomik për vitin **2017**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar **116 punonjës** gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar **115 punonjës**, pra **1 punonjës më pak**. Fondi i pagave është realizuar **68,790 mijë lekë**, pra **2,908 mijë lekë më pak** se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin **2018**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar **117 punonjës** gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar **115 punonjës**, pra **2 punonjës më pak**. Fondi i pagave është realizuar **79,141 mijë lekë**, pra **459 mijë lekë më pak** se programi.

programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin **2019**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar **117 punonjës** gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2019 është realizuar **116 punonjës**, pra **1 punonjës më pak**. Fondi i pagave është realizuar **93,330 mijë lekë**, pra **3,103 mijë lekë më pak** se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin **2020**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar **118 punonjës** gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2019 është realizuar **113 punonjës**, pra **5 punonjës më pak**. Fondi i pagave është realizuar **90,922 mijë lekë**, pra **3,618 mijë lekë më pak** se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin **2021**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar **119 punonjës** gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2019 është realizuar **113 punonjës**, pra **6 punonjës më pak**. Fondi i pagave është realizuar **97,428 mijë lekë**, pra **2,372 mijë lekë më pak** se programi.

-Sa më sipër, konstatohet se struktura organizative e shoqërisë Albgaz SHA, është e paargumentuar, jo e mirë menduar dhe duke u bazuar në aktivitetin, të ardhurat e rezultatin financiar negativ të shoqërisë nuk justifikohet numri i punonjësve.

-Sa më sipër nga grupi i auditimit konstatohet se struktura organizative dhe fondi i pagave, çdo vit kanë progresion rritës, i cili në asnjë rast nuk realizohet dhe nuk justifikohet.

- Pagat janë të grupuar në katër nivele për secilin pozicion pune, konkretisht niveli i I, II, III dhe IV dhe secili nivel ka një limit përcaktuar. Brenda limitit të çdo niveli, përcaktohet paga e secilit punonjës me vendim të Administratorit. Për pozicionet punëtori deri në specialist të lartë ka një rregullore udhëzim etj., ku mirë përcaktohen kriteret e caktimit të pagës. Për pozicionet Përgjegjës Sektori, Shef Sektori, Asistent Ekzekutiv, Këshilltar, Drejtor Drejtorie, përcaktimi dhe rritja e pagës është lënë kompetencë të Administratorit.

- Për periudhën objekt auditimi u konstatua se, mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të

punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklarimeve për vende të lira pune në këtë Shoqëri, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar neni 9 pika 1, pika 5 germa a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen dhe diskriminimin. 5. Në kuptimin e këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me: a) mundësinë për punësim, vetëpunësimi dhe profesion, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, të çfarëdo lloj dege aktiviteti dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, si dhe ngritjen në detyrë”*.

Në opinionin e grupit të auditimit organet drejtuese duhet të kishin bërë parashikime të detajuara statutore dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

Pasqyra nr. 3 Të dhëna përmblledhëse për detyrimet nga marrëdhëniet e punës periudha 01.07.2017 –31.12.2021

000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Fondi i pagave me trajtime gjithësej	82,340	95,757	104,989	103,067	107,614
2	Detyrimi për tatimin mbi të ardhurat personale	6,153	7,487	8,859	8,574	9,302
3	Gjoha të paguara për pagesë të vonuar	-	-	-	16	-
4	Interesa të paguar për pagesë të vonuar	-	-	-	-	-
5	Kontributi I sigurimeve shoqërore dhe shendetesore	10,481	11,983	13,523	13,681	14,964
6	Gjoha të paguara për pagesë të vonuar	-	-	-	40	-
7	Interesa të paguar për pagesë të vonuar	-	-	-	-	-

Burimi: Drejtoria e Financës, Përpunoi grupi i auditimit

- Për periudhën objekt auditimi u konstatua se, mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklarimeve për vende të lira pune në këtë Shoqëri, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar neni 9 pika 1, pika 5 germa a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen dhe diskriminimin. 5. Në kuptimin e këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me: a) mundësinë për punësim, vetëpunësimi dhe profesion, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, të çfarëdo lloj dege aktiviteti dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, si dhe ngritjen në detyrë”*.

Në opinionin e grupit të auditimit organet drejtuese duhet të kishin bërë parashikime të detajuara statutore dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

Nga auditimi me zgjedhje i 50 dosjeve të personelit për periudhën objekt auditimi dhe para kësaj periudhe ose për punonjësit që janë larguar nga puna rezulton se, dokumentacioni në përgjithësi është i plotë. Pjesë përbërëse e dosjes janë kartat e identitetit, certifikatat familjare, dëftesa/diplomat e studimeve të kryera (fotokopje të noterizuara), listë notash, vërtetimet shëndetësore dokumente shtesë për grada e tituj shkencorë, për kurset e trajnimit, gjuhët e huaja, dëshmi penaliteti etj.

Respektimi i dispozitave liqjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.

- Administrata e Shoqërisë ka përfituar padrejtësisht për periudhën mars viti 2018-mars 2020 trajtim ushqimor në vlerën 4,648,000 lekë, trajtim i cili referuar VKM nr. 68, datë 07.02.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, duhet të ishte 300 lekë për ditë pune, ndërsa nga Shoqëria është trajtuar me 500 lekë për ditë pune. Për periudhën prill 2020 e në vazhdim ky trajtim është konformë vendimit të sipërcituar. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë. ***Vlera 4,648,000 lekë për Shoqërisë “Albgaz” Sh.a dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.***

- Administrata e Shoqërisë ka përfituar padrejtësisht bonusin dietë antidodë në vlerën 3,170,244 lekë për periudhë tetor 2017- dhjetor 2021, bonus i cili referuar kontratës kolektive nr. 261, datë 19.09.2017 jepet për punonjësit që ushtrojnë detyrën në terren në kushtet e vështirësive tekniko profesionale. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë. ***Vlera 3,170,244 lekë për Shoqërisë “Albgaz” Sh.a dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.***

Pasqyra nr. 3 Të dhëna përmblledhëse për përdorimin e fondit të veçantë për periudha 01.07.2017 – 31.12.2021 000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Fondi i veçantë	-	-	-	-	-
2	Shpërblime për rezultate në punë	-	-	-	-	-
3	Shpërblime për fund viti	-	-	-	-	-
4	Shpërblime sëmundje	-	-	-	50	40
5	Për largime nga puna	-	2,595	4,349	1,195	354
6	Për raste fatkeqësie/lindje	-	10	-	-	-
7	Për dalje në pension	-	32	-	-	-

Burimi: Drejtoria e Financës, Përpunoi grupi i auditimit

-Me Vendimin nr. 2/1, datë 26.01.2017 të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar struktura organizative dhe përshkrimet e punës sipas aneksit nr. 1 dhe 2 të relacionit nr. 1, ku është konstatuar se:

Nga auditimi i strukturave organizative në lidhje me përshkrimet e punës është konstatuar se nuk është përcaktuar lloji i arsimit që kërkohet për çdo pozicion pune si dhe janë përcaktuar kriteret bazë për çdo pozicion pune, gjë e cila është reflektuar në vijimësi duke caktuar llojin dhe nivelin e arsimit për çdo pozicion pune.

Shoqëria “Albgaz” Sh.a për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të saj bazohet tek përshkrimet e punës të cilat miratohen për çdo vitin nga Këshilli Mbikëqyrës. Në lidhje me

përshkrimet e punës për vitin 2017 janë hasur këto problematika të cilat janë trajtuar si më poshtë:

Sektori i Burimet Njerëzore duhet ndjek prokurimet publike, funksion dhe detyrë e cila duhet të kryhet nga Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 20, pika c.

Sektori i Burimeve Njerëzore ngarkohen në lidhje me menaxhimin e listëprezencave dhe përgatis listëpagesat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për stafin “Albgaz” Sh.a, merret me llogaritjen e pagave dietat dhe shërbimet si dhe kujdeset për politikën e pagave, kryen kontabilizimin e pagave të stafit dhe ja përcjell Drejtorisë së Financës, drejton kostot direkte dhe indirekte të personelit, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 69 dhe 70.

Sektori IT dhe shërbimeve operacionale me administrimin dhe dokumentimin e lëvizjes së vlerave materiale dhe harton dokumentacionin përkatës. Kryen kontroll të vazhdueshëm për mirëmbajtjen dhe harxhimin e karburantit të mjeteve evidenton lëvizjen e mallrave në kartelet e magazinës dhe me dokumente si fatura. Fletëhyrje fletëdalje, si dhe bën rakordin e tyre me kartela e llogarisë, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 40.

Gjithashtu duke u bazuar në Vendimin nr. 1, datë 26.01.2017 të Këshillit Mbikëqyrës “Për aprovimin e strukturës dhe të përshkrimet e punës në Shoqërinë “Albgaz””, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse ngarkohet për menaxhimin e praktikave të kërkesave të sektorëve, hartimin ndjekjen e planeve të shpërndarjes nga magazina, mbledh kërkesat për nevoja të ndryshme, detajon konsumin e karburantit etj., veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Vendimin nr. 1, datë 26.01.2017 të Këshillit Mbikëqyrës.

Theksojmë se, në lidhje me problematikat e trajtuara mbi përcaktimin e detyrave për Sektorin e Burimeve Njerëzore, Sektorin e IT si dhe Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse të miratuara në Përshkrimet e Punës me Vendimin nr. 2/1, datë 26.01.2017 të Këshillit Mbikëqyrës, janë kryer reflektimet duke u bazuar në dispozitat ligjore përkatëse, sipas ndryshimeve të cilat kanë pësuar Përshkrimet e Punës miratuar me vendimet respektive të Këshillit Mbikëqyrës, për këto pozicione pune.

- Me shkresën nr. 3 prot., datë 01.03.2017 dhe Vendimin e Administratorit të Shoqërisë K. G. nr. 86, datë 01.03.2017 është emëruar në pozicionin e specialiste, në varësi të sektorit të Burimeve Njerëzore, M. H. me pagën 75,000 lekë sipas kontratë kolektive nr. 3, datë 01.03.2017.

- Me shkresën nr. 35/1 prot., date 30, 01.2019 dhe Vendimin e Administratorit të Shoqërisë A. A. nr. 24, datë 30.01.2019, i bëhet ndryshimi i pagës M. H. me pozicion pune specilaiste e Burimeve Njerëzore ne varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse nga 75,000 lekë në 50,000 lekë.

Sipas Vendimit nr. 2/1, datë 26.01.2017 të Këshillit Mbikëqyrës është aprovuar struktura organizative dhe përshkrimet e punës për shoqërinë Albgaz Sh.a”, të Këshillit Mbikëqyrës sipas Aneksit nr. 1, të relacionit nr. 1, si dhe aprovimi I përshkrimit të punës sipas Aneksit nr. 2, të relacionit nr. 1.

Bashkëngjitur strukturës organizative janë miratuar dhe kriteret për nivelin e arsimit për çdo pozicion pune.

Punonjësi në fjalë nuk disponon arsimin e lartë përkatës, jo sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

Diferenca:

Për vitin 2017, 10 muaj * 18,950 lekë=189,500 lekë

Për vitin 2018, 12 muaj * 189,500 lekë = 227,500 lekë.

Totali 416,000 lekë

Vlera 416,000 lekë për Shoqërisë “Albgaz” Sh.a dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Proceset Gjyqësore për Ndërprerjen e paligjshme të marrëdhënie të punës

-Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 7 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **8,491,981 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Sa më sipër nga ana e përmbartuesve privatë është vepruar me urdhër sekuestro.

Nga grupi i auditimit kjo vlerë konsiderohet si efekt financiar negativ.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligji nr. 9125, datë 29.07.2003 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Ligji nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar.

Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 07.02.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”.

Kontratës Kolektive nr. 261, datë 19.09.2017

2.3 Auditim mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko-financiar të shoqërisë, si dhe ndjekja e realizimit të këtyre treguesve.

Sipas dokumentacioni të vënë në dispozicion rezultoi se:

Titulli i gjetjes: Programet ekonomiko-financiar (buxhetet vjetor) janë hartuar dhe realizuar në pamjaftueshmëri financiare, pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar në fakt plotësisht me buxhet, si dhe respektuar afatet për dërgimin dhe miratimin e programit ekonomik nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Asamblesë (pronarit).

Situata: Programet ekonomiko-financiar (buxhetet vjetor) janë hartuar dhe realizuar në pamjaftueshmëri financiare, pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar në fakt plotësisht me buxhet, konkretisht është programuar me humbje për periudhën e auditimit. Në mënyrë të detajuar: Për vitin 2017 nga të ardhurat janë realizuar në vlerën 19,557 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 114,037 mijë lekë, për vitin 2018 të ardhurat janë realizuar në vlerën 11,961 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 145,032 mijë lekë, për vitin 2019 të ardhurat janë realizuar në vlerën 9,811 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 335,714 mijë lekë, për vitin 2020 të ardhurat janë realizuar në vlerën 145,044 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 170,209 mijë lekë, për vitin 2021 të ardhurat janë realizuar në vlerën 162,588 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 194,710 mijë lekë.

-Për vitin 2017, nuk janë respektuar afatet për dërgimin dhe miratimin e programit ekonomik nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë Asamblesë (pronarit). Kjo situatë ka ndodhur për shkak se Shoqëria e ka filluar ushtrimin e aktivitetit të saj më datë 05.01.2017.

- Për vitin 2018, nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit Mbikëqyrës, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, kapitulli III, pika 2.

- Për vitin 2019 është konstatuar se nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit Mbikëqyrës, me nr. 21/3 prot., datë 27.11.2018, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, kapitulli III, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, “Drejtoritë e shoqërive, ku shteti ka mbi 50% të aksioneve, hartojnë projekt programet dhe dërgojnë kopje të tyre, me relacionet shpjeguese pranë Këshillit Mbikëqyrës, brenda datës 1 nëntor të çdo viti”.

- Për vitin 2020 është konstatuar se nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit Mbikëqyrës, me nr. 100/1 prot., datë 05.11.2019, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, kapitulli III, pika 2.

-Për vitin 2021 janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit Mbikëqyrës, me nr. 95/6 prot., datë 02.11.2020, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, kapitulli III, pika 2.

Kriteri: Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, kapitulli III, pika 2.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e efijencës në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për Shoqërinë “Albgaz” Sh.a Tiranë.

Shkaku: Kjo është situatë e cila ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit siç duhet nga organet drejtuese.

Rëndësia: E mesme.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Në hartimin dhe zbatimin e programit ekonomik, përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, dhe Statuti i shoqërisë.

Projekt programet ekonomike janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit duke u bazuar në kërkesat e çdo drejtorie, si dhe janë dërguar për miratim Këshillit Mbikëqyrës sipas relacioneve përkatëse.

Konkretisht:

-Për vitin 2017 programi ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 26.01.2017, i konfirmuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 1069/1 prot., datë 20.03.2017.

-Për vitin 2018 programi ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 27, datë 27.12.2017, i konfirmuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 491/5 prot., datë 17.01.2018.

- Për vitin 2019 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 16, datë 27.11.2018, i konfirmuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 95/2 prot., datë 10.01.2018.

- Për vitin 2020 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 11.11.2019, i konfirmuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 9975 prot., datë 27.12.2019.

- Për vitin 2021 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.18, datë 23.12.2020, i konfirmuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr.215/2 prot., datë 31.12.2020.

Gjatë zbatimit të programit ekonomik për vitet 2017 dhe 2019, ndryshimet e ndodhura janë bërë me vendim të organeve drejtuese, konkretisht riallokimi i vitit 2017, është miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.16, datë 11.01.2017, si dhe riallokimi i vitit 2019 është miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 7, datë 15.07.2019.

Përsa më sipër është konstatuar se, për vitin 2017 Shoqëria nuk disponon dokumentacion mbi hartimin e projekt programit ekonomik, si dhe *nuk janë respektuar afatet për dërgimin dhe miratimin e programit ekonomik nga Asambleja Aksionare*. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se Shoqëria e ka filluar ushtrimin e aktivitetit të saj më datë 05.01.2017.

Për vitin 2018 është konstatuar se, *nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit Mbikëqyrës*, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, kapitulli III, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, “Drejtoritë e shoqërive, ku shteti ka mbi 50% të aksioneve, hartojnë projekt programet dhe dërgojnë kopje të tyre, me relacionet shpjeguese pranë Këshillit Mbikëqyrës, brenda datës 1 nëntor të çdo viti”.

- Për vitin 2019 është konstatuar se *nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit Mbikëqyrës*, me nr. 21/3 prot., datë 27.11.2018, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, kapitulli III, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, “Drejtoritë e shoqërive, ku shteti ka mbi 50% të aksioneve, hartojnë projekt programet dhe dërgojnë kopje të tyre, me relacionet shpjeguese pranë Këshillit Mbikëqyrës, brenda datës 1 nëntor të çdo viti”.

-Për vitin 2020 është konstatuar se *nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit Mbikëqyrës*, me nr. 100/1 prot., datë 05.11.2019, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, kapitulli III, pika 2.

-Për vitin 2021 *janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit Mbikëqyrës*, me nr. 95/6 prot., datë 02.11.2020, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, kapitulli III, pika 2.

Mbi planifikimin dhe realizimin e zërave të ardhurave dhe shpenzimeve është konstatuar se:

- Për vitin 2017, në zërin “Të ardhurat” janë planifikuar në shumën 132,870,000 lekë dhe realizuar në shumën 19,557,000 ose në masën 15%.

Në zërin “Shpenzimet” janë planifikuar në shumën 132,317,000 lekë dhe realizuar në shumën 114,037,000 lekë ose në masën 86%.

- Për vitin 2018, në zërin “Të ardhurat” janë planifikuar në shumën 246,540,000 lekë dhe realizuar në shumën 11,961,000 lekë ose në masën 5%.

Në zërin “Shpenzimet” janë planifikuar në shumën 185,984,000 lekë dhe realizuar në shumën 145,032,000 lekë ose në masën 78 %.

- Për vitin 2019, në zërin “Të ardhurat” janë planifikuar në shumën 11,629,000 lekë dhe realizuar në shumën 9,879,000 lekë ose në masën 85%.

Në zërin “Shpenzimet” janë planifikuar në shumën 239,748,000 lekë dhe realizuar në shumën 335,714,000 lekë ose në masën 140%.

Në lidhje me shpenzimet kemi një *tejkalim në shumën 95,966,000 lekë* kjo situatë ka ndodhur për shkak se, është shtuar zëri i “Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale” i pa parashikuar, në zbatim të vendimit të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës nr. 2138, datë 18.02.2019 është kryer rivlerësimi i AAM mbi bazën e kontratës nr. 38/3 prot., datë 03.06.2019 me ekspertin vlerësues me vlerë 161,811,000 lekë.

- Për vitin 2020, në zërin “Të ardhurat” janë planifikuar në shumën 131,082,000 lekë dhe realizuar në shumën 145,044,000 lekë ose në masën 111%.

Në zërin “Shpenzimet” janë planifikuar në shumën 278,075,000 lekë dhe realizuar në shumën 170,209,000 lekë ose në masën 61%.

Në lidhje me të ardhurat kemi një *tejkalim në shumën 13,962,000 lekë*, kjo situatë ka ndodhur për shkak se, zëri “Të ardhura nga Divident” i parashikuar në vlerën 50,346,000 lekë dhe i realizuar në vlerën 120,086,000 lekë.

- Për vitin 2021, në zërin “Të ardhurat” janë planifikuar në shumën 156,382,000 lekë dhe realizuar në shumën 162,588 lekë ose në masën 104%.

Në zërin “Shpenzimet” janë planifikuar në shumën 199,446,000 lekë dhe realizuar në shumën 194,710,000 lekë ose në masën 98%.

Në lidhje me të ardhurat kemi një *tejkalim në shumën 6,206,000 lekë* kjo situatë ka ndodhur për shkak se, është zëri “Të ardhura nga Divident” i parashikuar në vlerën 50,000,000 lekë dhe i realizuar në vlerën 122,648,000 lekë.

Mbi planifikimin dhe realizimin e programit ekonomik për vitet 2017 deri 2021 është konstatuar se:

Mbi të gjitha programet ekonomiko-financiar (buxhetet vjetor) janë hartuar në pamjaftueshmëri financiare, pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar me buxhet, konkretisht është me humbje për çdo vit, respektivisht:

- Për vitin 2017, Shoqëria ka pasur humbje në shumën 94,459,828 lekë.

- Për vitin 2018, Shoqëria ka pasur humbje në shumën 133,071,313 lekë.

- Për vitin 2019, Shoqëria ka pasur humbje në shumën 325,836,505 lekë.

- Për vitin 2020, Shoqëria ka pasur humbje në shumën 25,165,020 lekë.

- Për vitin 2021, Shoqëria ka pasur humbje në shumën 32,122,570 lekë.

Shoqëria “Albgaz” Sh.a në shpenzimet e veprimtarisë operacionale të saj rëndohet padrejtësisht nga vënia në punë dhe mirëmbajta e stacioneve të kompresorëve B2S Drenovë.

Stacioni i kompresorëve B2S Drenovë është ndërtuar që në vitin 1983, është aset i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a. Ky stacion shfrytëzon energjinë elektrike dhe reaktive për të mbajtur kompresorët dhe stacionet e gazit në punë, e cila faturohet nga “A.” Sh.a, Q.. Ndërkohë, energjia

elektrike dhe reaktive e konsumuar, nuk shfrytëzohet e gjitha vetëm për procesin e transmetimit apo dhe shpërndarjes së gazit natyror. Energjia e konsumuar shfrytëzohet edhe për:

- Grumbullimin e gazit të asociuar (shoqëruar) të naftës që nxirret nga vendburimi pranë stacionit të kompresorëve në Drenovë.

- Diferencimin e naftë-gaz i asociuar, i cili do të që i pamundur të realizohej në mungesë të presionit vakumetrik të kompresorëve.

Në mungesë të kompresorëve, gazi i asociuar që gjendet në vendburimet e naftës do e kishte të pamundur të kontrollohej, rrjedhimisht, do të çlirohej në ajër duke rrezikuar jetën e punonjësve të naftës, të banorëve në ato rrethina si dhe mjedisit në tërësi, kjo pasi gazi është me përmbajtje të lartë të hidrokarbureve me element toksikë. Gjithashtu puna e kompresorëve është e domosdoshme pasi gazi i asociuar përdoret si energji e shtuar në procesin e nxjerrjes së naftës, si dhe procesin e trajtimit fiziko-kimik të saj, përgatitjen në standard teknik për shitje të naftës që nxirret nga QPN Ballsh dhe QPN.

Pra sa trajtuar si më sipër dëshmon se energjia elektrike dhe reaktive që përdoret nga kompresorët shfrytëzohet si nga “Albgaz” Sh.a dhe nga “A.” Sha, por faturimi është i njëanshëm. Kompresorët kryejnë shërbime të cilat janë të domosdoshme si për transmetimin e gazit natyror, por edhe për industrinë e nxjerrjes së naftës dhe gazit, të cilat nuk janë në objektin e veprimtarisë së Shoqërisë “Albgaz” Sh.a.

Mbajtja e stacionit të kompresorëve B2S Drenovë në punë ka kosto operacionale të lartë (shpenzime për vajra, riparime të defekteve, shpenzime paga fuqie punëtore, energjinë elektrike dhe reaktive etj. Shtuar dhe faktin që kompresorët si gjithë sistemi janë tepër të vjetër dhe punojnë nën 10 % të kapacitetit të projektuar, sepse sasia e gazit që prodhohet është shumë e ulët, bënë që kostua e shfrytëzimit të tyre të jetë në vlera tepër të larta.

Për pos shpenzimeve të tjera, edhe pse është aset i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, faturimi i energjisë elektrike dhe reaktive i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a kryhet nga Shoqëria “A.” Sh.a, bile jo nga kjo shoqëri, por nga (Q.). Pra matësi i energjisë është i kësaj të fundit (Aseti është i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, matësi është i Shoqërisë “Q.”), dhe me çmim 17.4 lek/kwh për energji elektrike dhe 1.65 lek për kwh energji reaktive që i përket çmimit të liberalizuar të konsumatorëve të tregut të lidhur me tensionin e lartë dhe të mesëm.

Për shpenzimet e energjisë elektrike dhe reaktive (jo për shpenzimet e tjera), Shoqëria “Albgaz” Sh.a i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 120 prot., datë 22.10.2018 për rivlerësimin e këtij shpenzimi, për një shpërndarje sa më të drejtë mes dy shoqërive.

Për vitet 2017-2019 shpenzimet për elektrike dhe reaktive, lubrifikant, shpenzime avarie, paga etj., kapin **vlerën 23,365,578 lekë** (Energji elektrike dhe reaktive = 22,477,013 lekë, lubrifikantë= 740,565 lekë, avarie = 148,000 lekë, paga= 11,387,733=23,365,578). Shpenzime të cilat janë përballuar vetëm nga Shoqëria “Albgaz” Sh.a.

Konkluzion: Programet ekonomiko-financiar (buxhetet vjetor) janë hartuar dhe realizuar në pamjaftueshmëri financiare, pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar në fakt plotësisht me buxhet, si dhe respektuar afatet për dërgimin dhe miratimin e programit ekonomik nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë Asamblesë (pronarit).

2.4 Organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese. Analiza e debitorëve,

kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.

Në zbatim të pikës nr. 4, të programit të auditimit Nr. 9/1, Datë 17.01.2022, “ Mbajtja e evidencës kontabël në qendër dhe në njësitë vartëse, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Dokumentacioni i pasqyrave financiare për periudhat ushtrimore 2017-2020.

Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.

Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.

Dokumentacioni i mbajtur mbi përlllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale.

Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me rregullat dhe parimet e ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Standardet Kombëtare të Raportimit Financiar (SKK), të aprovuara dhe të shpallura për zbatim nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK). Ato janë përgatitur në përputhje me standardin kombëtar të kontabilitetit nr. 2, veprimet e kryera dokumentohen dhe regjistrohen në librat e kontabilitetit në përputhje me parimet e SKK-ve. Regjistrat janë të mbajtur në gjuhën shqipe dhe vlerat në njësinë monetare Shqiptare në lekë. Veprimet në valutë janë konvertuar në lekë sipas standardit kontabël përkatës. Pasqyrat financiare (bilanci) janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike, duke kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimi i të drejtave të konstatuara. Regjistrimet kontabël janë të pajisur me evidencë mbështetëse që sigurojnë besueshmërinë e tyre. U konstatua se regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e llogarisë kontabël, bëhet duke u bazuar në dokumentacionin përkatës kontabël.

Titulli i gjetjes: Bilanci i shoqërisë nuk është hartuar dhe miratuar sipas afateve ligjore.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se; Nga Shoqëria AlbgaZ ShA nuk janë marrë masat e duhura për miratimin e bilancit kontabël, së bashku me anekset e tij, brenda një afati 6-mujor të mbylljes së periudhës ushtrimore. Pasqyrat financiare janë aprovuar me vendimin nr. 7718/1, datë 09.07.2018, nga ortaku i vetëm i shoqërisë MIE, për humbjen në vlerën 94,459,826 lekë.

-Aprovimi është kryer jashtë afatit të caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1 ku citohet: “*Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit 1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinojnë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi*”.

Për veprimet e mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi administratorët dhe Këshilli Mbikëqyrës.

Titulli i gjetjes: Mos depozitimi i pasqyrave financiare në afat në organet tatimore.

-Depozitimi në sistemin tatimor është kryer jashtë afatit ligjor, që është datë 31 mars e periudhës së mëpasshme.

-Aprovimi është kryer jashtë afatit të caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1.

-Më datë 31.01.20119, me numrin e çështjes CN-085852-01-19, nga shoqëria është kryer depozitimi i pasqyrave financiare të periudhës 2017, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në regjistrin e shoqërive tregtare. Ky depozitim është kryer jashtë afateve ligjore në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, neni 43, Regjistrimet e tjera të detyrueshme dhe neni 46 ku citohet :

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 29, Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit ku citohet: “ 1. Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1 ku citohet: “Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit 1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi”.

Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, neni 43, Regjistrimet e tjera të detyrueshme dhe neni 46 ku citohet : “....3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:a) pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme; Neni 46, Regjistrimi i pasqyrave financiare, 1. Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në çdo rast t’i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar.”

Titulli i Gjetjes: Parregullsi në paraqitjen e pasqyrave financiare

Situata: -Nga departamenti i financës, regjistrimet e veprimeve kontabël, janë kryer në programin Excel dhe jo me “Bartës informatik”, të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë, gjë e cila ndikon në pasaktësi gjatë procesit të regjistrimit të dokumenteve financiarë, si dhe gabime gjatë kuadrimin të veprimeve kontabël. Mungesa e programit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në

ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabile dhe të pasqyrave financiare.

-Gjendja e trojeve ka problematika të ndryshme si diferenca të sipërfaqes në certifikatë me gjendjen kontabël, të pronësisë, si dhe nuk disponohen certifikata të trojeve për pjesën e transmetimit të gazit.

-Në kartelat e pasurisë “Godina e Stacionit Cërrik” ka diferencë në regjistrimin e sipërfaqeve të truallit me përkatësisht 340 m² më shumë në regjistrat kontabël (ndërsa, Çertifikata e pronësisë rezulton me 1,360m²) dhe “Salla e pompave të ujit Selishtë”, e cila ka të regjistruar në kontabilitet një sipërfaqe totale të truallit me 10,000 m² dhe në Çertifikatë pronësie ka të regjistruar 4,290 m², pra një diferencë e konsiderueshme prej 5,710 m².

-Procesi i marrjes në dorëzim i aktiveve afatgjata materiale në shoqërinë Albgaz SHA, nga shoqëria dhuruese Albpetrol SHA, nuk është kryer sipas Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 42,43, 55,56,57.

-Zëri i AAJM, për periudhën 31.12.2017 Aktivet afatgjata jomateriale, License programe dhe transmetimi është grant dhe i klasifikuar si AAJM afatgjatë. Ky zë përbëhet nga pajisje kompiuterike të dhëna si grant nga TAP dhe licensa 1 vjecare për programin Office 365 Bussines Premium, në vlerën 1,056,850 lekë. Këto licensa nuk janë të lidhura me pajisjet kompiuterike dhe meqënëse skadonin brenda një periudhe 1 vjecare duhet kontabilizoheshin tek shpenzimet e periudhës, për vlerën 4 mujore, prej 352,283 lekë që i takonte vitit 2017, dhe pjesa tjetër 704,567 lekë si shpenzim i periudhës 2018. Ky veprim ka dhënë efekte dhe zërin e të ardhurave nga grantet.

-Në vlerën e të ardhurave rimarrje grantesh, nuk është llogaritur pjesa përkatëse e vitit 2017 e licensave të Office 365 që skadonin në vitin 2018, dhe jo duke e amortizuar si një Aktiv Afatgjatë.

-Administratori dhe drejtoria ekonomike kanë përdorur norma amortizimi për aktivet afatgjata materiale, për periudhën 2017, të pa miratuara nga këshilli mbikëqyrës.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, normat për llogaritjen e shpenzimeve të amortizimit të aktiveve afatgjata materiale janë të pa vlerësuara dhe aprovuara nga këshilli mbikëqyrës.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin Nr.9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, ku citohet: 1 *Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Neni 5, 9, “Mbajtja e kontabilitetit”, citojnë: “Të gjitha njësitë ekonomike e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit mbi bazën e parimeve dhe të metodave, që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit; “Respektimi i standardeve kontabël”,1. Pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parasë së njësisë ekonomike. Pasqyrat financiare përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël.”*

2.*Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 1 – Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrve financiare - i përmirësuar, pika 103. Zbatimi i vlerësimeve kontabël citon: “Disa të dhëna financiare, të paraqitura në pasqyrat financiare, bazohen në vlerësime të bëra nga drejtuesit e njësisë ekonomike, dhe jo në fakte të vëzhguara në mënyrë objektive. Shembuj të zbatimit të vlerësimeve kontabël janë: (b) vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, si dhe përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit;*

3.(c) krijimi i provizioneve për shitjet me garanci ose për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces.”

4. Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr.5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, pika 39 citon se “Çdo njësi ekonomike cakton metodat e amortizimit dhe normat e amortizimit në politikat dhe procedurat e saj kontabël, të cilat duhet të përdoren për amortizimin e aktiveve afatgjata materiale.” “.. citohet: “Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit 1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi” ”

Ndikimi: Veprimet sa më sipër kanë sjellë mos vlerësim të drejtë të situatës së aktiveve të shoqërisë. Mosmbajtja e kontabilitetit me “Bartës informatik”, sjellë risk për mos marrje në kohë të informacionit, duke u reflektuar në vendimmarrjen e drejtimit të shoqërisë.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që në të ardhmen për pajisjen me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit.

Titulli i Gjetjes: Parregullësi në deklaratimet e blerjeve në sistemin tatimor.

Situata: -Deklarime shpenzimesh të njohura fiskale në kundërshtim me Udhëzimin Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar.

Në librin e blerjeve dhjetor 2017, u konstatuan deklaratime të faturave të OSHEE dhe UKT, të cilat ishin faturuar për subjektin e Ministrisë së Ekonomisë. Këto fatura ishin deklaruar për vlera pjesore si dhe në kolonën e blerjeve me Tvsh jo të zbritshme.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me Udhëzimin Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohet: “3.5. Shpenzimet e njohura, Shpenzime të njohura janë ato që kryhen për qëllime të biznesit, që synojnë sigurimin dhe ruajtjen e të ardhurave. Shpenzimet e njohura janë shpenzime që njihen si të zbritshme nga të ardhurat për përcaktimin e fitimit të tatueshëm. Për të qene të njohura (të zbritshme) shpenzimet duhet të përmbushin këto kushte:

a. të jenë kryer në interes të drejtpërdrejtë të veprimtarisë ekonomike prej së cilës realizohen të ardhurat ose të jenë të lidhura me drejtimin normal të aktivitetit të tatimpaguesit;

b. të jenë kryer ose të jenë përballuar efektivisht dhe të jenë të mbështetur në dokumente justifikuese të njohura ligjërisht;

c. të jenë pasqyruar nëpërmjet një veprimi kontabël duke pakësuar aktivet neto; d. në çdo rast shpenzimet duhet të jenë të provuara nga tatimpaguesit me dokumentacionin përkatës ligjor. Dokumente të përdorura si bazë për justifikimin e shpenzimit, për efekt tatimor, është fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore, faturat e lëshuara nga persona jo-rezidentë që nuk janë të regjistruar në organet tatimore shqiptare dhe çdo dokument tjetër i lëshuar nga ente ose organizma juridike,...

Ndikimi: Mos deklarimi i saktë i blerjeve sjell risk për penalitete për mos zbatim të legjislacionit tatimor si dhe deformon rezultatin financiar.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që në të ardhmen nga sektori i financës deklarimet e blerjeve të kryehen me saktësi dhe në kohën e përcaktuar.

Titulli i Gjetjes: Mosplotësimi i regjistrimit të aktiveve të shoqërisë

Situata: -Shoqëria nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjistër, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30 ku përcaktohet: *“Formati i regjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia ..”*

Ndikimi: Mos plotësimi i saktë i regjistrimit sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Drejtimi i shoqërisë duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrimit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë.

Titulli i Gjetjes: Mos marrja e masave për uljen e kapitalit të regjistruar të shoqërisë

Situata: Shoqëria në pasqyrat e vitit 2017 ka një humbje në vlerën 94,459,828 lekë e mbledhur me humbjen e vitit 2018 në vlerën 133,071,313 lekë dhe e redukton kapitalin e shoqërisë në vlerën 169,606,330 lekë. ***Humbjet e shoqërisë kanë kaluar në më shumë se 50 % të kapitalit të regjistruar.***

Për periudhat 2019-2020 shoqëria ka paraqitur pasqyrat financiare të konsoliduara të cilat nuk e japin të qartë fenomenin, por problematika kryesore e daljes me humbje është në vazhdimësi.

Nga organet drejtuese të shoqërisë nuk janë marrë masat për vlerësimin e situatës, propozimet për zgjidhje dhe njoftimi i ortakut, veprim në kundërshtim me nenin Neni 136 “Mbledhja e asamblesë së përgjithshme”, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, pika 3 si dhe pika k e nenit 20.2 të statutit të shoqërisë

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me nenin Neni 136 “Mbledhja e asamblesë së përgjithshme”, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, pika 3 si dhe pika k e nenit 20.2 të statutit të shoqërisë, ku përcaktohet: *”3. Asambleja e përgjithshme duhet të thirrret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim. .”*

Ndikimi: Mos marrja e masave për rritjen e kapitalit mund të sjellë në një situatë falimentimi për shoqërinë.

2.5 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.

Nga dokumentacioni i vënë dispozicion u konstatua se nuk ka dhënien e me qira të aktiveve afatgjata materiale. Ndërsa është marrë me qira vetëm ambienti i zyrave të administratës Tiranë. Në këtë procedurë nuk u konsatuan shkelje ose mangësi ligjore.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Me shkresën nr. 38/4 prot., datë 18.05.2018 të nxjerrë nga titullari i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a A. A. është kryer ftesa për ofertë, së bashku me dokumentacionin përkatës, ku cakton dhe planimetrinë e zyrave të cilat i nevojiten shoqërisë “Albgaz” Sh.a për ushtrimin e aktivitetit të saj. Është ngritur grupi i punës dhe nga grupi i punës është paraqitur relacioni nr. 38/10 prot., datë 08.06.2018, ku janë paraqitur 3 oferta nga operatorë ekonomik. Grupi i punës i caktuar me urdhër nga titullari i shoqërisë ka bërë vëzhgimin nga afër të operatorëve të paraqitura+ në ofertë. Nga 3 operator ekonomik që kanë paraqitur ofertat e tyre, është kualifikuar operatori ekonomik “N.” shpk, pasi ka paraqitur ofertën më të ulët ekonomike. Është përzgjedhur operatori ekonomik “N.” shpk me ofertën ekonomike më të ulët. Shoqëria “Albgaz” Sh.a ambientin e marrë me qira në qytetin e Tiranës me një sipërfaqe 500m² me ofertë 1560 lekë/m² nga kompania “N.” shpk me vendndodhje në rrugën e Kosovarëve, njësia administrative nr. 5, e ka në përdorim për selinë/zyrat e administratës së Shoqërisë “Albgaz” Sh.a. Pas shpalljes fitues të operatorit ekonomik, është lidhur kontrata me operatorin ekonomik “N.” shpk me nr. 38/11 prot., datë 02.07.2018. Qiraja mujore e dakortësuar midis “Albgaz” Sh.a dhe Shoqërisë “N.” shpk, është e pa ndryshuar në vlerën 780,000 lekë për të gjithë periudhën sipas kontratës të sipërpërmendur. Nga dokumentacioni i vënë dispozicion u konstatua se është marrë me qira vetëm ambienti i zyrave të administratës Tiranë për një periudhë 1 (një) vjeçare. Me memon Nr. Prot 71 e datës 14.06.2019 drejtuar administratorit të shoqërisë z.A. A. nga z. E. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe e Prokurimeve, si dhe z. D. M. me detyrë shef i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve, i është kërkuar nevoja për rinovimin e kontratës së qirasë së sipërpërmendur si dhe nevoja për ambiente shtesë, me arsyen se sipërfaqja aktuale nuk është e mjaftueshme për stafin e kompanisë për kryerjen e punës me efikasitet dhe përgjegjsi. Duhet cilësuar se përveç 500m² të përcaktuara në objektin e kontratës janë shfrytëzuar edhe 42.7m² si magazinë e domosdoshme për shoqërinë por e papërfshirë në objektin e kontratës së lidhur.

Nëpërmjet Urdhrit të Brendshëm Nr. 32 I datës 09.07.2019 me Nr.Prot. 71/1 Administratori urdhëron ngritjen e grupit të punës për sigurimin e ambjenteve të reja për selinë qendrore të kompanisë dhe kryerjen e procedurave mbi rinovimin e kontratës së qerasë.

Në datën 24.07.2019 me kërkesën me Nr.Prot 71/3 z.. E. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve i drejtohet z. I. S. me detyrë administrator i Shoqërisë N. sh.p.k me lëndë nevojën për negociim për sipërfaqe shtesë dhe cmimin e referuarne lidhje me Rinovimin e Kontratës së Qirasë Nr. 1188 Rep dhe Nr. 353 Kol datë 02.07.2018.

Me proces-verbalin me Nr.Prot 71/4 e datës 24/07/2019 gjatë negociimit u ra dakord se është i mundur plotësimi i kërkesës për zgjerimin e sipërfaqes aktuale 542,7 m². Sipërfaqja shtesë e mundësuar nga qiradhënësi është 85.2 m².

Si pasojë sipërfaqja totale e Albgaz sh.a shkon në 627,9m² me cmimin fillestar të pandryshueshëm 1.560 lek/m².

Më datë 23.08.2019 lidhet kontrata e qerasë vjetore për periudhën 01/07/2019 – 30/06/2020 me nr.rep 2107 dhe nr.Kol 606 për zyrat e Albgaz sh.a me sipërfaqen e re 627m² me vlerë qera mujore 979.524 lek. Qera vjetore 11.754.288 lek.

M² qendron i pandryshueshëm në vlerën e 1.560 lekëve.

Më datë 23.04.2020 bëhet shtesë në kontratën e qerasë me Nr.rep 748 dhe Nr.Kol 224 me objekt “Marrja me qera e ambjenti tregtare për zyra dhe 8 vendparkimeve” si pjesë e kontratës bazë Nr.Rep 1145 I datës 15.04.2019 (e cila ende nuk është paraqitur nga ana e personit përgjegjës). Më datë 06.08.2020 Me Nr.rep 1440 dhe Nr.kol 464 lidhet kontrata e qirasë për periudhën 01/07/2020 – 30/06/2021 të zyrave të Albgaz sh.a për sipërfaqen e 627.9 m² me vlerën e qerasë mujore 979.524 lek.

Qeraja mujore është e pandryshuar për të gjithë periudhën, sipas kontratës së lidhur e të sipërpërmendur.

2.6 Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjeve me vlera te vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj.,).

1. Titulli i Gjetjes: Kontrata për shërbimin e telefonisë, jo në përputhje me ligjet dhe VKM përkatëse.

Situata: Më datë 22.05.2017, administratori i shoqërisë K. G., i përfaqësuar nga A. Gj. me autorizimin e posaçëm me nr. 154 prot., datë 22.05.2017, ka lidhur kontratën me shoqërinë V. Sh.a, për përfitimin e shërbimit të sistemit të telefonisë. Kohëzgjatja e kontratës është 24 muaj dhe vlera totale e shpenzimit që shoqëria “Albgaz” Sh.a detyrohet ti paguajë shoqërisë Vodafone është 3,585,600 lekë brenda afatit të kontratës, për një numër 88 përdoruesish, me një vlerë shpenzimi fiks mujor prej 149,400 lekë. Në Vendimin të Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 13.04.2017, janë përcaktuar kuotat dhe pozicionet e punës të cilat përfitojnë mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare, si administratori dhe drejtorët e drejtorive, ndërsa punonjësit e tjerë nuk janë përfitues. Dhënia e garancisë ndaj shoqërisë V. për mbulimin e shpenzimeve për të gjithë numrat e kontraktuar përfshirë dhe pozicionet e tjera jo të aprovuara në vendimin e KM, ekspozon shoqërinë për efekte të mundshme ekonomike negative.

- Në librat e blerjeve të deklaruar në sistemin tatimor, në periudhën 2017-2018-2019, vlera e deklaruar e blerjeve të shërbimit të telefonisë janë në shumat e rimbursuara prej shoqërisë për personat e autorizuar dhe jo në vlerën totale të faturës së lëshuar nga V., një veprim i kryer për të justifikuar si shpenzim të zbritshëm për deklaratimet tatimore vetëm vlerat e rimbursuara. Por një stornim i tillë ka sjellë të mos zbatohet Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, por që nuk ka ndikuar në rezultatin e shoqërisë.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, si dhe VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik”, i ndryshuar, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “*Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*” dhe neni 4, “Fusha e zbatimit”, VKM nr. 864 ...13. Drejtuesit e ndërmarrjes/shoqërisë tregtare me kapital 100 për qind shtetëror, që funksionojnë sipas ligjeve specifike përkatëse, kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular **të personave zyrtarë**, bazuar në detyrën që kryejnë dhe në varësi të mundësive financiare që kanë, të miratuar nga organet përkatëse, sipas specifikimeve të mësipërme. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, të jenë në çdo

rast, jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve administrative, të miratuara në planin financiar përkatës. "

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, seksioni III, mbajtja e kontabilitetit, neni 57, Udhëzimin, nr. 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 42, neni 115, si dhe Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat ", i ndryshuar, pika 3.5, shpenzimet e njohura ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *Neni 57, "Seksioni III Mbajtja e kontabilitetit për qëllime tatimore Neni 57 Dokumentimi dhe mbajtja e llogarive për qëllime tatimore 1. Tatimpaguesi mban kontabilitetin, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe me aktet e nxjerra në zbatim të tij. 2. Për regjistrimin e veprimeve ekonomike, që lidhen me tatimet dhe taksat, përdoren edhe librat, regjistrat apo dokumentacioni i përcaktuar në ligjet tatimore specifike dhe në dispozitat përkatëse nënligjore. 3. Tatimpaguesit janë të detyruar të përdorin dokumentacionin bazë, përfshirë faturën tatimore, në përputhje me legjislacionin tatimor dhe dispozitat nënligjore përkatëse."*

Neni 46.2 "Tatimpaguesi, subjekt i TVSH-së, regjistron të gjitha transaksionet dhe veprimet financiare dhe përgatit e mban libra e regjistra kontabël, ku, pa u kufizuar vetëm në to, regjistrohen:....; ç) **pagesat për mallra dhe shërbime, përfshi shumën e secilës blerje apo pagesë, shumën e tatimit të paguar dhe emrin e adresën e furnizuesit; d) arkëtimet dhe pagesat.**"

Neni 115. "Plotësimi i pasakte i deklaratës tatimore dhe kërkesa e pasakte për rimbursim 115.1.2. **Një deklaratë tatimore, përfshirë deklarin e tepricës kreditore, quhet e pasaktë kur nuk është e plotësuar me të dhënat reale financiare të subjektit.** Deklarata tatimore do të quhet e saktë kur detyrimi tatimor ose teprica kreditore është llogaritur në mënyrë korrekte dhe për të cilën nuk është bërë asnjë gabim aritmetik ose logjik. Nëse pasaktësia është bërë me dashje, gjë që mund të arsyetohet dhe provohet bazuar në dokumentacionin, faktet dhe rrethanat konkrete, konsiderohet evazion."

3.5. "Shpenzimet e njohura janë ato që kryhen për qëllime të biznesit, që synojnë sigurimin dhe ruajtjen e të ardhurave. Shpenzimet e njohura janë shpenzime që njihen si të zbritshme nga të ardhurat për përcaktimin e fitimit të tatueshëm. Për të qenë të njohura (të zbritshme) shpenzimet duhet të përmbushin këto kushte: a. të jenë kryer në interes të drejtpërdrejtë të veprimtarisë ekonomike prej së cilës realizohen të ardhurat ose të jenë të lidhura me drejtimin normal të aktivitetit të tatimpaguesit; b. të jenë kryer ose të jenë përballuar efektivisht dhe të jenë të mbështetur në dokumente justifikuese të njohura ligjorisht; c. **të jenë pasqyruar nëpërmjet një veprimi kontabël duke pakësuar aktivet neto;** d. në çdo rast shpenzimet duhet të jenë të provuara nga tatimpaguesit me dokumentacionin përkatës ligjor. Dokumente të përdorura si bazë për justifikimin e shpenzimit, për efekt tatimor, është fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore, faturat e lëshuara nga persona jo-rezidentë që nuk janë të regjistruar në organet tatimore shqiptare dhe çdo dokument tjetër i lëshuar nga ente ose organizma juridike."

Ndikimi/Efekti: Rëndim i shpenzimeve të shoqërisë.

Shkak: Keq interpretim i dispozitave ligjore.

Rëndësia: E mesme

2. Titulli i Gjetjes: Copëzim i fondit limit në procedurat për blerjen e karburantit.

Situata: Për vitin 2017 janë kryer 3 procedura prokurimi me objekt "Blerje karburanti Diezel D1 dhe Benzinë" me vlerë totale 1,150,000 lekë pa TVSH. Nga auditimi i këtyre procedurave

konstatohet se Autoriteti Kontraktor për vitin 2017 ka copëzuar fondin limit, në kundërshtim me nenin 28 pika 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e efikasitetit në përdorimin e këtyre fondeve.

Kriteri: Neni 40, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“Pika 8, Në asnjë rast, procedura e prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shërbimet nga procedurat konkurruese të prokurimit.”*

Ndikimi: Mos respektim i parimeve të konkurrencës me efekt negativ të drejtpërdrejtë në fondet publike.

Shkaku: Keq interpretim i dispozitave ligjore dhe nënligjore të procedurave të prokurimit publik

Rëndësia: E mesme.

3. Titulli i Gjetjes: Shpenzime udhëtim e dieta për jashtë shtetit të kryera pa dokumentacion të plot justifikues.

Situata: Nga auditimi i shpenzimeve të kryera nga punonjësit që janë dërguar jashtë shtetit, u konstatua se në 3 raste në vitin 2017, në 11 raste në vitin 2018 dhe në 8 raste në vitin 2019 janë paguar 22 fatura në vlerën 1,725,587 lekë, për akomodim në hotele jashtë vendit. Këto fatura janë lëshuar nga agjenci turistike pa u shoqëruar me faturën e hotelit të përdorur nga punonjësit e shoqërisë duke mos vërtetuar prezencën e tyre në hotelet përkatëse.

-Nga drejtori i drejtorisë juridike E. K., në shkresat nr. 96/1 datë 04.11.2019, nr. 41 prot., datë 25.03.2019, dërguar titullarit, i relatohet se janë iniciuar procedura të marrjeve të ofertave më të lira për të njëjtin hotel nga operatorë të ndryshëm ekonomik, të cilët nuk kanë pasur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me hotelet e përcaktuara.

Vlera 1,725,587 lekë përbën shpenzime jo të justifikuara si dhe për Shoqërinë Albgaz Sh.a dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

Kriteri: VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit , i ndryshuar, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “9... Në shpenzimet e fjetjes përfshihet fatura e hotelit të përzgjedhur, si rregull, në mënyrë të diferencuar, ... ”

Ndikimi: Shpenzime udhëtim e dieta për jashtë shtetit të kryera pa dokumentacion të plot justifikues.

Shkaku: Keq interpretim i dispozitave ligjore dhe nënligjore në zbatimin e disiplinës financiare.

Rëndësia: E mesme.

4. Titulli i Gjetjes: Vendosje e specifikimeve teknike me vlera specifike të caktuara.

Situata: Në procedurën e iniciuar me kërkesën e Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëveshjeve me nr. 237 prot., datë 05.09.2017, me objekt “Blerje pajisje GPS për nevoja të Albgaz Sh.a”, u konstatua se parametrat teknik të kërkuar janë me vlera specifike dhe jo me kufij të limituar. Përcaktimi me vlera të pandryshuara të madhësisë së ekranit, pesha, rezolucioni, kohë zgjatja e baterisë ka sjellë paracaktimin e fituesit të procedurës.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 23, pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara*

nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;"

Ndikimi: Vendosja e specifikime teknike të fiksuara dhe parapërcaktimi i fituesit të procedurës së prokurimit ul konkurrencën e pjesëmarrjes dhe ekonomicitetin e saj.

Shkaku: Keq interpretim i dispozitave ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik.

Rëndësia: E mesme.

5. Titulli i Gjetjes: Keq administrimin i shpenzimeve në kryerjen e shërbimeve publike.

Situata: Në zbatim të kontratës nr. 253/2, datë 15.09.2017, me objekt marrje mjeti me qira tip Pick-Up, 4x4, nga Drejtoria e Financë & Kontabilitetit, është likuiduar fatura nr. 6175, e datës 19.09.2017, me vlerën 327,360 lekë me TVSH. Në kontratë përcaktohet se kohëzgjatja e shërbimit është nga data 18.09.2017- 31.10.2017, dhe se çmimi për të paguar është 6200 lekë/ditë.

Komisioni i blerjeve me vlera të vogla, në hartimin e ftesës për ofertë ka llogaritur si ditë shërbimi ditët e shtuna dhe ditët e diela, duke e përcaktuar periudhën e shërbimit nga 18.09.2017 - 31.10.2017. Përcaktimi në ftesën për ofertë, nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, i të gjithë periudhës për 45 ditë në total, pa pasur një plan pune të saktë, në mënyrë që të kufizohej përdorimi vetëm në ditët efektive të punës, si dhe me përfshirjen e ditëve të shtuna dhe të diela, është bërë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me ndryshimet vijuese të tij, neni 2. Vendosja e kushtit në kontratë për pagesën e menjëhershme të vlerës pa përfunduar kontrata është kryer në kundërshtim me nenin 2 të sipërcituar si dhe me pikën c), të nenit 13, si dhe nenit 61 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", me ndryshimet vijuese të tij.

-Grupi i auditimit referuar gjetjes së Auditit të Brendshëm të shoqërisë, (mbështetur në Ligjin nr. 154 "Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të shtetit", neni 16, pika 2 dhe ISSAI 1610), konstatoi se mjeti është përdorur vetëm në tre raste në afatin kohor të kërkuar 18.09.2017- 31.10.2017, datë 21.09, datë 03.10 dhe 11.10. Vlera për një ditë është 6200 lekë x 3 ditë=18,600 lekë, është vlerë e qirasë së ditëve që mjeti është përdorur. Vlera 308,760 lekë përbën efekt ekonomik financiar negativ për shoqërinë AlbgaZ SHA, e cila është krijuar nga mos përdorimi i mjetit. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 2, nenin 13, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me ndryshimet vijuese të tij, nenin 61 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", me ndryshimet vijuese të tij.

Kriteri: Neni 2, neni 13, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me ndryshimet vijuese të tij, neni 61 i Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", me ndryshimet vijuese të tij, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: "Neni 2, ku citohet: "Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë." pikën c), të nenit 13,që një ndër rastet kur kundërshtohet urdhri i nëpunësit autorizues nga nëpunësi autorizues është dhe rasti ku citohet:" urdhri për pagesën përfundimtare jepet pa u përfunduar shërbimi, pa hyrjen e vlerave materiale në njësi ose marrjen në dorëzim nga njësia e investimit të përfunduar",

“...Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë të detyruara të procedojnë me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimeve menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit/marrjes në dorëzim të aktiveve në përputhje me kushtet e kontratës. Për moszbatimin e këtij detyrimi zbatohen sanksionet ligjore të përcaktuara në kontratën e lidhur në mes palëve ose në marrëveshjet përkatëse dypalëshe për të cilat mban përgjegjësi Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i njësisë respektive”.

Ndikimi: Keq administrimin i shpenzimeve në kryerjen e shërbimeve publike .

Rëndësia: E mesme.

Shkaku: Keq interpretim i dispozitave ligjore dhe nënligjore në zbatimin e disiplinës financiare.

6. Titulli i Gjetjes: Keq administrim i kryerjes së shpenzimeve të karburantit për vitin 2017.

Situata: Shpenzimet për konsum karburanti janë administruar nga A. S. me detyrë përgjegjëse i sektorit të shërbimeve mbështetëse dhe operacionale në cilësinë e personit të autorizuar nga A. Gj. me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Operacionale. Ky administrim ka paraqitur risk të lartë shpërdorimi, pasi përcaktimi i normave të konsumit të karburantit, ndjekja, monitorimi, verifikimin dhe marrja në dorëzim e formularëve të plotësuar mbi lëvizjet e kryera të punonjësve, dhe deklarimet e shpenzimeve të karburantit, janë kryer nga i njëjti person. Për pos sa më sipër u konstatua se mungonin kërkesat për karburant nga përdoruesit, fletët e udhëtimit të aprovuara nga administratori/eprori përkatës, dhe kuponat tatimorë përkatës për karburantin e konsumuar. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij.

Kriteri: Neni 22, Veprimtaritë e kontrollit, pika 1, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“Titullarët e njësive të sektorit publik miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. 3. Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrisë të Financave . ”*

Ndikimi: Keq administrim i shpenzimeve operacionale.

Shkaku: Keq interpretim i dispozitave ligjore dhe nënligjore në zbatimin e disiplinës financiare.

Rëndësia: E mesme.

“Mirëmbajtje dhe riparim fotokopje, printera dhe pajisje IT”

-Me shkresën nr.53 prot, datë 01.06.2021, lidhur me procedurën “Mirëmbajtje dhe riparim fotokopje, printera dhe pajisje IT” nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, i përbërë nga: D. M., E. O. dhe S. K., është përlllogaritur fondi limit me masën 350,000 lekë pa tvsh.

-Me shkresën nr.53/1 prot, datë 01.06.2021 është ngarkuar komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, për kryerjen e procedurave të prokurimit lidhur me “Mirëmbajtje dhe riparim fotokopje, printera dhe pajisje IT”.

-Me shkresën nr.53/2 prot, datë 01.06.2021 nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël është hartuar ftesa për ofertë dhe specifikimet teknike lidhur me këtë procedurë.

-Me shkresën nr.53/4 prot, datë 01.06.2021 është hartuar urdhëri për ngritur komisionin mbi verifikimin e sasisë dhe cilësisë së mallrave dhe shërbimeve, i përbërë nga: D. M., G. L. dhe A. B.

-Me shkresën nr.47/4 prot, datë 07.06.2021 është hartuar urdhëri për ngritur komisionin mbi verifikimin e sasisë dhe cilësisë së mallrave dhe shërbimeve, lidhur me disa procedura, ndër të cilat dhe procedura “Mirëmbajtje dhe riparim fotokopje, printera dhe pajisje IT”, i përbërë nga: D. M., G. L. dhe A. B.

-Në datën 07.06.2021 nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, është mbajtur procesverbali i tërheqjes nga gara i operatorit ekonomik “P.”, pasi është shpallur fituese, për arsye të gabimit nga ana e tyre të përlogaritjes të kostos.

Komisioni ka vendosur shpalljen fituese të operatorit ekonomik të renditur në vend të dytë “O.”.

-Në datën 08.06.2021 nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, është mbajtur procesverbali i tërheqjes nga gara i operatorit ekonomik “O.”, pasi është shpallur fituese, për arsye të gabimit nga ana e tyre të përlogaritjes të kostos.

Komisioni ka vendosur shpalljen fituese të operatorit ekonomik të renditur në vend të tretë “A.”.

-Në datën 09.06.2021 nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, është mbajtur procesverbali i tërheqjes nga gara i operatorit ekonomik “A.”, pasi është shpallur fituese, për arsye të mos sigurimit total të sasisë të mallit në kohë.

Komisioni ka vendosur shpalljen fituese të operatorit ekonomik të renditur në vend të katërt “R.”.

-Në datën 10.06.2021 nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, është mbajtur procesverbali i tërheqjes nga gara i operatorit ekonomik “R.”, pasi është shpallur fituese, për arsye të gabimit nga ana e tyre të përlogaritjes të kostos.

Komisioni ka vendosur shpalljen fituese të operatorit ekonomik të renditur në vend të pestë “A.”.

-Në datën 10.06.2021 nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, është mbajtur procesverbali i tërheqjes nga gara i operatorit ekonomik “A.”, pasi është shpallur fituese, për arsye kohe.

Komisioni ka vendosur shpalljen fituese të operatorit ekonomik të renditur në vend të gjashtë “C.”, me vlerën 259,200 lekë me TVSH.

-Me Akt – Dorëzimin pa datë në qershor 2021 nga operatori ekonomik “C.”, procesverbalin e verifikimit në datën 14.06.2021, dhe me shkresën nr.53/3 prot, datë 4.0.2021 “Proces verbal përcjellës”, janë marrë në dorëzim mallrat nga komisioni i verifikimit, i përbërë nga: A. B., D. M. dhe G. L.

“Blerje kancelari dhe letër format”

-Me shkresën nr.54 prot, datë 01.06.2021, lidhur me procedurën “Blerje kancelari dhe letër format” nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, i përbërë nga: D. M., E. O. dhe S. K., është përlogaritur fondi limit me masën 400,000 lekë pa tvsh.

-Me shkresën nr.54/1 prot, datë 01.06.2021 është ngarkuar komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, për kryejën e procedurave të prokurimit lidhur me “Blerje kancelari dhe letër format”.

-Me shkresën nr.54/2 prot, datë 01.06.2021 nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël është hartuar ftesa për ofertë dhe specifikimet teknike lidhur me këtë procedurë.

-Me shkresën nr.47/4 prot, datë 07.06.2021 është hartuar urdhëri për ngritur komisionin mbi verifikimin e sasisë dhe cilësisë së mallrave dhe shërbimeve, lidhur me disa procedura, ndër të cilat dhe procedura “Mirëmbajtje dhe riparim fotokopje, printera dhe pajisje IT”, i përbërë nga: D. M., G. L. dhe A. B.

-Në datën 07.06.2021 nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, është mbajtur procesverbali i tërheqjes nga gara i operatorit ekonomik “E.”, me vlerën 166,667 lekë pa TVSH, pasi është shpallur fituese, për arsye të mos paraqitjes.

Komisioni ka vendosur shpalljen fituese të operatorit ekonomik të renditur në vend të dytë “I.”, me vlerën 177,000 lekë pa TVSH.

-Në datën 08.06.2021 nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, është mbajtur procesverbali i tërheqjes nga gara i operatorit ekonomik “I.”, pasi është shpallur fituese, për arsye të mos paraqitjes.

Komisioni ka vendosur shpalljen fituese të operatorit ekonomik të renditur në vend të tretë “Europrinty Group”, me vlerë 183,000 lekë pa TVSH.

-Në datën 09.06.2021 nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, është mbajtur procesverbali i tërheqjes nga gara i operatorit ekonomik “E.”, pasi është shpallur fituese, për arsye të mos paraqitjes.

Komisioni ka vendosur shpalljen fituese të operatorit ekonomik të renditur në vend të katërt “L.”, me vlerën 197,777 lekë pa TVSH.

-Me procesverbalin e verifikimit në datën 11.06.2021 janë marrë në dorëzim mallrat nga komisioni i verifikimit, i përbërë nga: A. B., D. M. dhe G. L.

“Rinovim i licensave Office 365”

-Me shkresën nr.100/1 prot, datë 26.11.2021, lidhur me procedurën “Rinovim i licensave Office 365” nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, i përbërë nga: D. M., E. O., A. B. dhe S. K., është përllogaritur fondi limit me masën 655,249 lekë pa tvsh.

-Me shkresën nr.100/2 prot, datë 26.11.2021 është ngarkuar komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, për kryejn e procedurave të prokurimit lidhur me “Rinovim i licensave Office 365”.

-Me shkresën nr.100/3 prot, datë 26.11.2021 nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël është hartuar “Procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit”.

-Me shkresë nr.100/4 prot, datë 26.11.2021 nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël është hartuar “Ftesa për ofertë” dhe specifikimet teknike.

-Në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë:

1.I. me vlerën 500,324 lekë pa TVSH,

2.O. me vlerën 600,000 lekë pa TVSH,

3.I. – I me vlerën 649,000 lekë pa TVSH.

Është shpallur fitues operatori ekonomik I. me vlerën më të vogël 500,324 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr.100/5 prot, datë 23.12.2021 “Për pagesën e Operatorit Ekonomik I. SHPK, me NIPT J61820021C”, është kryer procedura e pagesës të tij me vlerë 600,388.8 lekë me TVSH.

“Blerje materiale për mbrojtjen personale dhe kryerjen e shërbimeve të dezinfektimit të nevojshëm për përballimin e situatës të krijuar nga epidemia COVID – 19, si dhe blerje detergjentësh dhe pajisje për pastrim të zyrave”

-Me shkresën nr.74 prot, datë 17.07.2021, lidhur me procedurën “Blerje materiale për mbrojtjen personale dhe kryerjen e shërbimeve të dezinfektimit të nevojshëm për përballimin e situatës të krijuar nga epidemia COVID – 19, si dhe blerje detergjentësh dhe pajisje për pastrim të zyrave” nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, i përbërë nga: D. M., E. O. dhe S. K., është përllogaritur fondi limit me masën 798,192 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr.74/1 prot, datë 17.07.2021 është ngarkuar komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, për kryejën e procedurave të prokurimit lidhur me “Blerje materiale për mbrojtjen personale dhe kryerjen e shërbimeve të dezinfektimit të nevojshëm për përballimin e situatës të krijuar nga epidemia COVID – 19, si dhe blerje detergjentësh dhe pajisje për pastrim të zyrave”.

-Me shkresë nr.74/2 prot, datë 14.07.2021 nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël janë hartuar “Ftesa për ofertë” dhe specifikimet teknike.

-Me shkresën nr.74/3 prot, datë 14.07.2021 nga komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël është hartuar “Procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit”.

-Në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë:

- Operatori ekonomik “A.” me vlerë 555,000 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “J.” me vlerë 783,333 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “P.” me vlerë 734,000 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “B.” me vlerë 779,900 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “B.” me vlerë 56,800 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “D.” me vlerë 511,000 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “E.” me vlerë 599,000 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “I.” me vlerë 779,000 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “M.” me vlerë 409,900 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “M.” me vlerë 764,000 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “M.” me vlerë 449,000 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “M.” me vlerë 640,000 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “O.” me vlerë 789,800 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “O.” me vlerë 750,000 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “P.” me vlerë 736,000 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “P.” me vlerë 778,000 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “XH.” me vlerë 442,000 lekë pa TVSH.

Është shpallur fitues operatori ekonomik E. me vlerën 599,000 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr.74/5 prot, datë 03.09.2021 nga komisioni i verifikimit të sasisë dhe cilësisë mallrave, i përbërë nga: A. B., D. M. dhe G. L., është hartuar “Procesverbal nr.1”, i verifikimit të sasisë dhe cilësisë mallrave, lidhur me këtë procedurë.

-Me shkresën nr.74/6 prot, datë 03.09.2021 nga komisioni i verifikimit të sasisë dhe cilësisë mallrave, i përbërë nga: A. B., D. M. dhe G. L., është hartuar “Procesverbal nr.2”, i konfirmimit të kryerjes të dezinfektimit të ambjenteve të brendshme me sipërfaqe 628 metër katror, lidhur me këtë procedurë.

-Me shkresën nr.74/7 prot, datë 04.11.2021 “Për pagesën e subjektit E. SHPK, me NIPT L71715003C”, është kryer procedura e pagesës të tij me vlerë 718,800 lekë me TVSH.

2.7 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në procedurat e prokurimeve, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, si dhe efektiviteti i investimeve.

Në zbatim të pikës nr.7, të programit të auditimit Nr. 9/1, Datë 17.01.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Dokumentacioni i dosjes së prokurimit.

Dokumente të tjera.

Titulli i Gjetjes: Në një rast investimi është kryer pa leje ndërtim.

Situata: Në një rast investimi është kryer pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 39, pika 1 dhe 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 11, pika a, neni 13, pika c. Leja e ndërtimit për objektin është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 8, datë 28.02.2020, pasi është ndërtuar objekti, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi A. C. me detyrë drejtor i drejtorisë së marrëveshjeve dhe projekteve dhe E. P. me detyrë shef i sektorit të projekteve.

- Në një rast në preventivin paraprak dhe atë të ndryshuar nuk është përcaktuar fond rezervë, si dhe ndryshimet në preventiv nuk janë shoqëruar me ndryshimet në projekt. Pra projekti është i pa ndryshuar.

Kriteri: Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 39, pika 1 dhe 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 11, pika a,b,c,ç.

Shkaku: Mos zbatim i dispozitave ligjore.

Ndikimi/Efekti: Keq administrim të territorit.

Rëndësia: E mesme.

Titulli i Gjetjes: Lidhje kontrate shtesë me nr. 101/16 prot., datë 18.12.2019, kontratës bazë nr. 3/17 prot., datë 18.03.2019 për ndërtimin e dy magazinave me konstruksion metalik dhe rikonstruksionin e zyrave Fier, viti 2019, pa pasur fond disponibël.

Situata: Kontrata për ndërtimin e dy magazinave me konstruksion metalik dhe rikonstruksionin e zyrave Fier, është lidhur me nr. 3/17 prot., datë 18.03.2019 ndërmjet Shoqërisë “Albgaz” Sh.a. të përfaqësuar nga A. A. në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë dhe operatorit/e shoqërisë “A.” shpk në vlerën 55,109,096 lekë pa TVSh. Për realizimin e këtij objekti është bërë shtesë kontrate me nr. 101/16 prot., datë 18.12.2019 në vlerën 11.016.811,60 lekë pa TVSH.

Kjo shtesë kontrate deri më datë 19.06.2020 që përfundoj auditimi nuk është likuiduar për mungesë të fondeve.

Për rrjedhoj kjo shtesë kontrate nuk duhet të ishte lidhur, pasi lidhja e kësaj kontrate është në kundërshtim me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe e Verifikimit), nr. 9941 prot., datë 08.11.2018, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi, E. K. me detyrë drejtor i drejtorisë juridike dhe prokurimeve.

Shkaku: Mos zbatim i udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe e Verifikimit), nr. 9941 prot., datë 08.11.2018.

Kriteri: Shkresat e Agjencisë së Prokurimit Publik ((Drejtoria Juridike dhe e Verifikimit) nr. 9941 prot., datë 08.11.2018.

Titulli i Gjetjes: Procedurë prokurimi me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Situata: Procedura e prokurimit, negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për objektin e prokurimit “Ndërtim magazina dhe rikonstruksion i zyrave në Fier”, me fond limit 11.016.812 lekë, e parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2019, nuk është në kushtet e rrethanave të veçanta (kushte specifike) të pa parashikuara nga

dispozitat ligjore, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 33, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar neni 36, çka ngarkon me përgjegjësi drejtorinë e drejtorisë juridike dhe prokurimeve.

Shkaku: Mos zbatim nga drejtoria juridike dhe prokurimeve i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014.

Kriteri: VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, me ndryshimet vijuese të tij.

Rëndësia: E mesme.

Ndikimi/Efekti: Përzgjedhjen e operatoreve, në kundërshtim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.

Titulli i Gjetjes: Procedura e prokurimit “Ndërtim magazina dhe rikonstruksion i zyrave në Fier, është kryer jo plotësisht konformë dispozitave ligjore.

Situata: Për procedurën e prokurimit “Ndërtim magazina dhe rikonstruksion i zyrave në Fier”, për vlerën 60,529 mijë lekë, në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit, nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

- Për procedurën e prokurimit “Ndërtim magazina dhe rikonstruksion i zyrave në Fier”, për vlerën 60,529 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 63 pika 3, neni 67, Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

- Në 1 rast për vlerën 325 mijë lekë është anuluar procedura e prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 73, pika 2. Në opinionin e grupit të auditimit, arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

Shkaku: Keq interpretime të akteve ligjore dhe nënligjore të procedurave të prokurimit publik.

Ndikimi/Efekti. Nuk ka efekt.

Rëndësia: E mesme.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Ligji 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Tenderi me objekt: “ Ndërtim dhe rikonstruksion i zyrave Fier” 2018,

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim dhe rikonstruksion i zyrave Fier ”REF- 99578-12-17-2018		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 25 Prot., datë 25.10.2018 1. O. S. -Drejtor i drejtorisë së financës, kontabilitetit dhe programimit 2. E. S. – specialiste e sektorit të projekteve dhe	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:- Komisioni i Posaçëm: Urdhër Nr. 24,	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Nr Prot., datë

studimeve 3. I. I. -specialiste e sektorit të projekteve dhe studimeve	Prot. 125, dat; 19.11.2019 1. D. M. përgjegjës i sektorit të prokurimeve 2. E. P. përgjegjës i sektorit të projekteve dhe studimeve 3. E. A. -(Specialist sektori juridik dhe i prokuriveve,	1.A. C. 2.E. Z. 3.A. L.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 60,529,111 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 55,109,096 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 5,420,015 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 17.01.2019	9.Burimi Financimit Fondet e institucionit	10.Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Nr. 10 b) S'kualifikuar 8 (2 OE Pa oferte ekonomike) c) Kualifikuar 3 ç) Shpallur Fitues 1: A. shpk
11.Ankimime AK-ka bërë pastaj e ka tërhequr OE L APP-ka/Rekomandime KPP-s'ka/	12. PërgjigjeAnkesës	13.Përgjigje Oe ankimues ankese apo KKP nr. prot, date _____, date __.__.20__

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Fondi i këtij i këtij investimi është akorduar nga Shoqëria T., në zbatim të kontratës të lidhur me Shoqërinë “Albgaz” Sh.a datë 18.09.2017 në vlerën 616,800 euro me destinacion ndërtim magazinave dhe rikonstruksion i zyrave Fier, të cilat do ti shërbejnë edhe shoqërisë T., në zbatim të marrëveshjes që ka lidhur me Shtetin Shqiptar. Transaksioni për kalimin e këtij fondi është kryer nëpërmjet Bankës R. Bankë më datë 04.12.2017 në vlerë 616,800 euro, për llogari të Shoqërisë “Albgaz” Sh.a.

Investimi është kryer pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 39, pika 1 dhe 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 11, pika a, neni 13, pika c. Leja e ndërtimit për objektin është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 8, datë 28.02.2020, pasi është ndërtuar objekti, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi A. C. me detyrë drejtor i drejtorisë së marrëveshjeve dhe projekteve dhe E. P. me detyrë shëf i sektorit të projekteve.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Shoqërisë “Albgaz” Sh.a për vitin 2018. Projekti dhe specifikimet teknike janë bazuar në dokumentacionin me nr. 56/1 prot., datë 07.05.2018 dhe 56/2 prot., datë 02.07.2018, dorëzuar nga shoqëria “Gj.”, sipas kontratës së lidhur me nr. 323/18 prot., datë 04.04.2018, si dhe në materialin e grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit të ngritur me urdhër nr. 52 datë 25.10.2018 me nr. 120/1 prot..

Preventivi i projektit teknik është në vlerën 90,891,343 lekë me TVSH. Me urdhër nr. 52 datë 25.10.2018 të Administratorit të Shoqërisë është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit për ndërtimin e magazinave dhe rikonstruksionin e zyrave Fier, i përbërë nga O. S., me

detyrë drejtor i drejtorisë së financës dhe projekteve, E. S., me detyrë specialiste e sektorit të projekteve dhe studimeve dhe I. I. me detyrë specialiste e sektorit të projekteve dhe studimeve.

Me procesverbal të datë 30.10.2018 nga preventivi i projektit janë hequr vlera 18,256,410 lekë ($15,213,675 \times 1.2$ (TVSH) = 18,256,410). Kjo vlerë ka të bëjë me Vinç urë 5,200,000 lekë, sistemi i sinjalizimit të zjarrit në vlerën 135,000 lekë, Gjenerator dizel 400/230V 100 KV/*0KW në vlerën 3,000,000 lekë, UPS 3 f, 10 KVA 910 min) + USB/R232 në vlerën 800,000 lekë, Securiti System (Pajisjet), msi dhe kabina elektrike Tip Box në vlerën 3,770,463 lekë.

Me memon nr. 120/1 prot., datë 30.10.2018 i përbërë nga O. S., E. S., dhe I. I., kanë informuar Administratorin e Shoqërisë për procesverbalin e llogaritjes së vlerës, duke lënë si vlerë përfundimtare të përlogaritjes së kontratës 60,529,111 lekë pa TVSH.

Për zbritjen e këtyre vlerave, me shkresën nr. 133 prot, datë 03.12.2018 nga Administrator i Shoqërisë, i është kërkuar shoqërisë projektuese “Gj.” shpk, rishikimi i vlerës 10,013,675 lekë. Me shkresën nr. 758 prot., datë 04.12.2018 shoqëria projektuese “Gj.” shpk, ka rishikuar vlerën 10,013,675 lekë dhe ka dërguar preventivin e ndryshuar duke lënë si vlerë përfundimtare ndërtimin e dy magazinave në vlerën 28,336,295 lekë +5,667,259 lekë (TVSH) = 34,003,554 lekë dhe rikonstrukcionin e godinës të zyrave 2 kate të Albgaz Fier në vlerën 24,095,812 + 4,819,162 (TVSH) = 28,914,975 lekë.

Me urdhër të administratorit nr. 24 datë 19.11.2018 është ngritur njësia e prokurimit e përbërë: D. M. me profesion jurist, me detyrë shëf i sektorit juridik dhe prokurimeve, E. P. me detyrë shëf i sektorit të projekteve, E. A. me profesion jurist, me detyrë specialist i burimeve njerëzore dhe komisioni i vlerësimit të ofertave i ngritur me urdhrin nr. 24/1 datë 14.12.2018, me përbërje, A. C., me profesion inxhinier mekanik, - Kryetar me detyrë drejtor i drejtorisë së projekteve dhe marrëveshjeve, A. L., me profesion juriste, me detyrë shefe e sektorit të burimeve njerëzore, E. Z., me profesion ekonomiste, me detyrë shefe e sektorit tregtar.

Dokumentet e tenderimit (D.T.) janë hartuar dhe më pas janë miratuar me procesverbalin nr. 125/8 prot., datë 17.12.2018 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga D. M., E. P. dhe E. A., i cili i është bashkëlidhur D.T.

Me vendim/shkresë nr. 125/9 prot., datë 17/12/2018 të Administratorit të Shoqërisë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, si dhe memon nr. 120/1 prot., datë 30/10/2018, është bërë miratimi i dokumenteve të prokurimit publik si: Fondi limit, procedura e përzgjedhur nga njësia e prokurimit, kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike.

Në datën 17.12.2018 në sistemin e prokurimit elektronik të A.P.P, nga personi përgjegjës për prokurimin për këtë procedurë prokurimi është kryer njoftimi i kontratës nga ku A.P.P e ka bërë aktive publikimin e njoftimit të kontratës në datën 18.12.2018, dhe ky formular është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 51, datë 24.12.2018.

Në auditimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit njësia e prokurimit ka kërkuar:

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;
- b. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- ç. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;
- dh. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10

e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015,2016,2017), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me **Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar**.

2. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015,2016, 2017) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se 50 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet..

3. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik 4. Vërtetim qe konfirmon shlyerjen e taksave vendore per vitin 2017 dhe 2018 leshuar nga Bashkia/te ku ushtron aktivitet sipas QKR-se;

5. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR. 2.3 Per Kapacitetin teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë: 1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo me te vogel se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. b. punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme. Ne rast se punimet Jane kryer me ente publike: Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë sipas Formularit te Vleresimit (shtojca nr. 9 e DT) për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, situacionin perfundimtar dhe kontrate/tat. Ne rast se punimet Jane kryer me sektorin privat: Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore, aktet e kolaudit dhe situacioni perfundimtar, dokumentacion për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

3. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

NP – 1 A (Punime gërmimi në tokë)

NP – 2B (Ndertime civile dhe industriale)

N.P – 3B (Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasadash).

N.P – 4 A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.)

NP – 12B (Punime te inxhinierise se Mjedisit)

Dokumenta Standarde të Tenderit

NS - 1A (Punime per prishjen e ndertimeve)

NS- 2A (Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)

NS - 4A (Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik,

metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese)

NS -8A (Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri)

NS- 14 A (Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj)

NS -18A (Punime Topogjeodezike).

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhenien e licencave profesionale në fushen e ndertimit; Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përgjegjës për dhënien e licencave profesionale në fushen e ndertimit në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës. Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës. 4. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë)

Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem. i. Libreze pune (perkatëse)

ii. CV perkatëse

iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse).

iv. Diplome

5. Një punësim mesatar i të paktën 72 (shtatëdhjetë e dy) personave, për periudhën nëntor 2017 – nëntor 2018 të vërtetuar me;

5.1 Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën nëntor 2017 – nëntor 2018

5.2 List pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën nëntor 2017 – nëntor 2018 shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

6. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre punonjësit e mëposhtem ,te cilet duhet të figurojnë **si drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 12(dymbëdhjetë) muajt e fundit, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, libreze pune.**

Inxhinier Ndertimi 1(një)

Inxhinier Elektrik 1(një)

Inxhinier Hidroteknik 1(një)

Inxhinier Elektronik 1(një)

Inxhinier Mekanik 1(një)

Inxhinier Mjedisit 1(një)

Inxhinier Topograf/Gjeodet 1(një)

Arkitekt 1(një)

Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me “Certifikate per auditimin e energjise)

7. Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 20 (dhjetë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te paktën: -

Grupi I- 5(pese) punonjës

-Grupi II-5(pese) punonjës

-Grupi III- 5(pese) punonjës

-Grupi IV- 4 (kater) punonjës

-Grupi V- 1 (një) punonjës

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

-Kontratën individuale të punës;

-Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ose ekuivalent.

-Punonjesit sa më sipër te figurojne ne list pagesat e shoqerise per 6 muajt e fundit.

7.1 Operatori ekonomik ofertues referuar Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 ”Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar), duhet të ketë 1 (një) mjek. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomik duhet të ketë mjek ndërmarrjeje. Kjo të vërtetohet me:

-Kontratë pune,

Dokumenta Standarde të Tenderit

-Diplomë,

-Librezë pune,

-Urdhër Mjeku,

-CV

(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm)

8. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga QKL Kodi I.2.A. Per ekspertize mbi masat e mbrojtjes nga zjarri te ndertesave te cdo lloji.

9. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga QKL Kodi III.2.A. Per auditim mjedisor dhe ndikimin ne mjedis.

10. Shoqëria duhet te paraqesë Certifikaten e cilesise se punimeve ISO 9001- 2015 (e vlefshme). (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten Iso).

11. Shoqëria duhet te paraqesë Certifikate ISO 14001-2015 (e vlefshme). (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten ISO).

12. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë OHSAS 18001-2007(e vlefshme)(Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten OHSAS).

13. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë PAS 99-2012(e vlefshme)(Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten PAS).

14. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 39001 -2012 (e vlefshme) (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten Iso).

15. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 50001 -2018 (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

17. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 10)

1. Mjetet

Kamiona veteshkarkues (kapaciteti total mbajtes deri ne 10 Ton) Minimumi cope 2 Pronësi ose me qera

Kamiona veteshkarkues (kapaciteti total mbajtes mbi 10 Ton) Minimumi cope 2 Pronësi ose me qera

Autobetoniere 3 cope Pronësi ose me qera

Autopompe per hedhje betoni 1 cope Pronësi ose me qera

Auto vinç 2 cope Pronësi ose me qera

Motorgenerator 1 cope Pronësi ose me qera

Asfaltoshtuese 1 cope Pronësi ose me qera

Grejder 1 cope Pronësi ose me qera

Rul 2 cope Pronësi ose me qera

Eskavator me goma 1 cope Pronësi ose me qera

Minieskavator 1 cope Pronësi ose me qera

Kamioncine 1-3 ton 1 cope Pronësi ose me qera

Matrapik 1 copë Pronësi ose me qera

Pompe suvatimi 1 copë Pronësi ose me qera

Depozite uji 1 copë Pronësi ose me qera

Skela metalike (forme H) te kompletuara me parapetet mbrojtese, shkalle dhe rrjete mbrojtese **per punime ne fasade 2000 m2** Pronësi ose me qera

Skele kulle 1 cope Pronësi ose me qera

Vibrator 1 copë Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

-Kokore minimumi 30 copë

-Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 3 copë

-Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 3 copë

-Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Nga auditimi i specifikimeve teknike të përcaktuara në DST u konstatuan parregullësitë si vijon:
Vendosja e disa specifikimeve teknike nuk ishte argumentuar dhe justifikuar me relacionet përkatëse, si licensat profesionale, NP – 12B (*Punime te inxhinierise se Mjedisit*) Një punësim mesatar i të paktën 72 (shtatëdhjetë e dy) personave, për periudhën nëntor 2017 – nëntor 2018 të vërtetuar me; Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen nëntor 2017 – nëntor 2018, *Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me “Certifikate per auditimin e energjise, Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga QKL Kodi I.2.A. Per ekspertize mbi masat e mbrojtjes nga zjarri te ndertesave te cdo lloji. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga QKL Kodi III.2.A. Per auditim mjedisor dhe ndikimin ne mjedis. 1. Mjetet. Kamiona veteshkarkues (kapaciteti total mbajtes deri ne 10 Ton)*

Minimumi cope 2 Pronësi ose me qera Kamiona veteshkarkues (kapaciteti total mbajtes mbi 10 Ton) Minimumi cope 2 Pronësi ose me qeraAutobetoniere 3 cope Pronësi ose me qera, Autopompe per hedhje betoni 1 cope Pronësi ose me qera, Auto vinç 2 cope Pronësi ose me qera.

Vendosja e paargumentuar e specifikimeve për aftësisë teknike e profesionale, të Operatorëve Ekonomik ofetues, ka pasur si pasojë që KVO ka skualifikuar një OE i cili kishte ofertë ekonomike më të ulët në vlerën 10,932,511 lekë.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik”, ku citohet: ”1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.” dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, ku citohet: “Neni 27 Kontratat e mallrave 1. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. 2. Autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave. 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Për sa më sipër mban përgjegjësi anëtari i njësisë së prokurimit, specialisti i fushës së ndërtimit, E. P. përgjegjës i sektorit të projekteve dhe studimeve.

Nga procesi i kualifikimit të OE fitues u konstatua se operatori nuk plotësonte sa vijon:

1-Kërkesa për pasjen e një mjeku të punësuar me kontratë

-Mjekja E. D., në listëpagesat e muajve janar-shkurt-mars-prill-maj-qershor, është me vlerat zero,në muajin korrik-gusht-shtator-tetor-nëntor 2018 ka nga 3 ditë punë, këto në kundërshtim me kontratën e punës ku deklarohej se do të punojë gjashtë ditë në javë, me pagën 30,000 lekë në muaj.

-Vërtetimi për pagesat ndaj OSHEE është vetëm për një kontratë kur në ekstraktin e QKR, OE ka si vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit Tirane Preze Ahmetaq Rruga Nacionale Vore Fushkruje, Zona Kadastrale 1000 Tirane Bërxull Fshati Domje, Rruga Miqesia, Objekt ne ndertim 2 kate me Zone kadastrale 1514 nr. pasurie 313/49, Vol 10 Fq 43 dhe Zone kadastrale 1514, Nr Pasurie 313/50, Vol 10, fq 44 Tirane Fshati Bërxull, Objekt ne ndertim 1, Kat me zone kadastrale 1167, Ndr Pasurie 211/46, Vol 13 Fq.16 dhe Zone Kadastrale 1167, Nr.pasurie 211/26, Vol 09, Fq.247.

- Pagesa e taksave vendore për të gjitha pikat e ushtrimit të aktivitetit.
- Në mjetet e marra me qera mungonte autorizimi i Bashkisë Fier, ku do ishte objekti i punës.

KVO duhet të skualifikonte OE dhe të anulonte procedurën e prokurimit, duke qenë se i kishte skualifikuar OE e tjerë pjesëmarrës.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Në zbatim të pikës nr.7, të programit të auditimit Nr. 9/1, Datë 17.01.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Dokumentacioni i dosjes së prokurimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Tenderi me objekt: “Ndërtimi i qendrës së mirëmbajtjes Korçë ”2020,

b. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ ”REF- 70165-08-28-2020		
1.Urdhër Prokurimi Nr. Prot., datë	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:- Komisioni i Posaçëm: Urdhër Nr. 5, nr.84 Prot., date 05.08.2020	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdher Nr.29, nr. 84/4 Prot., datë 13.08.2020.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedure e hapur	1. M. R. -drejtor, drejtorja teknike 2. D. M. – përgjegjës i sektorit të prokurimeve publike 3.- E. S. – specialiste drejtorja e projekteve dhe marrëveshjeve	1.E. K. drejtor drejtorja juridike 2.E. P. përgjegjës sektori i projekteve dhe studimeve 3.A. L. përgjegjës sektori i mirembajtjes dhe sigurimit teknik
5.Fondi Limit (pa tvsh) 98,844,810 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 95,880,716 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,964,094 lekë
8. Data e hapjes së tenderit	9.Burimi Financimit Fondet e institucionit	10.Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Nr. 4 b) S’kualifikuar 3(2 Pa oferte ekonomike) c) Kualifikuar 1 ç) Shpallur Fitues 1: B. dhe D shpk
11.Ankimime AK-s’ka APP–ka/Rekomandime	12. PërgjigjeAnkesës	13.Përgjigje Oe ankimues ankese apo KKP

KPP-s'ka/		nr. prot, date _____, date _____.20__
-----------	--	--

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga AK në përcaktimin e Dokumenteve Standardë të Tenderit janë kërkuar që:

1. Kriteret e përgjithshme të pranimi/kualifikimit

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaraten e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

2. Kriteret e veçanta të kualifikimit

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1; -

c. Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;

e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;

- f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;
g. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;
gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit, pika 1 e kësaj shtojce (shtojca 12)

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- a. Xhiro mesatare e realizuar nga operatori ekonomik gjatë tre viteve të fundit (2017, 2018 dhe 2019), ku mesatarja e të tre viteve, duhet të jetë jo më e vogël se 50% e fondit limit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.
- b. Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshem gjatë tre viteve 2016, 2017 dhe 2018. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të këtyre tre viteve, të paraqitura e konfirmuara nga autoriteti përkatës dhe të shoqëruar me raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Bilancet e kërkuara të mos jenë me humbje të paktën për dy vite të njëpasnjëshme.
- c. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për periudhën vitet 2017, 2018 dhe keqet e maturuara të vitit 2019 sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kësaj deklarate duhet ti bashkëngjiten të gjithë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik ka paguar detyrimet përkatëse, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këtë periudhë. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur. Në rast deklarimi të rreme do të vepohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

1.3 Per kapacitetin teknik:

Per sa i perket aftesise teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet te permbushe kerkesat minimale te cilat vendossen nha Auteriteti Kontraktor si me poshte:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme e realizuar në një kontratë të vetme në një vlerë jo më e vogël se 50% e fondit limit, të realizuar gjatë tri viteve të fundit ku zërat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit në prokurim.

Ose

- a) punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, ku zërat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit në prokurim.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;

4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikatën/çertifikatat e marrjes në dorëzim;
6. Faturat tatimore përkatëse për çdo situacion;

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë;
2. Lejen e ndertimit
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt-kolaudim i objekti;
5. Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit;
6. Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2. Operatorët ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës.

Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42 date 16.01.2008; Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:

- 1) License për zbatim punimesh pikat NP.1 -Klasifikimi "A"
- 2) License për zbatim punimesh pikat NP.2 -Klasifikimi "D"
- 3) License për zbatim punimesh pikat NP.3 -Klasifikimi "D"
- 4) License për zbatim punimesh pikat NP.4 -Klasifikimi "B"
- 5) License për zbatim punimesh pikat NP.11 -Klasifikimi "A"
- 6) License për zbatim punimesh pikat NP.12 -Klasifikimi "A"
- 7) License për zbatim punimesh pikat NS.2- Klasifikimi "A"
- 8) License për zbatim punimesh pikat NS.3- Klasifikimi "A"
- 9) License për zbatim punimesh pikat NS.4 -Klasifikimi "B"
- 10) License për zbatim punimesh pikat NS.8 -Klasifikimi "A"
- 11) License për zbatim punimesh pikat NS.12 -Klasifikimi "B"
- 12) License për zbatim punimesh pikat NS.14 -Klasifikimi "A"
- 13) License për zbatim punimesh pikat NS.18 -Klasifikimi "B"
- 14) License për zbatim punimesh pikat NS.19 -Klasifikimi "B"

Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjës;

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktura, Republika e Shqipërisë, siç përcaktohet në "Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008

2.3. 2.3.3 Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik:

Për të provuar se ka përvojë e duhur, operatori duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën 150 (njëqind e pesëdhjetë) punonjës, për periudhën Korrik 2019 - Qershor 2020 të dëshmuar me;

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj në periudhën e mësipërme .
- b. List-pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e percaktimeve që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për secilin nga muajt në periudhën e mësipërme.
- Pjesë e stafit të shoqërisë dhe të figurave në Licensën e kompanisë:

- Inxhinier Nderimi 2(dy)
- Arkitekt 2(dy)
- Inxhinier Elektronik 1(nje)
- Inxhinier Mjedis 1(nje)
- Inxhinier Elektrik 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinier Gjeodet 2(dy)
- Inxhinier Gjeolog 1 (nje)
- Inxhinier Mekanik 2(dy)

Secili prej pjestarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të jetë në **Listëpagesat të paktën për periudhën Korrik 2019 - Qershor 2020** si dhe të figurojnë në **licensën e shoqërisë**.

Për secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet:

- **kontratë noteriale pune e vlefshme**
- **diploma**

c. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, libereze pune, dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë 12 muajt e fundit **1 (një) mjek të përgjithshëm**.

d. Operatori ekonomik të disponojë **1 inxhinier drejtues teknik** të pajisur me **certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, të vërtetuar me kontratë noteriale pune, diplome, certificate si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për 12 muajt e fundit.

f. Të ketë në stafin e punonjësve të pajisur me dëshmi kualifikimit e sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente të akredituara sipas legjislacionit në fuqi, si dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi ku nga këta të jenë të paktën:

- **Teknik nderimi – 3**
- **Specialist Saldator -3**
- **Specialist hidraulik - 4**
- **Specialist Murator - 8**
- **Specialist Elektricitist - 4**
- **Specialist Suvatues - 8**
- **Specialist Bojaxhi - 5**
- **Specialist Hekurkthyes - 6**
- **Specialist Hidroizolues - 2**
- **Specialist Karpertier - 6**
- **Specialist Pllakashtrues - 4**
- **Specialist për Punime durale - 2**
- **Specialist për pajisje kamera – 1**
- **Specialist për pajisje kunder zjarrit – 1**
- **Specialist për punime gipsi – 1**
- **Punëtor të thjeshtë - 40**

- **Shofer - 5**
- **Manovratore –6**

Përpunonjësit e sipërpërmendur të paraqiten, dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, dëshmitë e aftësisë profesionale (manovratore), lejet e drejtimit për shoferet, diplome/deftese profesionale për tekniket e ndertimit, si dhe kontratat e punës të vlefshme. Specialistet e mesipër duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë të pakten 3 muajt e fundit.

g. Operatori ekonomik të ketë të punësuar **2 (dy) ekspert zjarrefikse** të shoqëruar me : kontratë noteriale pune, certifikatën e zjarrefikst për dhenien asistencës teknike dhe trajnimi punonjës për masat MNZH-se, të jenë në listë pagesa për periudhën 12 muajt e fundit, gjithashtu operatori ekonomik ose eksperti zjarrefikse të jetë të pajisur me Kodi 1.2.A lëshuar nga QKL.

i. 1 (një) Inxhinier Drejtues Teknik – Auditues energjitik i Certifikuar me titull : Auditues energjitik në Ndertesa dhe Instalime industriale

Per inxhinierin auditues energjitik duhet të ketë keto dokumenta provues:

- Kontrata noteriale e punës (e vlefshme për të pakten periudhën e parashikuar të ndertimit).
- Certifikata për audituesin energjitik të lëshuar nga Agjencia për Eficienten e Energjisë.
- Inxhinieri duhet të figurojë në listepagesën e shoqërisë 12 muajt e fundit.

j. Operatori për të plotësuar këtë kusht duhet të ketë të pakten:

- **10 (dhjetë) Punonjës Specialist të Certifikuar dhe trajnuar për Punimet në lartësi. D.P.I. Renia nga lartësitë**, punime në fasade, etj sipas V.K.M nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” e dhenë nga një organizatë certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Të jenë me kontratë noteriale pune individuale dhe të figurojnë në Listepagesat për të pakten 12 muajt e fundit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatën “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.4 Disponimi i mjeteve të mëposhtme:

Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtes mbi 20 ton	copë 3	Ne pronesi ose me qera
Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtes 10 - 20 ton	copë 2	Ne pronesi ose me qera
Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtes 5-10 ton	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine vetëshkarkues, kapacitet mbajtes 1-5ton	copë 3	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me goma	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Bobcat	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Minieskavator	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Kamion me vinc	copë 2	Ne pronesi ose me qera
Fadrom (kove para dhe krahe mbrapa)	copë 2	Ne pronesi ose me qera
Kantier ndertimi (zyre)	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Autobot uji	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Autobetoniere	copë 3	Ne pronesi ose me qera
Autopompe betoni	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Fabrik Prodhimi Betoni	copë 1	Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi
Betoniere kantier	copë 2	Ne pronesi ose me qera
GPS	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Rimorkiator për levizjen e mjeteve	copë 1	Ne pronesi ose me qera

Eskavator me zinxhire	copë 2	Ne pronesi ose me qera
Rul hekur hekur	cope 1	Ne pronesi ose me qera
Rul gome hekur	cope 1	Ne pronësi ose me qira
Grejder	cope 1	Ne pronësi ose me qira
Asfaltoshtruese	cope 1	Ne pronësi ose me qira
Vibrator betoni	cope 2	Ne pronësi ose me qira
Matrapik	cope 1	Ne pronësi ose me qira
Skeleri	1,000 m2	Ne pronësi ose me qira
Rrjete mbrojtese	1,000 m2	Ne pronësi ose me qira

Mjete mbrojtese		
Kokore	cope 150	Ne pronesi ose me qera
Fikse Zjarri	cope 10	Ne pronesi ose me qera
Tabela Sigurimi Teknik	cope 20	Ne pronesi ose me qera
Kuti Ndhme e shpejt	cope 10	Ne pronesi ose me qera
Prozhektor per ndricim	cope 2	Ne pronesi ose me qera

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces 10 te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesinë e mjetit:
 - certifikaten e pronesise;
 - leja e qarkullimit;
 - certifikaten e kontrollit teknik;
 - siguracionin;
 - taksat vjetore
 - fotot perkatese;

ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.

Per mjetet dhe paisjet e tjera qe nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet te paraqese kontrate noteriale te blerjes ose fatura tatimore te blerjes ose dokument zhdoganimi te mjetit ose kontrate qeraje.

Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendodhjen e mjeteve.

Fabrikat prodhimi i betoni në Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi te jene te pajisura me (Leje shfrytezimi, plane vendosje, leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) Furnizusi te kete status aktiv ne QKB.

2.3.5 Shoqeria duhet te paraqesë Certifikatë të cilesisë së punimeve:

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise)

- ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor)
- OHSAS 18001- 2007 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurise ne Pune) ose ISO 45001-2018
- ISO PAS 99:2012 (Per sistemin e integruar te menaxhimit) (ose e perditeluar)
- EN ISO 3834-2:2006 (e vlefshme) (ose ekuivalente)
- ISO 50001-2012 (Per menaxhimin e energjise)
- Çertifikatë SSH EN 12102, e vlefshme, si edhe Deklarata e Konformitetit të instalimit dhe funksionimit nga prodhuesi i pajisjeve.

Shënim: Kërkesat e standardit ndërkombëtar SSH EN 12102, mbulohen nga çertifikatat ISO 3744; 3745. Sigurimi i çdo njëres prej tyre do të përmbushë kushtin e kërkuar. Në rast se operatorët ekonomik nuk janë vetë mbajtës të ndonjëres prej çertifikatave të mesipërme, ata duhet të paraqesin edhe Autorizimin e Prodhuesit (Manufacturer Authorisation Form) në emër të tij, lëshuar nga prodhuesi i pajisjeve ose përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi për të lëshuar autorizim, vërtetuar kjo me dokumentacionin që provon se prodhuesi e lejon përfaqësuesin e autorizuar prej tij të lëshojë autorizim prodhuesi.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomik, secili prej tyre duhet të jetë i pajisur me çertifikatat e sipërpermendura, në varesi të punimeve që do të kryej.

2.3.6 Grafiku i punimeve, ku zërat e punës, fuqisë punëtore dhe numrit të mjeteve të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit.

2.3.7 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.10. Deklaratë nga administrator i shoqërisë ofertuese.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me **preventivin duhet të dorëzojë analizë teknike për të gjithë e preventivit të ofertës**. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM Nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10.

2.3.9 Çdo ofertues do të paraqesë planin e sigurise ne kantier Per punimet ne objekt ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003 sipas kerkesa, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12504-4:2008, SSH EN 12350-2:2009 dhe SSH EN 12504-2:2012.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të ketë licencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.A(1+2) në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave Ligj Nr. 10431, Date 9/6/2011, VKM Nr. 538, Date 26/5/2009, VKM Nr. 1124, Date 30/7/2008.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të ketë licencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.B autoriteti kontraktor kërkon që kjo të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në ligjin 10081 datë 23.02.2003, nga ku rrjedhimisht operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”.

2.3.13 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontratë bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Hekur;

- Pajisje hidrosanitare;
- Dyer & dritare;
- Hidroizoluese;
- Pajisje mekanike;
- Bojra hidroplastike;
- Pajisje hidraulike;
- Pajisje elektrike;
- Pajisje ngohje ftohje;
- Pllaka;
- Gjeneratore;
- Pajisje telefonie;
- Shuars zjarri FM 200
- Rezervuar te zinguar

2.3.14 Ne perputhje me specifikimet teknike, preventivit perkates si dhe per shkak te rendesise se vecante qe ka sistemi MNZ per ruajtjen e materialeve te arkives si dhe shuarjes se zjarrit, detyrimisht operatori ekonomike te paraqes dokumentacionin si me poshte:

- autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi;
- certificate akreditimi e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave ekonomike e leshuar nga organizma kombetar ose nderkombetar te akredituar;

2.3.15 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates operatori ekonomik te kete si me poshte:

- 4 punonjes me kualifikimet ne fushen e sistemeve te MNZ. Detyrimisht te paraqitet kontrate noteriale pune per secilin, si dhe per te siguruar realizimin e punimeve ne perputhje me standartet perkatese detyrimisht certificate trajnimi nga prodhuesi ne fushen e sistemeve te shuarjes se zjarrit per secilin nga punonjesit dhe te jene ne liste pagesa per periudhen 12 muajt e fundit;

1 punonjes i pajisur me certificate trajnimi sipas standartit EU nr. 304/2008 ne fushen e e sistemeve te shuarjes se zjarrit;

2.3.16 Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet te shoqerohet edhe me dokumentacionin qe verteton lidhjet e firmes prodhuese me distributorin (kontratë/autorizim). Operatori ekonomik të paraqesë katalogjet perkatese per secilin nga produktet/mallrat e mesiperme. Gjithashtu O.E. te paraqes deklaratë garancie jo me pak se 1 vit nga momenti i marrjes ne dorezim.

2.3.17 Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit”.

2.3.18 Vetëdeklarim nga operatori ekonomik pjesmarres per kontratat që ka në proces dhe/ose eshte shpallur fitues, duke percaktuar objektin, vleren e kontrates, si dhe drejtuesin teknik te deklaruar per secilin objekt qe ka proces dhe/ose eshte shpallur fitues. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

Nga auditimi i specifikimeve teknike të përcaktuara në DST u konstatuan parregullësitë si vijon: Vendosi e disa specifikimeve teknike nuk ishte argumentuar dhe justifikuar me relacionet përkatëse, si licensat profesionale, NP – 12B (Punime te inxhinierise se Mjedisit)

*Një punësim mesatar i të paktën 150 (njëqind e pesëdhjetë) punonjës, për periudhën **Korrik 2019 - Qershor 2020**, të vërtetuar me; Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen, Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me “Certifikate per auditimin e energjise, -Operatori ekonomik duhet te kete licence lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.A(1+2) ne mbeshnje te vendimit te Keshillit te Ministrave Ligj Nr. 10431, Date 9/6/2011, VKM Nr. 538, Date 26/5/2009, VKM Nr. 1124, Date 30/7/2008.*

-Operatori ekonomik duhet te kete licence lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.B autoriteti kontraktor kërkon që kjo të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në ligjin 10081 datë 23.02.2003, nga ku rrjedhimisht operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”.

1. Mjetet. Kamiona veteshkarkues (kapaciteti total mbajtes deri ne 10 Ton) Minimumi cope 2 Pronësi ose me qera Kamiona veteshkarkues (kapaciteti total mbajtes mbi 20 Ton) Minimumi cope 3 Pronësi ose me qera Autobetoniere 3 cope Pronësi ose me qera, Autopompe per hedhje betoni 1 cope Pronësi ose me qera, Auto vinç 2 cope Pronësi ose me qera.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik”, ku citohet: ”1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.” dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, ku citohet: “Neni 27 Kontratat e mallrave 1. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. 2. Autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave. 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Për sa më sipër mban përgjegjësi kryetari i njësisë së prokurimit, drejtori i drejtorisë teknike, z. M. R.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni lidhur me Projekt Raportin, protokolluar KLSH me shkresën nr. 9/8 prot, datë 03.06.2022 “Observacione” nga M. R., ku janë shprehur objeksione duke i'u referuar dokumenteve të dosjes së prokurimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit

-Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se komentet tuaja janë nuk përbëjnë fakte të reja të cilat, nuk janë trajtuar gjatë punës në subjekt, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

2.8 Mbi zbatimin e rregullave dhe procedurave të shitblerjes të gazit dhe projektet që lidhen me gazin natyror.

Në zbatim të pikës 8 të programit të auditimit **“Nr.9/1 Prot, datë 17/03/2022”**, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Statuti dhe rregullorja e brendshme,
- 2) Vendimet e Këshillit të Mbikëqyrjes,
- 3) Urdhërat e brendshëm të Administratorit

Albgaz është certifikuar nga ERE si operator i kombinuar i gazit natyror, konkretisht: ERE me **Vendim nr. 179, datë 08.11.2017** “Mbi certifikimin e Shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” Albgaz sh.a”, ka vendosur: *“Miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Kombinuar të gazit natyror Albgaz sh.a. në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 EC.*

ERE me **Vendim nr. 63 datë 23.04.2019** Për një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e Shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” Albgaz sh.a.” të ndryshuar ka vendosur: (i) Albgaz sh.a. të përfundojë brenda tre muajve procedurat e aplikimit pranë institucioneve përgjegjëse për pajisjen me certifikata pronësie për të gjitha asetete që disponon. (ii) Shoqëria Albgaz sh.a. të dorëzojë për miratim në ERE deri në datën 31 Maj 2019, Programin e Përputhshmërisë të përshtatur sipas atij të miratuar nga ERE me Vendimin nr. 77, datë 26.05.2017 e Bordit të ERE-s. (iii) “Albgaz sh.a të paraqesë në ERE deklaratat e audituesve financiarë dhe pasqyrat financiare të shoqërisë çdo vit ushtrimor.”

Në fund, me **Vendim Nr. 221, Datë 20.12.2019** “Mbi disa ndryshime në Vendimin e Bordit të ERE nr. 179, datë 08.11.2017, ka vendosur: Shtyrjen e afatit të parashikuar në pikën 3 të vendimit të bordit të ERE nr. Nr. 63, datë 23.04.2019, deri në datë 20.06.2020; Shtyrjen e afatit të parashikuar në pikën 4 vendimit të bordit të ERE nr. Nr. 63, datë 23.04.2019, deri në 20.12.2020.

Për transmetimin e gazit natyror, shoqëria është e licensuar nga ERE, konkretisht:

Me **Vendim të ERE nr. 188, datë 10.11.2017** “Mbi liçensimin e shoqërisë albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, ka vendosur: *të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e Transmetimit të Gazit Natyror për një afat 30 – vjeçar, me kushtin që brenda afatit 6 mujor në mbështetje të nenit 24 pika 2 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar”.*

-Me **Vendim te ERE nr. 262, date 19.12.2018** për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE nr. 188, datë 10.11.2017, ka vendosur të shtyjë afatin e depozitimit të dokumentacionit të munguar deri më date 04.03.2019.

-Me **Vendim të ERE nr. 37, Datë 04.03.2019** “Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 188 datë 10.11.2017, i ndryshuar ka vendosur të shtyjë depozitimin e dokumentacionit të munguar brenda datës 20.12.2019, në mbështetje të nenit 24, pika 2 e Ligjit nr. 102/2015, “Për

sektorin e gazit natyror”, që ka të bëjë me Dokumentacionin që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar; Lejet dhe autorizimet mjedisore; një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së Personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të Aplikantit në kuadër të Licensës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milion USD..”

Së fundmi, me **Vendim Nr. 220, Datë 20.12.2019** “Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar që brenda datës 20.06.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2 e Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar...”

Konstatohet se akoma, mbetet i paplotësuar

- (i) kushti i pajisjes me leje mjedisore;
- (ii) sigurimi nga një shoqëri sigurimesh.

Aktiviteti i transmetimit kryhet vetëm nëpërmjet një linje dhe vetëm për një klient A. sh.a.

Për shpërndarjen e Gazit Natyror shoqëria është licensuar nga ERE, Konkretisht:

Me **Vendim te ERE nr.187, datë 10.11.2017** “Mbi Liçensimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror për një afat 30 – vjeçar, me kushtin që brenda afatit 6 mujor në mbështetje të nenit 24 pika 2 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar”.

Me vendim te ERE nr. 261, date 19.12.2018 për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, *ka vendosur të shtyjë afatin e plotësimit të dokumentacionit të munguar deri më datë 04.03.2019.*

Gjithashtu, me Vendim të ERE nr. 36, Datë 04.03.2019 “Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 187 datë 10.11.2017, i ndryshuar *ka vendosur të shtyjë afatin e plotësimit të dokumentacionit të munguar deri më datë 20.12.2019.* Dokumentacioni I munguar ka të bëjë me: Dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar; Lejet dhe autorizimet mjedisore; një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së Personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të Aplikantit në kuadër të Licensës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milion USD..”

Së fundmi, me Vendim Nr. 220, Datë 20.12.2019 “Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar *ka vendosur të shtyjë sërish afatin e depozitimit të dokumentacionit të munguar deri më datë 20.06.2020.*

Sikurse me aktivitetin e transmetimit, edhe me shpërndarjen, konstatohen se akoma, mbetet i paplotësuar

- (i) kushti i pajisjes me leje mjedisore
- (ii) sigurimi nga një shoqëri sigurimesh.

-Me përjashtim të rastit të furnizimit (neni 4.1.c) dhe rastit të tregtimit (neni 4.1.ç) një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së

Personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të Aplikantit në kuadër të Licensës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milion USD. Kjo politikë ose këto politika sigurie do të jenë dhe qëndrojnë në fuqi dhe me efekt të plotë për të gjithë kohëzgjatjen e Licensës së kërkuar. Për më tepër i Licensuari do të mbetet përgjegjës për çdo dëmtim që do të mund të ndodhë prej, ose të lidhet me, ose të rezultojë prej aktiviteteve të kryera gjatë kohëzgjatjes së Licensës.

Shoqëria Albgaz Sh.a. është duke kryer evidentimin faktik të aseteve në terren si dhe njëkohësisht po kryen regjistrimin e aseteve të parregjistruara në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme përkatëse, pasi duke kryer këtë proces Shoqëria Albgaz Sh.a. do të rrisë vlerën e saj dhe do të pastrojë regjistrat nga asetet e panevojshme për operacionet e saj, si dhe në përmbushje të kërkesave në mbështetje të nenit 37 të ligjit 102/2015, *“Për Sektorin e Gazit Natyror”*.

Në aplikimin për tarifë për llogaritjen e tarifës së transmetimit të gazit, nuk është marrë në konsideratë shuma totale e aseteve të shoqërisë, por vetëm kategoria që lidhet me operimin e rrjetit. Albgaz sh.a. fillimisht po shfrytëzon linjat e transmetimit të gazit. Linjat e shpërndarjes janë ende për saktësime të mëtejshme, momentalisht nuk ka aktivitet për Shpërndarjen e gazit natyror, deri sa të kryhen rinovim tërësor i infrastrukturës së gazsjellësit kjo pritet të realizohet në kuadër të investimeve strategjike me rëndësi kombëtare (Gas Masterplani), ku gazsjellësi T. do të ketë rol suportues në konceptimin, planifikimin dhe implementimin e projektit. Pra në mangësi të një rrjeti funksional shpërndarje shoqëria Albgaz Sh. A nuk është në gjendje të aplikojë për një tarifë shpërndarje.

-Shoqëria "Albgaz" Sh. A, në cilësinë e Transmetuesit, funksionin si Operator i Kombinuar i Gazit Natyror ku ofron shërbimin e transmetimit të gazit natyror për llogari të prodhuesit (Shoqëria Albpetrol sh. a, në cilësinë e Prodhuësit). Momentalisht kanë kontratë shërbimi transmetimi të gazit natyror vetëm me A. Sh.a.

-Shoqëria “Albgaz” Sh.a është certifikuar nga ERE, si operator i kombinuar i gazit natyror, nga ERE me Vendim nr. 179, datë 08.11.2017 në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 EC, *çertifikim i cili është kushtëzuar*, si për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror me plotësimin e dokumentacionit që tregon titujt e pronësisë mbi aktivet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar, lejet dhe autorizimet mjedisore, certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri). Për plotësimin e këtyre kushteve ERE herë pas here ka vendosur dhe rivendosur afate me Vendimet nr. 188, datë 10.11.2017, nr. 63, datë 23.04.2019, nr. 221, datë 20.12.2019, nr. 37, datë 04.03.2019, nr. 220, datë 20.12.2019, nr. 261, datë 19.12.2018, nr. 36, datë 04.03.2019 dhe me Vendim nr. 220, datë 20.12.2019, ka vendosur të shtyjë sërish afatin e depozitimit të dokumentacionit të munguar deri më datë 31.03.2022.

Sikurse me aktivitetin e transmetimit, edhe me shpërndarjen, konstatohet se deri më datë 31.03.2022 datë në të cilën përfundoj auditimi, nuk është plotësuar asnjë nga kushtet e vendosura nga ERE. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” neni 22.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi drejtimi i shoqërisë.

Albgaz pavarësisht se është i licensuar për kryerjen e aktivitetit të shpërndarjes së gazit natyror nuk e ushtron këtë aktivitet.

2.9 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikës nr. 7, të programit të auditimit “Nr. 324/1, Datë 30.04.2020, Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Statuti i Shoqërisë.
2. Struktura organizative.
3. Përshkrimet e punës.
4. Kodi i sjelljes miratuar me Vendimin nr. 1, datë 26.01.2017 miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.
5. Regjistër risku për vitin 2019 protokolluar me nr. 100/2 prot., datë 05.11.2019.
6. Regjistër risku për vitin 2021 protokolluar me nr. 13/1 prot., datë 18.01.2021.
7. Pyetësor vetëvlerësimi për vitin 2019,
8. Pyetësor vetëvlerësimi për vitin 2020,
9. Pyetësor vetëvlerësimi për vitin 2021.
10. Dosjet personale të Audituesve të Brendshëm të Shoqërisë.
11. Planetet vjetore dhe realizimi i tyre mbi veprimtarinë e Auditit të Brendshëm për vitet 2017-2021.
12. Raportet vjetore të Auditit të Brendshëm, raportimet në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për vitet 2017-2021.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Menaxhimi financiar dhe kontrolli (MFK) konsiston në hartimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, me qëllim asistimin e menaxherëve në përmbushjen e objektivave, vendimmarrjen e duhur dhe përcaktimin e përgjegjësiave për zbatimin e tyre, në fushën e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, prokurimit, kontraktimit dhe organizimin e njësisë. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka të bëjë me forcimin e performancës së Shoqërisë për të marrë vendime më të mira, të jap shërbime më të mira dhe të japë vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur këtë menaxhimin financiar dhe kontrolli synohet që menaxhmenti i kësaj Shoqërie të jetë përgjegjës jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë të domosdoshme dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit.

Në drejtim të vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në Shoqërinë “Albgaz” Sh.a, janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizmit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Duke u bazuar në ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, grupi i auditimit hartoi pyetësorë lidhur me implementimin dhe organizimin e këtij Ligji, dhe iu dorëzuan elektronikisht Administratorit të Shoqërisë “Albgaz” Sh.a për të paraqitur dokumente në lidhje me zbatimin e këtij drejtimi. Në mbështetje të përgjigjeve mbi pyetësorët dhe dokumentacionit të vendosur në dispozicion, janë hasur problematika të cilat janë të paraqitura si më poshtë:

➤ Mjedisi i kontrollit

Në zbatim të Ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nëpunësi autorizues është A. A. me detyrë Administratori i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, kompetencë të cilën nuk e ka deleguar, duke ruajtur njëherazi edhe pozicionin e Koordinatorit të Menaxhimit të Riskut. Për periudhën objekt auditimi. Shoqëria nuk disponon urdhër për emërimin e nëpunësit zbatues, por theksojmë se funksionet e tij janë mbuluar nga O. S. me detyrë Drejtor i Financës dhe Kontabilitetit.

Nga natyra e saj Shoqëria, ka plan strategjik, i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit. Deklarata e vizionit dhe misionit strategjik gjen vend në planin e biznesit të Shoqërisë, gjë e cila është e publikuar dhe në faqen zyrtare WEB të “Albgaz” Sh.a.

Në lidhje me integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të Shoqërisë, me Vendimin nr. 1, datë 26.01.2017 të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar Kodi i Sjelljes, ku në të cilin janë përcaktuar qartë integriteti dhe vlerat etike të punonjësve. Gjithashtu është përcaktuar morali si një qëndrim korret që punonjësit mbajnë ndaj punës së tyre, lidhur me disiplinën dhe gatishmërinë për të përmbushur detyrat e tyre.

- Shoqëria **nuk** ka një procedurë të veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikim të shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 21 pika 1 dhe 3, si dhe Kapitulli II, “Monitorimi”, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, “1. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes. 3. Për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullsive, nëpunësit autorizues të njësive publike regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive. “Monitorimi”. Për të mbështetur monitorimin e rregullt, titullarët e njësive duhet të ngrenë një sistem për raportimin e brendshëm të risqeve të identifikuar, sipas udhëzimeve të Koordinatorit të Riskut duke garantuar një raportim në afat, të shpeshtë (p.sh. çdo tremujor) dhe të detajuar.....” Qëndrimi mbështetës është që nxit rezultatet e pritshme. Meqënëse menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm i jep menaxhimit garanci të arsyeshme se misioni i njësive do të përmbushet, menaxhimi duhet të ketë një qëndrim mbështetës ndaj kontrollit të brendshëm që përshkon të gjithë njësinë. Përgjatë periudhës objekt auditimi u konstatua se në përgjithësi ka mangësi në kuptimin e kontrollit të brendshëm dhe rolin të secilit pozicion në këtë sistem dhe për këtë arsye nevojitet edukim i vazhdueshëm për të garantuar, se të gjithë punonjësit e kuptojnë sistemin e kontrollit të brendshëm dhe rolin që kanë në të.

Struktura organizative është korniza me anë të së cilës planifikohen, zbatohen, kontrollohen dhe raportohen aktivitetet e njësive. Strukturat duhet të jenë në harmoni me përmasat dhe me natyrën specifike të njësive dhe misionin e saj, duhet të vlerësohen kohë pas kohe dhe të modifikohet në rastet se gjykohet e nevojshme. Me vendimet respektive të Këshillit Mbikëqyrës janë miratuar strukturat organizative për çdo vit.

Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikët e ngjashme lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore. Ato përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm. Marrëdhëniet e punës në këtë Shoqëri janë rregulluar me anë të Kodit të Punës, si dhe Kontratën kolektive dhe kontratat

individuale. Përshkrimet e punës janë miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë Aksionare. Në mënyrën e funksionimit dhe organizimit, Shoqëria nuk ka rregulla të përcaktuara për rekrutimin e stafit.

Përgjatë periudhës objekt auditimi punonjësit kanë zhvilluar trajnime për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, por trajnimet mbi riskun janë shumë të pakta. Përsa i përket punonjësve të Shoqërisë por në veçanti punonjësit e Drejtorisë së Financës dhe Kontabilitetit **nuk** janë trajnuar mbi ligjshmërinë e menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III, pika 3.1 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, “3.1. Mjedisi i kontrollit, Trajnimi dhe ndërgjegjësimi: Trajnimi i përshtatshëm dhe ngritja e përgjegjshmërisë së menaxherëve dhe stafit në fushën e zbatimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, është çelësi i suksesit në këtë fushë. Aktivitetet e trajnimit duhet të përfshijnë sa më poshtë: -Konceptet dhe parimet bazë të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe të auditimit të brendshëm; -Rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin; -Caktimin e objektivave të efektshme, të matshme dhe të përshtatshme, produkteve dhe treguesve të performancës; -Vlerësimin dhe menaxhimin e riskut; -Identifikimin dhe vlerësimin e kontrolleve të brendshme; -Përgatitjen e gjurmëve të auditimit; -Rolet, objektivat, përfitimet dhe kufizimet e funksionit të auditimit të brendshëm.”

Në lidhje me punonjësit e strukturës të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, i nënshtrohen trajnimeve të detyrueshme në ASPA, për të cilat janë pajisur me certifikatat përkatëse.

Për çdo vit është bërë dhe vlerësimi i performancës nga drejtuesit e njësive për funksionet e varësisë së tyre.

➤ **Menaxhimi i riskut**

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut dhe vendosja e objektivave. Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative e veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen. Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij, analizimin dhe rifreskimin e kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut.

- Albgaz Sh.a për periudhën objekt auditimi **nuk** ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë raporte vjetore mbi problematikat e hasura, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenin 8 pika b, nenin 27 pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, “b. Ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligj. 2. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrohen grupit për menaxhimin strategjik, me

qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave. Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje”.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizmin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura. Strategjia e Menaxhimit të Riskut përcakton mënyrën se si duhet të silllet shoqëria ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

Si çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (qëndrore, vendore apo institucion i pavarur), ashtu edhe Albgaz sh.a., duhet të ketë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht (të paktën një herë në tre vjet), si dhe sa herë, kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme.

- Për periudhën 2017-2020, *Albgaz Sh.a nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Menaxhimit të Riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollat që synojnë minimizimin e riskut, vlerësimin, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave. Nuk janë përcaktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin dhe implementimin e kësaj strategjie, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenin 21 pika 2, si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II pika 2.5.2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, “2. Për t’i zbatuar veprimtaritë e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollat që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit. 2.5.2. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes...”.*

Ndërsa për vitin 2021, u konstatua se Strategjia e Menaxhimit të Riskut është hartuar dhe protokolluar me nr. 13/2 prot., datë 18.01.2021.

Regjistri i Riskut duhet të kryhet çdo 2 vite, konkretisht:

- *Konstatohet se për vitet 2017 dhe 2018, nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrimit të Risqeve, monitorimin e kontroleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenin 11 pikat 2 dhe 3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, “2. Identifikimin dhe krijimin e regjistrimit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë. 3. Garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në strukturat që ata drejtojnë, bazuar në rregullat e*

vendosura nga titullari i njësisë publike, si dhe i raportojnë nëpunësit autorizues përkatës për çdo dobësi të sistemit që duhet trajtuar”.

- Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion për vitin 2019, u konstatua se, *ekziston një regjistër risku* i protokolluar në arkivin e Shoqërisë me nr. 100/2 prot., datë 05.11.2019, por në formatin e hartimit të regjistrit të riskut **nuk disponohet “Matrica e riskut” sipas Aneksit nr. 2 “Regjistri dhe matricat e riskut”,** të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësinë publike”.

Konstatohet se **nuk është respektuar data e hartimit të Regjistrit të Riskut,** bazuar në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësinë publike”, Kapit. 4 Hapat për ngritjen e sistemit të MR, për “Afatet e kryerjes së aktiviteteve”, pika 2: “Regjistri vjetor i risqeve duhet të hartohet **deri në fund të muajit shkurt nga çdo njësi publike,** duke marrë në konsideratë objektivat e njësisë publike dhe planet operationale të punës së çdo strukture të miratuara me buxhetin vjetor. Gjatë vitit, në rast se ka ndryshime në objektiva duhet të rishikohet dhe regjistri i risqeve. Format i regjistrit të risqeve jepet në aneksin nr. 2”.

- *Për vitin 2021,* bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion, *ekziston një regjistër risku* i protokolluar në arkivin e Shoqërisë me nr. 13/1 prot., datë 18.01.2022, por në formatin e hartimit të regjistrit të riskut **nuk disponohet “Matrica e riskut” sipas Aneksit nr. 2, “Regjistri dhe matricat e riskut”,** të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësinë publike”.

Nga auditimi në lidhje me menaxhimin e riskut u konstatua se vlerësimi dhe kontrolli i risqeve nuk është në nivelin e duhur, dhe mund të vënë në rrezik arritjen e objektivave që kanë të bëjnë me menaxhimin e riskut.



Aktivitetet e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit konsistojnë në politikat, procedurat dhe përgjegjësitë që duhet të përcaktohen për minimizimin e riskut të mosrealizimit të objektivave institucionale. Nga auditimi me përzgjedhje mbi transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës është konfirmuar sistemi i nënshkrimit me dy firma sipas rregullave të vendosura nga Ministria e Financave. Edhe pse ka dokumente që verifikojnë proceset kryesore operationale dhe financiare, ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemeve IT apo sistemeve rezervë, plan rikuperimi nga fatkeqësitë të testuara në praktikë, ende **nuk janë hartuar gjurmët e auditimit të detajuara për procedurat kryesore,** bazuar në gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlera të vogla, shpenzimeve për konsumin e karburantit. *Pra, nuk ka hartimin, miratimin dhe arkivim të kësaj gjurme të auditimit,* që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenin 16 pikat 2 dhe 3, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III, pika 3.2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, “2. *Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmën e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operationet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.* 3. *Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.* 3.2. *Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e*

ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme... ”.

Gjithashtu **nuk** rezultojnë të jenë përgatitur hartat e proceseve të punës sipas formatit të përcaktuar nga DH/MFKK si kërkesë e pikës 3.3, të Manualit të MFK. Përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij. *Harta e proceseve të punës dhe manuali i procedurave të brendshme, ka si objektiv përcaktimin e qartë të detyrave, ndarjen e tyre, si dhe përshkrimin e pozicionit të punës, në përputhje me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menxhimin Financiar dhe Kontrollin”.*

➤ **Informimi dhe komunikimi**

Informimi dhe komunikimi konsiston në vlerësimin se njësia publike disponon informacionin e duhur, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
- Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.
- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.
- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Menaxhimit duhet t’i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet. Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përmbushjes së objektivave si në nivel aktiviteti ashtu edhe objektivave të përgjithshme të mbarë njësisë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.

Duke u bazuar në Vendimin nr. 2/1, datë 26.01.2017 të Këshillit Mbikëqyrës janë miratuar përshkrimet e punës me anë të së cilët funksionon mënyra e organizimit të kësaj Shoqërie, por **nuk** është e përfshirë mënyra e komunikimit, brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin

e informacionit. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

➤ **Monitorimi**

Procesi i monitorimit të njësisë konsiston në vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm sipas nevojës, me qëllim mirëfunksionimin e tyre. Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura. Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës. Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.

Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit bëhet duke plotësuar pyetësozin e vetëvlerësimit. Çdo nëpunës autorizues për çdo vit duhet të përgatisë një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai do të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës. Në deklaratë, Nëpunësi Autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar. Qëllimi i kësaj deklarate është për të rritur llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm. Raporti Vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm duhet të bëhet çdo vit, ku nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi tek nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

- Albgaz Sh.a për periudhën objekt auditimi **nuk** ka hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave, Deklaratën dhe Raportin Vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm. Për vitet 2017 dhe 2018 **nuk** ka plotësuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pyetësozin e vetëvlerësimit, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon menaxhimi financiar dhe kontrolli, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8 pika 1 dhe 2 si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, si dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli V, Shtojca nr. 2, “Pyetësori i vetë-vlerësimit për komponentët e MFK-së”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, “1. Nëpunësi autorizues i

*njesisë publike, sipas pikave 1 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njesisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njesisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njesisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitet e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji. 2. Nëpunësi i parë autorizues përgatit dhe depoziton te Ministri i Financave raportin vjetor të konsoliduar **jo më vonë se fundi i muajit maj**, duke u mbështetur në raportet, sipas pikës 1 të këtij neni, për kontrollin e brendshëm të sektorit publik. Ky raport është përmbledhje e raporteve vjetore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e auditimit e brendshëm në sektorin publik. Shtojca nr. 2. Pyetësorët e vetëvlerësimit, për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, I rekomandohet Titullarit të njesisë që të detyrojë drejtuesit e tjerë të strukturave të njesisë të plotësojnë këtë pyetësor për strukturat që kanë përgjegjësi. Titullari i njesisë do t'i përdorë rezultatet për të formuluar një përgjigje të plotë, në lidhje me gjithë subjektin. Kjo përgjigje e plotë duhet t'i dërgohet Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, në Ministrinë e Financave.....”.*

Duke u bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion u konstatua se, “Albgaz” Sh.a ka plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit për vitin 2019, dokumentacioni i cili **nuk** është dërguar në Ministri.

- Në vitin 2020 është plotësuar Pyetësori i Vetëvlerësimit, i protokolluar me nr. 34/4 prot., datë 03.09.2021, i cili rezulton i protokolluar jashtë afatit, referuar Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli V, Shtojca nr. 2, “Pyetësori i vetë-vlerësimit për komponentët e MFK-së”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: 2. *“Nëpunësi i parë autorizues përgatit dhe depoziton te Ministri i Financave raportin vjetor të konsoliduar **jo më vonë se fundi i muajit maj**, duke u mbështetur në raportet, sipas pikës 1 të këtij neni, për kontrollin e brendshëm të sektorit publik. Ky raport është përmbledhje e raporteve vjetore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e auditimit e brendshëm në sektorin publik”.*

Në vitin 2021 është plotësuar Pyetësori i Vetëvlerësimit, i protokolluar me nr. 22 prot., datë 16.02.2022, të cilat i janë dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

➤ **Auditi i Brendshëm**

Duke u bazuar në nenin 16, pika k, të Statutit të Shoqërisë, në të cilin përcaktohet që:

Lidhur me veprimtarinë e Keshillit Mbikëqyrës, të miratohet struktura e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të emëroj drejtorin dhe anëtarët e saj.

-Me vendimet respektive të Këshillit Mbikëqyrës janë emëruar audituesit e brendshëm më poshtë:

-Me vendimin nr.7, datë 26.01.2017 të Keshillit Mbikëqyrës është emëruar M. H. në pozicionin specialiste audit.

-Me vendimi nr. 14, datë 01.03.2017 është emëruar E. M. në pozicionin specialiste audit.

-Me vendimin nr. 22, datë 01.11.2017 të Këshillit Mbikëqyrës është emëruar M. H. në pozicionin e Drejtorit të Auditit të Brendshëm.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u konstatua se, sipas Vendimit nr. 2/1, datë 26.01.2017 të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar struktura organizative për vitin 2017 ku pjesë e kësaj strukture është dhe Auditi i Brendshëm i përbërë nga dy specialist audit.

Sipas Vendimit nr. 3, date 09.02.2018 te Këshillit Mbikëqyrës, janë miratuar disa ndryshime në strukturën organizative per vitin 2018, ku pjesë e këtyre ndryshimeve është dhe struktura e Auditit të Brendshëm, ku ka kaluar ne Drejtorinë e Auditit të Brendshëm strukturë e cila është e përbërë nga tre pozicione (1 drejtor + 2 specialistë auditit). Aktualisht detyren ne kite drejtori e ushtrojnë detyrën drejtori dhe 1 specialist auditit ndërsa një vend është vakant. Nga auditimi i dosjeve të tyre është konstatuar se te dy audituesit disponojnë certifikatat perkatese dhe kualifikimet sipas dispozitave ligjore.

Per vitin 2017, ne mbështetje të kërkesës së kryer nga Njësia e Auditit të Brendshëm me shkresën nr. 131 prot., datë 20.04.2017 me vendimin nr. 17, datë 13.09.2017 ti Këshillit Mbikëqyrës është miratuar Plani strategjik 2017-2019 dhe Plani vjetor per vitin 2017 i NJAB te shoqërisë. Në Planin vjetor te auditimit per vitin 2017 është miratuar ne muajin shtator te ketij viti, ku NJAB ka programuar 9 misione auditimi, 2 misione perputhshmerie, 6 misione finance dhe 1 mision për performancën.

Përgjatë kësaj periudhe 3 mujore janë realizuar 2 misione duke krijuar dosje te rregullta te Auditimit te brendshëm, nga te cilat mision i plotë, ku janë përfshirë 7 fusha/sisteme te ndryshme auditimi. Auditime te paplanifikuara nuk janë kryer. Nga misionet e realizuar janë shqyrtuar dhe evaduar te dy misionet e auditimit.

Njësia e Auditit të brendshëm ka dhënë gjithsej 22 rekomandime, nga te cilat janë pranuar 22, nga te cilat 20 me karakter organizativ dhe 2 rekomandime masa zhdëmtimi ne shumën 44,761 lekë.

Me shkresën nr. 23 prot., date 13.02.2018 NJAB ka dërguar Raportin Vjetor per periudhën Janar - Dhjetor 2017 në Drejtorinë e Harmonizimit te Auditit te Brendshëm ne Ministrine e Financave dhe Ekonomise.

Për vitin 2018, ne mbështetje te kërkesës se kryer nga NJAB, me vendimin nr. 25, datë 27.12.2017 të Keshillit Mbikëqyrës është miratuar Plani strategjik 2018-2020 dhe Plani vjetor për vitin 2018 i NJAB të shoqërisë.

Në Planin vjetor të auditimit per vitin 2018 ka programuar 8 misione auditimi, nga te cilat 3 misione financiare, 5 misione përputhshmërie.

NJAB ka dhënë gjithsej 37 rekomandime, nga te cilat janë pranuar 37, jane zbatuar 27 rekomandime ndërsa ne proces realizimi 10, per vitin 2018 nuk ka zbulime me dëm ekonomik.

Me shkresën nr. 16 prot., datë 12.02.2018 NjAB ka dërguar Raportin Vjetor për periudhën janar-dhjetor 2017 ne Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm ne Ministrine e Financave dhe Ekonomisë.

Per vitin 2019, ne mbështetje te kërkesës dhe shkresës nr. 119 prot., date 17.10.2018 është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit te Brendshëm Plani strategiik 2019-2021 dhe Plani vjetor per vitin 2019 i NJAB të shoqërisë.

NJAB ka dhënë gjithsej 51 rekomandime, janë pranuar 51 rekomandime, te karakterit organizativ dhe nuk ka zbulime me dem ekonomik.

Me shkresen nr. 56/1 prot., date 11.02.2020 NjAB ka derguar Raportin Vjetor per periudhën janar-dhjetor 2019 në Drejtorinë e Harmonizimit te Auditit te Brendshem ne Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Për vitin 2020, ne mbështetje te kërkesës se kryer nga NJAB, me vendim nr 15 date 03.10.2019 te Keshillit Mbikqyres eshte miratuar Plani Strategjik 2020-2022 dhe plani vjetor 2020 i NJ.A.B. i shoqerise. Në planin vjetor të auditimit për vitin 2020, janë programuar gjithsej 10 angazhime auditimi.

Janë realizuar **7 misione angazhimi** auditimi nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm. Nga keto misione 3 misione financiare dhe 4 te perputhshmerise.

Nj.A.B ka sygjëruar 37 rekomandime per vitin 2020, te cilat jane pranuar te karakterit organizativ dhe rolit te Kontrollit te Brendshem. Nuk ka zbulime me dem ekonomik.

Eshte realizuar edhe nje mision angazhimi me shkrese te M.F nr Nr19310 date 16.10.2020 “Mbi kryerjen dhe raportimin e angazhimit te auditimit te detyrimeve te prapambetura” me objekt: “Auditim i sistemit te pagesave te prapambetura te krijuara nder vite, te shkaqeve te ekzistences dhe krijimit te detyrimeve financiare deri ne 30 Shtator 2020 ne shoqerise Albgaz “ sh.a.

Me Vendim te keshillit Mbikqyres nr.12 date 11.10.2021 eshte miratuar Raporti i Veprimtarise se Nj.A.B per vitin 2020”.

Me shkresën nr.19 prot., datë 12.02.2021 NjAB ka dërguar Raportin Vjetor për periudhën janar-dhjetor 2020 ne Drejtorinë e Harmonizimit te Auditit të Brendshëm ne Ministrine e Financave dhe Ekonomisë.

Për vitin 2021 ne mbështetje te kërkesës se kryer nga NJAB , me vendim nr 16 date 23.12.2020 te Keshillit Mbikqyres eshte miratuar Plani Strategjik 2021-2023 dhe plani vjetor 2021 i Nj.A.B. i shoqerise. Në planin vjetor të auditimit për vitin 2021, janë programuar gjithsej 9 angazhime auditimi.

Me kërkesë dhe relacion argumentimi nga Nj.A.B është bërë ndryshimi i Planit vjetor 2021 me vendim të Këshillit Mbikqyrës nr.13 datë 11.10.2021 “Për një ndryshim të vendimit të K.M nr.16 datë 23.12.2020.”

Janë realizuar **7 misione angazhimi** auditimi nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm. Nga këto misione 4 misione financiare dhe 3 të përputhshmërisë.

Nj.A.B per vitin 2021 **ka sygjëruar 49 rekomandime** te karakterit te administrimit te buxhetit 29 rekomandime, 14 rekomandime ne fushen e prokurimeve dhe 6 rekomandime ne fushen e pagave Rekomandimet jane pranuar ne teresi nga palet ne auditim.

Me shkresën nr. 23/1 prot., datë 14.02.2022 NjAB ka dërguar Raportin Vjetor për periudhën janar-dhjetor 2021 ne Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm ne Ministrine e Financave dhe Ekonomisë.

Në mënyrë të përmbledhur

Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit të brendshëm në Shoqërinë Albgaz Sh.a ka funksionuar jo në nivelin e duhur, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është implementuar plotësisht, për pasojë nuk ka funksionuar në të gjitha hallkat e njësisë, duke mos bërë të mundur që drejtuesi të bëjë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

- Shoqëria Albgaz Sh.a për periudhën objekt auditimi nuk disponon urdhër për emërimin e nëpunësit zbatues.

- Nuk disponohet një procedurë e veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikim e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

- Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik i riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë raporte vjetore mbi problematikat e hasura.

- Nuk është hartuar dhe miratuar Strategjia e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi,

për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave. Nuk janë përcaktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin dhe implementimin e kësaj strategjie.

- Nuk janë miratuar, hartuar dhe arkivuar Gjurmët e Auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlera të vogla, shpenzime për konsumin e karburantit.

- Nuk janë plotësuar, hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe pyetësozin e vetëvlerësimit, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon menaxhimi financiar dhe kontrolli.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit të brendshëm në Shoqërinë “Albgaz” Sh.a ka funksionuar jo në nivelin e duhur, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është implementuar plotësisht, për pasojë nuk ka funksionuar në të gjitha hallkat e njësisë, duke mos bërë të mundur që drejtuesi të bëjë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi nëpunësi autorizue dhe zbatues.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar.
2. Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”.
3. Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”.
4. Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010.

2.10 Të tjera që mund të dalin gjatë auditimit.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Situata ekonomiko financiare që nga krijimi i kësaj shoqërie (2017-2021), është me humbje, si dhe detyrimet ndaj të tretëve si kredi afatshkurtër e afatgjatë në vlerën 411,656 mijë lekë, detyrime të cilat janë maturuar për pagesë dhe janë kërkuar për likuidim, pasqyron qartazi jo vetëm situatën e vështirë të likuiditetit të Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, por po të vazhdohet në këtë pozitë, kjo shoqëri rrezikon të falimentojë. Në opinionin e grupit të auditimit kjo ka ardhur për arsyt si më poshtë:

-Shoqëri nuk e ka kryer aktivitetin e saj në përputhje me objektin e veprimtarisë, si operator i kombinuar i gazit natyror, pasi ka kryer veprimtarinë vetëm të operatorit të sistemit të transmetimit dhe jo edhe të operatorit të sistemit të shpërndarjes për tre vite kjo shoqëri ka marrë gaz natyror nga shoqëria A. dhe ja ka shitur përsëri shoqërisë (A.) si klient fundor.

-Shoqëria nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur investimeve shtetërore në zbatim të parashikimeve të Master Planit të Gazit Natyror, duke mos avancuar në projekte me interes të përbashkët të Komunitetit të Energjisë {J (*Degëzim i TAP AG në drejtim të Kroacisë*), A. (*Degëzim i TAP AG në drejtim të Kosovës, si dhe depozita nëntokësore e gazit natyror në Dumre-Elbasan*)} si e vetmja Shoqëri në Republikën e Shqipërisë me objekt të veprimtarisë, si operator i kombinuar i gazit natyror. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, i ndryshuar, neni 104 dhe 190, Ligjin nr. 102/2015 “*Për Sektorin e Gazit Natyror*”, neni 22, Master Plani i Gazit Natyror, dhjetor 2016.

-Shoqëria është organizuar me një strukturë organizative, të mbingarkuar, e pa strukturuar për të plotësuar objektin e shoqërisë, duke sjellë kosto në rritje në shpenzimet e shoqërisë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 16-19 të Raportit të Auditimit*).

Rekomandimi 1.1: Organet drejtuese të shoqërisë duhet analizojnë dhe të vlerësojnë arsyet e produktivitetit të ulët të veprimtarisë ekonomiko-financiare, efektin e çdo arsyeje të identifikuar, përfshirë një analizë të detajuar të detyrimeve ndaj të tretëve dhe në veçanti kreditë afatshkurtra e afatgjata, si dhe të merren masat e nevojshme për daljen nga kjo situatë që shoqëria mos të falimentojë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 1.2: Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, ti kërkojnë në rrugë institucionale Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë Asamblesë (pronarit) dhe të monitoruesit dhe hartimit të politikave, që të ndërmarrin veprime ligjore, për korrigjimin e menjëhershëm të veprimtarisë së kësaj shoqërie, dhe konkretisht për investime shtetërore në zbatim të parashikimeve të Master Planit të Gazit Natyror dhjetor 2016, si dhe marrjen e masave për kryerjen e plotë të aktivitetit të kësaj shoqërie referuar objektit të veprimtarisë, si operator i kombinuar i gazit natyror, duke kryer veprimtarinë e operatorit të sistemit të transmetimit dhe operatorit të sistemit të shpërndarjes.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “Albgaz” Sh.a është çertifikuar nga ERE, si operator i kombinuar i gazit natyror, nga ERE me Vendim nr. 179, datë 08.11.2017 në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 EC, *çertifikim i cili është kushtëzuar*, si për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror me plotësimin e dokumentacionit që tregon titujt e pronësisë mbi aktivet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar, lejet dhe autorizimet mjedisore, certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri). Për plotësimin e këtyre kushteve ERE herë pas here ka vendosur dhe rivendosur afate me Vendimet nr. 188, datë 10.11.2017, nr. 63, datë 23.04.2019, nr. 221, datë 20.12.2019, nr. 37, datë 04.03.2019, nr. 220, datë 20.12.2019, nr. 261, datë 19.12.2018, nr. 36, datë 04.03.2019 dhe me Vendim nr. 220, datë 20.12.2019, ka vendosur të shtyjë sërish afatin e depozitimit të dokumentacionit të munguar deri më datë 31.03.2022.

Sikurse me aktivitetin e transmetimit, edhe me shpërndarjen, konstatohet se deri më datë 31.03.2022 datë në të cilën përfundoj auditimi, nuk është plotësuar asnjë nga kushtet e vendosura nga ERE. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” neni 22. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 16-19 të Raportit të Auditimit*).

Rekomandimi 2.1: Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë të marrin masa për nxjerrjen nga statusi i certifikimit të kushtëzuar të shoqërisë, duke analizuar dhe vlerësuar arsyet

e mos plotësimin të kushteve të vendosura nga ERE, duke vendosur një afat prekluziv në lidhje me plotësimin e kushteve të certifikimit.

Brenda datës 31.12.2022

3. Gjetje nga auditimi: Nga Shoqëria “Albgaz” Sh.a nuk disponohet pronësia e gjurmës së kalimit të tubacioneve magjistrale të transmetimit të gazit natyror në total. Sipas Master Planit të Gazit Natyror kjo shoqëri disponon 267.4 km, ndërsa sipas inventarit kontabël disponon 264 km, me një diferencë 3.4 km. Tubacionet magjistrale të transmetimit të gazit janë projektuar e ndërtuar rreth viteve 1970-1980.

Gjurma e kalimit të tubacioneve është projektuar e zbatuar duke kaluar edhe përmes tokës arë dhe drufrutor të prodhimit të kulturave bujqësore dhe të plantacioneve të drufrutoreve nën administrim të ish-kooperativave bujqësore dhe të ish-ndërmarrjeve shtetërore.

Tubacionet janë futur në thellësinë 1 metër deri në 1.2 metër nën sipërfaqen e tokës, me qëllim që të mos pengonin punimet për kulturat bujqësore dhe drufrutore. Në zbatim të Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, me ndryshimet vijuese të tij, për pronësinë e gjurmës së kalimit të tubacioneve magjistrale të transmetimit të gazit, nuk është mbajtur asnjë qëndrim për njohjen e autoritetit të pronarit të tubacioneve për gjurmën e kalimit. Për 264 km tubacion i transmetimit të gazit kalon në tokat në pronësi të të tretëve.

Ky është jo vetë një problem pronësie, por dhe të shfrytëzimit të magjistrave të tubacioneve të transmetimit të gazit, pasi pengon jo vetëm kryerjen e shërbimeve teknike të tubacioneve, por dhe rëndon koston e mirëmbajtjes, pasi shoqëria është e detyruar të zhdëmtojë kulturat bujqësore dhe drufrutore të pronarëve të tokave. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, neni 12, pika 1 dhe 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 16-19 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 3.1: Nga Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës të merren gjitha masat tekniko-organizative dhe të ndiqen procedurat ligjore për përcaktimin e distancës së gjurmës së tubacioneve të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, si dhe zbatimin e plotë të dispozitave ligjore për pronësinë dhe pasurinë e nëntokës me të vetmin pronar Shtetin, duke i kërkuar zyrtarisht Zyrrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të bëjnë rregullimin e marrëdhënieve të bashkëpronësisë të tokës arë, drufrutore, pyjore, kullosore dhe truall që disponohet (regjistruar) nga palët e treta me gjurmën e kalimit të tubacioneve të magjistrave të transmetimit të gazit natyror.

Brenda datës 31.12.2022

4. Gjetje nga auditimi: Në statutin e Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, neni 13.3, është përcaktuar kompetenca e Asamblesë së Përgjithshme, vendosja e kufirit për aprovimin e huave në vlerat mbi 10,000,000 euro dhe të drejtën e vendimmarrjes për heqje dorë nga një e drejtë për vetëm mbi 300,000 euro ose 500,000 euro vlera kumulative gjatë një viti, duke i lënë vlerat nën këto tavane, si kompetencë e aprovimit të Këshillit Mbikëqyrës.

Po në këtë status neni 16, pika 16.3/n është përcaktuar kompetenca e Këshillit Mbikëqyrës:

- Të miratojë hyrjen në një marrëveshje huaje apo kredie ose krijime të tjera (apo marrëveshje për krijim) të një borxhi të shoqërisë deri në shumën prej 10,000,000 euro.

- Të japë miratimin paraprak për blerjen e aktiveve të paluajtshme mbi vlerën 100.000 euro.

- Të miratojë paraprakisht shitjen apo çdo formë disponimi të aktiveve të paluajtshme të Shoqërisë me vlerë nga 50.000 deri 100.000 euro, dhe të kërkojë paraprakisht miratimin e Asamblesë për vlera më të mëdha se 100.000 euro.

-Të miratojë paraprakisht shitjen e aktiveve të luajtshme në rast se vlera e një kontrate është nga 50.000 deri 100.000 euro, ose nëse vlera kumulative e këtyre kontratave është nga 250.000 deri 500.000 euro brenda një viti financiar.

-Termi i përdorur sa më sipër (... të miratoj paraprakisht...), nuk është i qartë dhe nuk i jep vlerë përfundimtare kompetencës së çeduar, pra Këshilli Mbikëqyrës, i shqyrton paraprakisht dhe më pas shqyrtohen dhe nga Asambleja e Përgjithshme, apo është organi i vetëm që i shqyrton dhe pas tij vendimet marrin vlerë përfundimtare.

Kompetencat si më sipër të Këshillit Mbikëqyrës, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, neni 4, neni 10 (Shtuar pas fjalisë së parë me Ligjin nr. 8/2016, datë 11.2.2016).

-Në nenin 17, përbërja e Këshillit Mbikëqyrës, në asnjë nga pikat nuk përcaktohet kriteri i aftësive profesionale, eksperiencia dhe monitorimi i veprimtarisë mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse i tyre me performancën e shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 16-19 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 4.1: Asambleja e Përgjithshme brenda kompetencave ligjore, të bëjë parashikime specifike (ç’fuqizojë dhe/ose ndreqje gabimi material) në Statut, në lidhje me vendosjen e kufirit për aprovimin e huave, si dhe përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës, ku të përcaktohet specifikisht kriteri i aftësive profesionale, eksperiencia dhe monitorimi i veprimtarisë mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse i tyre, në lidhje me performancën e shoqërisë.

Brenda datës 31.12.2022

5. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni zyrtar i vënë në dispozicion u konstatua se Shoqëria “Albgaz” Sh.a është palë edhe në marrëveshjet si më poshtë:

-Marrëveshja për fondet e rikonstruksionit të Qendrës Fier (Funding Agreement C32919 between T. and Albgaz Sh.a), hartuar dhe nënshkruar më datën 18.09.2017, protokolluar me nr. 141 prot., datë 03.11.2017 në gjuhën Angleze, nuk është hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare.

-EBRD-ECA (Terma Reeference: Project është përgatitur me ndihmën e konsulentit E., si pjesë e asistencës për ngritjen e kapaciteteve teknike, financuar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZ) e nënshkruar më datën 04.05.2017, hartuar dhe nënshkruar në gjuhën Angleze, nuk është hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare.

-Marrëveshja trepalëshe të trajnimit të negociuar ndërmjet S. S.P.A, Shoqërisë “Albgaz” Sh.a dhe Shoqërisë “A.” Sh.a, e nënshkruar më datën 22.01.2020, hartuar dhe nënshkruar në gjuhën Angleze, nuk është hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare.

Marrëveshjet si mësipër të hartuara dhe nënshkruara vetëm në gjuhën angleze, pa u hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8417, date 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 14.

Marrëveshjet e mësipërme, janë hartuar dhe nënshkruar vetëm në gjuhën angleze, pa u hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare gjë që pamundësoi auditimin e tyre nga grupi i auditimit, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 8417, date 21.10.1998, me ndryshimet vijuese të tij, neni 14. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 16-19 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 5.1: Për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura në lidhje me hartimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me Shoqërinë, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, duke përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar marrëveshjet ekzistuese, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Brenda datës 31.12.2022

6. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “Albgaz” Sh.a në shpenzimet e veprimtarisë operationale të saj rëndohet padrejtësisht nga vënia në punë dhe mirëmbajta e stacioneve të kompresorëve B2S Drenovë. Mbajtja e stacionit të kompresorëve B2S DR në punë ka kosto operationale të lartë (shpenzime për vajra, riparime të defekteve, shpenzime paga fuqie punëtore, energjinë elektrike dhe reaktive etj.). Përveç shpenzimeve të tjera, edhe pse është aktiv afatgjatë material i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, faturimi i energjisë elektrike dhe reaktive i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a kryhet nga Shoqëria “A.” Sh.a, bile jo nga kjo shoqëri, por nga (Q.). Pra matësi i energjisë është i kësaj të fundit (aktivi afatgjatë material është i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, matësi është i Shoqërisë “Q.”), dhe me çmim 17.4 lek/kwh për energji elektrike dhe 1.65 lekë për kwh energji reaktive që i përket çmimit të liberalizuar të konsumatorëve të tregut të lidhur me tensionin e lartë dhe të mesëm.

Për shpenzimet e energjisë elektrike dhe reaktive (jo për shpenzimet e tjera), Shoqëria “Albgaz” Sh.a i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 120 prot., datë 22.10.2018 për rivlerësim e këtij shpenzimi, për një shpërndarje sa më të drejtë mes dy shoqërive. Për vitet 2017-2019 shpenzimet për energjinë elektrike dhe reaktive, lubrifikant, shpenzime avarie, paga etj., kapin vlerën 23,365,578 lekë.

Deri më datën 31.03.2022, datë në të cilën përfundon auditimi nuk është kryer rivlerësim i këtij shpenzimi, për një shpërndarje sa më të drejtë të tij mes dy shoqërive, edhe pse 5 nga 6 antarët e Këshillit Mbikëqyrës (Me përjashtim të N. L. që është përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë) i përkasin Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë edhe të Asamblesë së Aksionarëve, për të cilët Shoqëria “Albgaz” Sh.a për vitet 2017-2019 ka shpenzuar vlerën 2,537,485 lekë për shpërblimin e tyre. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 2, pika 25 dhe 26, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 në faqet 30-33 të Raportit të Auditimit*).

Rekomandimi 6.1: Nga Këshilli Mbikëqyrës të ri-njoftohet zyrtarisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Asamblesë së Aksionarëve (pronarit) dhe të monitoruesit dhe hartimit të politikave të Shoqërisë “Albgaz” Sh.a dhe Shoqërisë “A.” Sh.a, brenda kompetencave ligjore, statusore, rregullatorë të kryej rivlerësimin e këtij shpenzimi, për një shpërndarje sa më të drejtë të tij mes dy shoqërive. Në rast mos kryerjes së rivlerësimit të këtij shpenzimi nga Asambleja, të ndiqen procedurat gjyqësore.

Brenda datës 31.12.2022

7. Gjetje nga auditimi: Në një rast investimi është kryer pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 39, pika 1 dhe 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 11, pika a, neni 13, pika c. Leja e ndërtimit për objektin është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 8, datë 28.02.2020, pasi është ndërtuar objekti, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi A. C. me detyrë drejtor i drejtorisë së marrëveshjeve dhe projekteve dhe E. P. me detyrë shef i sektorit të projekteve.

- Në një rast në preventivin paraprak dhe atë të ndryshuar nuk është përcaktuar fond rezervë, si dhe ndryshimet në preventiv nuk janë shoqëruar me ndryshimet në projekt. Pra projekti është i pa ndryshuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 39, pika 1 dhe 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.

408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 11, pika a,b,c,ç.

-U konstatua lidhje kontrate shitesë me nr. 101/16 prot., datë 18.12.2019, kontratës bazë nr. 3/17 prot., datë 18.03.2019 për ndërtimin e dy magazinave me konstruksion metalik dhe rikonstruksionin e zyrave Fier, viti 2019, pa pasur fond disponibël. Kontrata për ndërtimin e dy magazinave me konstruksion metalik dhe rikonstruksionin e zyrave Fier, është lidhur me nr. 3/17 prot., datë 18.03.2019 ndërmjet Shoqërisë “Albgaz” Sh.a. dhe operatorit/e shoqërisë “A.” shpk në vlerën 55,109,096 lekë pa TVSh. Për realizimin e këtij objekti është bërë shitesë kontrate me nr. 101/16 prot., datë 18.12.2019 në vlerën 11.016.811,60 lekë pa TVSH Për rrjedhojë kjo shitesë kontrate nuk duhet të ishte lidhur, pasi lidhja e kësaj kontrate është në kundërshtim me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe e Verifikimit), nr. 9941 prot., datë 08.11.2018, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi, E. K. me detyrë drejtor i drejtorisë juridike dhe prokurimeve.

-Procedura e prokurimit, negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për objektin e prokurimit “Ndërtim magazina dhe rikonstruksion i zyrave në Fier”, me fond limit 11.016.812 lekë, e parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2019, nuk është në kushtet e rrethanave të veçanta (kushte specifike) të pa parashikuara nga dispozitat ligjore, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 33, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar neni 36, çka ngarkon me përgjegjësi drejtorinë e drejtorisë juridike dhe prokurimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 në faqet 48-67 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 7.1: Për mbrojtur interesat publike, duke siguruar se fondet publike shpenzohen në mënyrën e duhur, të besueshme dhe efikase, me konkurrencë dhe transparencë në prokurimet publike, si dhe për të siguruar, që të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike të trajtohen në mënyrë të drejtë:

-Të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për ndërtimet dhe rikonstruksionet e objekteve, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me leje ndërtimi, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve.

- Në të ardhmen nga Shoqëria t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale fondeve disponibël, dhe në vartësi të tyre të operohet me procedurat e prokurimit dhe në veçanti lidhjes së kontratave.

- Nga Autoriteti kontraktor del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë të paligjshme, me qëllimin e rivënies në vend të integritetit në prokurimin publik, që procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës të kryhen vetëm në rrethanat të veçanta (kushte specifike).

8. Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimit “Ndërtim magazina dhe rikonstruksion i zyrave në Fier”,për vlerën 60,529 mijë lekë, në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit, nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

- Për procedurën e prokurimit “Ndërtim magazina dhe rikonstruksion i zyrave në Fier”, për vlerën 60,529 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.

9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 63 pika 3, neni 67, Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në 1 rast për vlerën 325 mijë lekë është anuluar procedura e prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 73, pika 2. Në opinionin e grupit të auditimit, arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

-Për procedurën e prokurimit “*Ndërtimi i qendrës së mirëmbajtjes Korçë*”, për vlerën 98,844,810 lekë, në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit, nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Për procedurën e prokurimit “*Ndërtimi i qendrës së mirëmbajtjes Korçë*”, për vlerën 98,844,810 lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 63 pika 3, neni 67, Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 në faqet 48-67 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 8.1:-Autoriteti kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të tillë që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kriterëve, duke parandaluar në këtë mënyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.

-Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, duke planifikuar trajnime për rritjen e kapaciteteve të personelit.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: -Struktura organizative dhe niveli i pagave të Shoqërisë, nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja Aksionare (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë). Konkretisht për vitin

2017 nuk është marrë miratimi për strukturën organizative, për vitet 2018 dhe 2019 nuk është marrë miratimi për strukturën organizative dhe nivelin e pagave dhe për vitin 2020 nuk është marrë miratimi për nivelin e pagave. Organet drejtuese të Shoqërisë (Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori) e kanë quajtur të ezauruar miratimin vetëm me miratimin e programit ekonomik ku pjesë e tij është dhe fondi i pagave. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1.

-Shoqëria “Albgaz” Sh.a marrëdhëniet e punës me punonjësit e saj i ka të rregulluar bazuar në Ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, Kontratës kolektive nr. 261, datë 19.09.2017 dhe kontratave individuale të punës. Pagat janë të grupuar në katër nivele për secilin pozicion pune, konkretisht niveli i I, II, III dhe IV dhe secili nivel ka një limit përcaktuar. Për pozicionet punëtor deri në specialist brenda limitit të çdo niveli është përcaktuar paga e secilit punonjës me vendim të Administratorit.

Për pozicionet përgjegjës sektori, shef sektori, asistent ekzekutiv, këshilltar, drejtor drejtorie nuk ka të miratuar sipas kompetencave statusore një rregullore, ku të parashikohen kriteret e caktimit të pagës brenda limit të miratuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 9.1: Nga Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës të merren masat për të hartuar dhe miratuar sipas kompetencave statutore një rregullore, ku të parashikohen kriteret e caktimit të pagës brenda limit të miratuar, për pozicionet përgjegjës sektori, shef sektori, asistent ekzekutiv, këshilltar, drejtor drejtorie etj.

Brenda datës 31.12.2022

Rekomandimi 9.2: Nga organet drejtuese të shoqërisë të merren masat për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet ligjore dhe statutore në mirë-organizimin dhe mirëfunksionimin e shoqërisë.

Brenda datës 31.12.2022

10. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se, mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në këtë Shoqëri, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira, sa më sipër në kundërshtim me Ligji nr. 9125, datë 29.07.2003 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, neni 9 pika 1, pika 5, gërma a *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 10.1: Nga organet drejtuese të shoqërisë të merren masat:

-Të bëhen parashikime të detajuara statutore dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

- Të bëhet adresim korrekt në rregullore i përgjegjësive të punonjësve bazuar në lidhjen shkakësore të veprimeve të tyre me pasojat e kundra ligjshme që mund të shkaktohen.

- Të përcaktohet në deklaratimet për pozicione të lira pune, edhe afati brenda të cilit të interesuarit për pozicionin e punës, duhet të shprehin interesin dhe paraqesin dokumentacionin e nevojshëm provues.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: -Sipas programit ekonomik për vitin 2017, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 116 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar 115 punonjës, pra 1 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 68,790 mijë lekë, pra 2,908 mijë lekë më pak se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin 2018, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 117 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar 115 punonjës, pra 2 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 79,141 mijë lekë, pra 459 mijë lekë më pak se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin 2019, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 117 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve të vitit 2019 është realizuar 116 punonjës, pra 1 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 93,330 mijë lekë, pra 3,103 mijë lekë më pak se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin 2020, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 118 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve të vitit 2020 është realizuar 113 punonjës, pra 5 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 90,922 mijë lekë, pra 3,618 mijë lekë më pak se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin 2021, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 119 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve të vitit 2021 është realizuar 113 punonjës, pra 6 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 97,428 mijë lekë, pra 2,372 mijë lekë më pak se programi.

-Sa më sipër, konstatohet se struktura organizative e shoqërisë Albgaz SHA, është e paargumentuar, jo e mirë menduar dhe duke u bazuar në aktivitetin, të ardhurat e rezultatin financiar negativ të shoqërisë nuk justifikohet numri i punonjësve.

-Sa më sipër nga grupi i auditimit konstatohet se struktura organizative dhe fondi i pagave, çdo vit kanë progresion rritës, i cili në asnjë rast nuk realizohet dhe nuk justifikohet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 11.1: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë Albgaz SHA të merren masa për parashikimin e saktë të strukturës numrit të punonjësve, duke ju referuar nevojave specifike të shoqërisë, bazuar në funksionin e saj primar.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Më datë 22.05.2017, administratori i shoqërisë K. G., i përfaqësuar nga A. Gj. me autorizimin e posaçëm me nr. 154 prot., datë 22.05.2017, ka lidhur kontratën me shoqërinë V. SHA, për përfitimin e shërbimit të telefonisë celulare. Kohëzgjatja e kontratës është 24 muaj dhe vlera totale e shpenzimit që shoqëria Albgaz detyrohet ti paguajë shoqërisë V. është 3,585,600 lekë brenda afatit të kontratës, për një numër 88 përdoruesish, me një vlerë shpenzimi fiks mujor prej 149,400 lekë. Me vendimin të Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 13.04.2017, janë përcaktuar kuotat dhe pozicionet e punës të cilat përfitojnë mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare, si administratori dhe drejtorët e drejtorive, ndërsa punonjësit e tjerë nuk janë përfitues.

Dhënia e garancisë ndaj Shoqërisë V. për mbulimin e shpenzimeve për të gjithë numrat e kontraktuar përfshirë dhe pozicionet e tjera jo të aprovuara në këtë vendim, ekspozon shoqërinë për efekte të mundshme ekonomike negative.

-Në librat e blerjeve të deklaruar në sistemin tatimor, në periudhën 2017-2018-2019, vlera e deklaruar e blerjeve të shërbimit të telefonisë janë në shumat e rimbursuara prej shoqërisë për personat e autorizuar dhe jo në vlerën totale të faturës së lëshuar nga V., një veprim i kryer për të justifikuar si shpenzim të zbritshëm për deklarimet tatimore vetëm vlerat e rimbursuara, por që nuk ka ndikuar në rezultatin e shoqërisë.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 1, pika 2, VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, seksioni III, mbajtja e kontabilitetit, neni 57, Udhëzimin, nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 42, neni 115, si dhe Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet 33-43 të Raportit të Auditimit*).

Rekomandimi 12.1: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masat, që shërbimi i telefonisë celulare të prokurohet, me synim e transparencës së garës konkurruese dhe leverdishmërisë ekonomike, si dhe kontrata të përfshijë vetëm personat e pozicioneve që ka përcaktuar Këshilli Mbikëqyrës për tu rimbursuar.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi:- Për vitin 2017 janë kryer 3 procedura prokurimi me vlera të vogla me objekt “Blerje karburanti Diezel D1 dhe Benzinë” me vlerë totale 1,150,000 lekë pa TVSH. Nga auditimi i këtyre procedurave konstatohet se Autoriteti Kontraktor për vitin 2017 ka copëzuar fondin limit, në kundërshtim me nenin 28.2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e efikasitetit në përdorimin e këtyre fondeve.

- Në procedurën e iniciuar me kërkesën e Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëveshjeve me nr. 237 Prot., datë 05.09.2017, me objekt “Blerje pajisje GPS” për nevoja të Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, u konstatua se parametrat teknik të kërkuar janë me vlera specifike dhe jo me kufij të limituar. Përcaktimi me vlera të pandryshuara të madhësisë së ekranit, pesha, rezolucioni, kohë zgjatja e baterisë ka sjellë paracaktimin e fituesit të procedurës.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 23, pika 3, nenin 23, pika 3 dhe nenin 40 të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet 33-43 të Raportit të Auditimit*).

Rekomandimi 13.1: Nga Autoriteti kontraktor të merren masa për korrigjimin e praktikave që cenojnë parimet e konkurrencës në çmimin e paguar nga shoqëria për blerjen e një malli, shërbimi apo kryerjen e një pune, të cilat nga ana tjetër kanë efekt të drejtpërdrejtë në shpenzimet e buxhetit të shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi:- Shpenzimet për konsum karburanti për vitin 2017, janë administruar nga A. S. me detyrë përgjegjëse i sektorit të shërbimeve mbështetëse dhe operacionale në cilësinë

e personit të autorizuar nga A. Gj. me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Operacionale. Ky administrim ka paraqitur risk të lartë shpërdorimi, pasi përcaktimi i normave të konsumit të karburantit, ndjekja, monitorimi, verifikimin dhe marrja në dorëzim e formularëve të plotësuar mbi lëvizjet e kryera të punonjësve, dhe deklaratimet e shpenzimeve të karburantit, janë kryer nga i njëjti person. Për pos sa më sipër u konstatua se mungonin kërkesat për karburant nga përdoruesit, fletët e udhëtimit të aprovuara nga administratori/epriori përkatës, dhe kuponët tatimorë përkatës për karburantin e konsumuar. Veprim në kundërshtim me nenin 22, pika 3, veprimtaritë e kontrollit, shkronja b), të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, pikave 6 dhe 10 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet 33-43 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 14.1: Nga Administratori i Shoqërisë, të merren masa për hartimin e procedurave të menaxhimit të shpërndarjes së karburantit dhe verifikimit të konsumit të tij, duke reflektuar rritjen e sigurisë që rrisqet për keqmenaxhim ose vjedhje të jenë të kufizuar brenda kufijve të pranueshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi:

Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se në Shoqërinë Albgaz Sh.a, Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nuk është implementuar në nivelin e duhur, pasi nga shoqëria për periudhën objekt auditimi:

- Nuk disponon urdhër për emërimin e nëpunësit zbatues.

- Nuk disponohet një procedurë e veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

- Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik i riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë raporte vjetore mbi problematikat e hasura.

- Nuk është hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave. Nuk janë përcaktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin dhe implementimin e kësaj strategjie.

- Nuk janë miratuar, hartuar dhe arkivuar Gjurmët e Auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlera të vogla, shpenzime për konsumin e karburantit.

- Nuk rezultojnë të jenë përgatitur Hartat e proceseve të punës sipas formatit të përcaktuar nga DH/MFKK si kërkesë e pikës 3.3, të Manualit të MFK.

- Nuk janë plotësuar, hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe pyetësorin e vetëvlerësimit, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon menaxhimi financiar dhe kontrolli.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, nevojiten aktivitete shtesë për të forcuar kontrollin në raportimin menaxhrial, llogaridhënie dhe menaxhim të rrezikut.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimi financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pikat 1, 2 dhe gërma b, neni 11 pika 2 dhe 3, neni 16 pika 2 dhe 3, neni 21 pikat 1, 2 dhe 3, neni 27 pika 2, Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësinë publike”, aneksi nr. 2, si dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, pika 2.5.2, pika 3.1, pika 3.2 dhe kapitulli V, shtojca nr.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqet 67-78 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 15.1: Shoqëria “Albgaz” Sh.a duhet të rrisë performancën e saj në drejtim të përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, të personelit, pasurive dhe buxhetit sipas planeve të biznesit, që menaxhmenti i kësaj shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve, por edhe për të siguruar që këto vendime të jenë dobiprurëse. Ajo duhet të marrë masa për hartimin dhe menaxhimin e strategjisë dhe regjistrin të riskut, krijimin e listave të proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve, si edhe përfshirjen efektive të sektorëve të ndryshëm në procese, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga rekomandimi: Programet ekonomiko-financiar (buxhetet vjetor) janë hartuar dhe realizuar në pamjaftueshmëri financiare, pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar në fakt plotësisht me buxhet, konkretisht është programuar me humbje për periudhën e auditimit. Në mënyrë të detajuar: Për vitin 2017 nga të ardhurat janë realizuar në vlerën 19,557 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 114,037 mijë lekë, për vitin 2018 të ardhurat janë realizuar në vlerën 11,961 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 145,032 mijë lekë, për vitin 2019 të ardhurat janë realizuar në vlerën 9,811 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 335,714 mijë lekë, për vitin 2020 të ardhurat janë realizuar në vlerën 145,044 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 170,209 mijë lekë, për vitin 2021 të ardhurat janë realizuar në vlerën 162,588 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 194,710 mijë lekë.

-Për vitin 2017, nuk janë respektuar afatet për dërgimin dhe miratimin e programit ekonomik nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë Asamblesë (pronarit). Kjo situatë ka ndodhur për shkak se Shoqëria e ka filluar ushtrimin e aktivitetit të saj më datë 05.01.2017.

- Për vitet 2018, 2019, 2020 është konstatuar se nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit Mbikëqyrës, brenda datës një nëntor, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, kapitulli III, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 30-33 të Projekt Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 16.1: Programet ekonomiko-financiar (buxhetet vjetor) të hartohen në mjaftueshmëri financiare, duke mbuluar me buxhet të gjithë aktivitetin e shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës të miratoj në kohë programin ekonomiko-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet

e tij gjatë vitit, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: -Nga departamenti i financës, regjistrimet e veprimeve kontabël, janë kryer në programin Excel dhe jo me “Bartës informatik”, të cilët janë programe informatike të pa-manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë, gjë e cila ndikon në pasaktësi gjatë procesit të regjistrimit të dokumenteve financiarë, si dhe gabime gjatë kuadrimin të veprimeve kontabël. Mungesa e programit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabile dhe të pasqyrave financiare.

-Procesi i marrjes në dorëzim i aktiveve afatgjata materiale në shoqërinë Albgaz SHA, nga shoqëria dhuruese A. SHA, nuk është kryer sipas Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 42,43, 55,56,57.

-Zëri i AAJM, për periudhën 31.12.2017 Aktivet afatgjata jo-materiale, License programe dhe transmetimi është grant dhe i klasifikuar si AAJM afatgjatë. Ky zë përbëhet nga pajisje kompiuterike të dhëna si grant nga TAP dhe licensa 1 vjecare për programin Office 365 Bussines Premium, në vlerën 1,056,850 lekë. Këto licensa nuk janë të lidhura me pajisjet kompiuterike dhe meqënëse skadonin brenda një periudhe 1 vjecare duhet kontabilizoheshin tek shpenzimet e periudhës, për vlerën 4 mujore, prej 352,283 lekë që i takonte vitit 2017, dhe pjesa tjetër 704,567 lekë si shpenzim i periudhës 2018. Ky veprim ka dhënë efekte dhe zërin e të ardhurave nga grantet.

-Në vlerën e të ardhurave rimarrje Grantesh, nuk është llogaritur pjesa përkatëse e vitit 2017 e licensave të Office 365 që skadonin në vitin 2018, dhe jo duke e amortizuar si një Aktiv Afatgjatë.

-Administratori dhe drejtoria ekonomike kanë përdorur norma amortizimi për aktivet afatgjata materiale, për periudhën 2017, të pa miratuara nga këshilli mbikëqyrës.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, normat për llogaritjen e shpenzimeve të amortizimit të aktiveve afatgjata materiale janë të pa vlerësuara dhe aprovuara nga këshilli mbikëqyrës.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin Nr.9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

-Miratimi i pasqyrave financiare të vitit 2017, për Sh.a “Albgaz”, Tiranë, është bërë nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 7718/1, datë 09.07.2018. Aprovimi është kryer jashtë afatit të përcaktuar në Ligjin nr. 8483 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 33/1.

Veprimet sa më sipër kanë sjellë mos vlerësim të drejtë të situatës së aktiveve të shoqërisë. Mosmbajtja e kontabilitetit me “Bartës informatik”, sjellë risk për mos marrje në kohë të informacionit, duke u reflektuar në vendimmarrjen e drejtimit të shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet 26-32 të Raportit të Auditimit).*

17.1 Rekomandim: Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që në të ardhmen për pajisjen me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan deklarime shpenzimesh të njohura fiskale në librin e blerjeve dhjetor 2017, si deklarime të faturave të OSHEE dhe UKT, të cilat ishin faturuar për subjektin e Ministrisë së Ekonomisë. Këto fatura ishin deklaruar për vlera pjesore si dhe në kolonën e blerjeve me Tvsh jo të zbritshëm.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me Udhëzimin Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Mos deklarimi i saktë i blerjeve sjell risk për penalitete për mos zbatim të legjislacionit tatimor si dhe deformon rezultatin financiar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet 26-32 të Raportit të Auditimit).

18.1 Rekomandim: Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që në të ardhmen nga sektori i financës deklarimet e blerjeve të kryehen me saktësi dhe në kohën e përcaktuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: -Shoqëria nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat tërësore e të plota që duhet të përmbajë ky regjistër, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30. Mos plotësimi i saktë i regjistrit sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet 26-32 të Raportit të Auditimit).

19.1 Rekomandim: Drejtimi i shoqërisë duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Shoqëria në pasqyrat e vitit 2017 ka një humbje në vlerën 94,459,828 lekë e mbledhur me humbjen e vitit 2018 në vlerën 133,071,313 lekë dhe e redukton kapitalin e shoqërisë në vlerën 169,606,330 lekë. Humbjet e shoqërisë kanë kaluar në më shumë se 50 % të kapitalit të regjistruar. Për periudhat 2019-2020 shoqëria ka paraqitur pasqyrat financiare të konsoliduara të cilat nuk e japin të qartë fenomenin, por problematika kryesore e daljes me humbje është në vazhdimësi. Nga organet drejtuese të shoqërisë nuk janë marrë masat për vlerësimin e situatës, propozimet për zgjidhje dhe njoftimi i ortakut, veprim në kundërshtim me nenin Neni 136 “Mbledhja e asamblesë së përgjithshme”, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, pika 3 si dhe pika k e nenit 20.2 të statutit të shoqërisë Mos marrja e masave për rritjen e kapitalit mund të sjellë në një situatë falimentimi për shoqërinë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet 26-32 të Raportit të Auditimit).

20.1 Rekomandim: Drejtimi i shoqërisë duhet të marrë masa për vlerësimin e situatës së përkeqësuar ekonomike dhe financiare të shoqërisë, të analizojnë humbjet vjetore, të propozojnë për miratim në asamblenë e ortakëve zgjidhje dhe strategji afatgjata të cilat do të përmirësojnë performancën ekonomike e financiare të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR

MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Administrata e Shoqërisë ka përfituar padrejtësisht: -Për periudhën Mars 2018 deri më Mars 2020, trajtim me dietë ushqimore në **vlerën 4,648,000 lekë**, trajtim i cili referuar pikës 2, germa a, të VKM nr. 68, datë 07.02.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, duhet të ishte 300 lekë për ditë pune, ndërsa Administrata e Shoqërisë është trajtuar me 500 lekë për ditë pune. Për periudhën prill të vitit 2020 e në vazhdim ky trajtim është konform VKM të sipërcituar.

-Për periudhën objekt auditimi konstatohet se punonjësit e shoqërisë Albgaz SHA kanë përfituar padrejtësisht bonusin dietë antidodë **në vlerën 3,170,244 lekë**, bonus i cili referuar kontratës kolektive nr. 261, datë 19.09.2017, jepet për punonjësit që ushtrojnë detyrën në terren në kushtet e vështirësive tekniko profesionale, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit*).

Rekomandimi 1.1: Nga organet drejtuese të shoqërisë të analizohet vlera 7,818,244, vlerë e cila ka të bëjë me trajtim me dietë ushqimore dhe dietë antidodë të administratës në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 5 datë 12.11.2019, dhe të merren masa për tu mos u përsëritur në të ardhmen, pasi kjo vlerë për Shoqërinë “Albgaz” dhe Buxhetin e Shtetit, përbën efekt negativ në menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Brenda datës 31.12.2022

2. Gjetje nga auditimi: Shpenzime udhëtim dhe dieta për jashtë shtetit në 22 raste në vlerën 1,725,587 lekë, për akomodim në hotele jashtë vendit, të kryera pa dokumentacion të plotë justifikues. Konkretisht faturat janë lëshuar nga agjenci turistike pa u shoqëruar me faturën e hotelit të përdorur nga punonjësit e shoqërisë, duke mos vërtetuar prezencën e tyre në hotelet përkatëse, veprim në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit , i ndryshuar, pika 9. Vlera 1,725,587 lekë përbën efekt negativ në menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit*).

Rekomandimi 2.1: Nga Administratori i Shoqërisë të shqyrtohet **vlera 1,725,587 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shpenzime udhëtim e dieta për jashtë shtetit të kryera pa dokumentacion të plot justifikues. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse për të korrigjuar këtë praktik të paligjshme që të mos përsëritet në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: -Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 7 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **8,491,981 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbaremore. Lidhur me këto çështje gjyqësore nga ana e përmbareuesve privatë është vepruar me urdhër sekuestro. Sa më sipër **vlera 8,491,981 lekë** përbën efekt negativ financiar në buxhetin e shoqërisë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit*).

3.1 Rekomandim: Nga Administratori, sektori Juridik dhe Burimet Njerëzore të shoqërisë Albgaz SHA, të merren masa për analizimin e vlerës prej **8,491,981 lekë**, të efektit negativ dhe për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Me vendim të ish-Administratorit të Shoqërisë K. G. nr. 86, datë 01.03.2017, në pozicionin e specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore është emëruar M. H. me pagë 75,000 lekë. Me vendim të Administratorit të Shoqërisë A. A. nr. 24, datë 30.01.2019, është bërë ndryshimi i pagës nga 75,000 lekë në 50,000 lekë për këtë ish-punonjëse. Ish-punonjësja në fjalë nuk dispononte diplomën e arsimit të lartë, në kundërshtim me kriteret e aprovuara me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 2/1, datë 26.01.2017. Nga përlllogaritja e pagës si diferencë ndërmjet pozicionit të punës me diplomë të arsimit të lartë dhe jo të lartë, për periudhën mars 2017 deri më dhjetor 2017 rezulton një diferencë në vlerën 416,000 lekë. ***Vlera 416,000 lekë për Shoqërinë “Albgaz” Sh.a dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ në menaxhimin me ekonominë, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit).***

Rekomandimi 4.1: Nga Këshilli Mbikëqyrës të shqyrtohet vlera **416,000 lekë**. Kjo vlerë ka ardhur si pasojë e diferencës së pagës nga mos pasja e diplomës së arsimit të lartë në pozicionin e specialistit në Sektorin e Burimeve Njerëzore të ish-punonjësës M. H. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse.

Brenda datës 31.12.2022

C. 1. MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenit nr.37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe Kontratës kolektive për punonjësit e shoqërisë Albgaz ShA, **kërkojmë nga Administratori i Shoqërisë** fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore:

“Vërejtje” për punonjësit:

1.-A. G. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Operacionale, për shkeljet e konstatuara në administrimin e shpenzimeve të karburantit.

Ky administrim ka paraqitur risk të lartë shpërdorimi, pasi përcaktimi i normave të konsumit të karburantit, ndjekja, monitorimi, verifikimin dhe marrja në dorëzim e formularëve të plotësuar mbi lëvizjet e kryera të punonjësve, dhe deklaratimet e shpenzimeve të karburantit, janë kryer nga i njëjti person.

2.-E. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, për shkeljet e konstatuara në procedurat e kryera për punonjësit që janë dërguar jashtë shtetit me shërbime.

Z. K. ka konceptuar procedura për përzgjedhjen e hoteleve për qëndrim jashtë shtetit, duke e përcaktuar paraprakisht hotelin dhe më pas duke u kërkuar operatorëve ekonomikë, ofertën më të ulët për qëndrim. Asnjë nga operatorët ekonomikë nuk kishte marrëveshje bashkëpunimi me hotelet e përcaktuara, pra procedura e marrjes së ofertave ekonomike ishte një procedurë formale dhe jo ekonomike dhe efektive.

3.-A. C. me detyrë drejtor i drejtorisë së marrëveshjeve dhe projekteve, për një rast investimi, që është kryer pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 39, pika 1 dhe 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 11, pika a, neni 13, pika c. Leja e ndërtimit për objektin është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 8, datë 28.02.2020.

-E. P. me detyrë shef i sektorit të projekteve, për një rast investimi, që është kryer pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 39, pika 1 dhe 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 11, pika a, neni 13, pika c. Leja e ndërtimit për objektin është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 8, datë 28.02.2020.

-Në cilësinë e specialistit të fushës, në njësinë e prokurimit në hartimin e specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, në Tenderin me objekt: “Ndërtim dhe rikonstruksion i zyrave Fier” 2018 u konstatuan parregullsitë si vijon: Vendosja e disa specifikimeve teknike nuk ishte argumentuar dhe justifikuar me relacionet përkatëse.

Vendosja e paargumentuar e specifikimeve për aftësisë teknike e profesionale, të Operatorëve Ekonomik ofertues, ka pasur si pasojë që KVO ka skualifikuar një OE i cili kishte ofertë ekonomike më të ulët në vlerën 10,932,511 lekë. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik”.

-M. R. me detyrë drejtori i drejtorisë teknike, për parregullsitë në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtimi i qendrës së mirëmbajtjes Korçë ”2020, në cilësinë e specialistit të fushës në njësinë e prokurimit, ku u konstatuan parregullsitë si vijon:

Vendosja e disa specifikimeve teknike nuk ishte argumentuar dhe justifikuar me relacionet përkatëse, si licencat profesionale, veprime në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik”.

C2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësin e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi këta persona nuk janë në marrëdhënie pune në këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore **“Vërejtje”**, konkretisht:

1. K. G., nuk është në marrëdhënie pune me Albgaz Sh.A.

2. E. O., nuk është në marrëdhënie pune me Albgaz Sh.A.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Kontrolli i Lartë i Shtetit